ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues · Kryeredaktor
BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 12 PRILL 2025 · NUMËR 330 · VITI VIII I BOTIMIT · ÇMIMI 50 LEKË · WWW.EXLIBRIS.AL · EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL · BOTIM I ONUFRI SHPK

Duke u marrë prej vitesh me figurën e një prej ushtarakëve-stratiotëve më të njohur arbërorë në fushat e betejave, në frontet e Europës mesjetare, Mërkur Buan, në një nga arkivat italianë gjetëm dokumentin e plotë të poemës dedikuar atij, shoqëruar nga një numër akuarelesh me mjaft vlerë për këtë kondotier të famshëm. Nuk do të flasim këtu për kronikën e bëmave dhe betejave të shumta që Mërkur Bua zhvilloi në frontet e luftërave, as për trofetë dhe famën e madhe që ai arriti në kapërcyellin e shekujve XV-XVI. Për këto e shumë të tjera do të flasim në një botim tjetër të afërt.

MËRKUR BUA

Luftëtari i famshëm shqiptar në vargjet dhe penelin e një poeti arbëror të panjohur

Nga Prof. Dr. Irakli Kocollari

Dje ishte ditëlindja e Asdrenit, 11 prill 1872

A MUND TË NDREQET KY "MËKAT" I ASDRENIT?

Nga Emil Lafe (fq. 4)

IN MEMORIAM

Margarita Xhepa dhe kumtet e reve

Nga Enver Kushi

Nuk e mbaj mend, se ku e kam lexuar një poezi që flet për mbrëmjen e një qyteti, pemët e menduara dhe gurët e kalldrëmta të menduara. Në Tiranë, mbrëmja e datës 4 prill, pasi përcollëm në banesën e fundit Margarita Xhepën, erdhi pa zë. Pemët, rrugët, gurët e kalldrëmta të lagjeve të vjetra të Tiranës, sheshet e kryeqytetit, banesat, ishin memece... (fq. 11)

SHËNIME MBI LIBRAT

MIHAL HANXHARI, NJË POET NDRYSHE

Nga Agim Vinca (fq. 6)

Një punim krahasimtar mes tregimit të E. Koliqit dhe M. Rousia

MITI I SHTOJZOVALLES

Nga Xheni Shehaj

Teksa përhumbesha në një antologji me tregime qipriote, ndesha në një autore të panjohur. Tregimi i saj kishte ngjashmëri të mëdha me tregimin e Ernest Koliqit, "Nusja e mrekullueshme". (fq. 5)

Botohet në Gjermani libri me ese i Lindita Arapit, "Lulebliri për libra"

Kur largohesh nga atdheu nuk jeton më në njëjës!

Mbi atdheun dhe identitetin, mbi përkatësinë dhe të huajën, për shanset e barabarta në shoqëri - dhe nostalgjinë e Shqipërisë për Europën. (fq. 9)

"Kronikë e një vdekjeje të lajmëruar" e Gabriel García Márquez-it

RRËFIMI SI KRONIKË

Nga Fatlum Meholli

Pavarësisht se narratori përpiqet të rindërtojë ngjarjet me sa më shumë saktësi, pyetje e pyetje mbeten pa përgjigje. Ishte Santiago Nasari vërtet fajtor? (fq. 21)

Studimet albanologjike në Kinë

Iljaz Spahiu, Sinolog (fq. 22)

Bota, Gjuha dhe Mendimi në filozofinë e Ludwig Wittgenstein-it

nga Ndue Gjika (fq. 20)

SHPËTIM GARUCI:

Shëmbëllyesi i dritëshkrueseve bardhezi të marubëve në pikturë

Nga Oltsen Gripshi, Ph.D.

(fq. 10)

BIBLIOTEKË

Rudolf Marku (fq. 12)
Si të ndërtojmë një poet
Arben Bllaci (fq. 14)
Funerali i Sheme Shkretës
Kosta Nake (fq. 15)
Te sitka e koles
Ylli Ajdini (fq. 16)
Kopshti i ëndrrave
Tinka Kurti (fq. 17)
Prishtinë 2.0
Won-Pyung Sohn (fq. 18)
Djali që nuk e njihte frikën
Përktheu: Xhoina Salaj
Arben Meksi (fq. 19)
Karikatura e së shtunës

SIMBOLI I TRËNDAFILIT TE "PRINCI I VOGËL" Një histori dashurie e pakushtëzuar

(fq. 16)

Nga Laura Born/ Eagle's Nest

"Zëri i Shqipërisë"- Antologjia e Poezisë Shqipe botohet në Uzbekistan

(fq. 23)

MËRKUR BUA

LUFTËTARI I FAMSHËM SHQIPTAR

NË VARGJET DHE PENELIN E NJË POETI ARBËROR TË PANJOHUR

Prof. Dr. Irakli Kocollari

Duke u marrë prej vitesh me figurën e një prej ushtarakëve-stratiotëve më të njohur arbërorë në fushat e betejave, në frontet e Europës mesjetare, Mërkur Buan, në një nga arkivat italianë gjetëm dokumentin e plotë të poemës dedikuar atij, shoqëruar nga një numër akuarelesh me mjaft vlerë për këtë kondotier të famshëm. Nuk do të flasim këtu për kronikën e bëmave dhe betejave të shumta që Mërkur Bua zhvilloi në frontet e luftërave, as për trofetë dhe famën e madhe që ai arriti në kapërcyellin e shekujve XV-XVI. Për këto e shumë të tjera do të flasim në një botim tjetër të afërt.

Ajo që na shtyu në hartimin e këtij shkrimi ishte fakti befasues që hasëm në Arkivat Italiane, për Autorin e poemës biografike kushtuar stratiotit arbëror. Ai quhet Xhane nga qyteti i Koronit në More. Kështu e ka identifikuar ai vetvehten në shkrimet që ka lënë. Një luftëtar arbëror në radhët e reparteve të komanduara nga Mërkur Bua dhe njëkohësisht një kronist, poet por edhe piktor i pa identifikuar gjer më sot si i tillë. (1)

EMIGRIMET E ARBËRORËVE NGA MOREJA NË TERRITORET ITALIANE

Mbasi territoret ballkanase dhe ato të Greqisë ranë nën pushtimin Osman, ashtu sikundër nga territoret e Arbërisë, edhe nga territoret helenike morën rrugën e emigrimit drejt territoreve italiane, jo pak familje, të cilat shtyheshin ti shpëtonin masakrave dhe mënxyrës së robërisë osmane. Më të shumtët që mernin këtë kalvar mundimesh në emigrimet e largëta, ishin arbërorët e Greqisë (arvanitët), të cilët kishin shfaqur qëndresën më të mëdhe, të vendosur dhe të përgjakshme kundër pushtuesve osmanë. Në radhët e mërgimtarëve ishin kryesisht luftërtarë të njohur, me familjet dhe fëmijët e tyre, të cilët largoheshin të kërcënuar prej një hakmarrje të pritëshme të pushtuesit lindor. (2)

Mes radhëve të emigrantëve, që largoheshin nga zotërimet e shumta venedikase në Peloponez, prej Koronit, Methonit, Nafplos, Argosit, etj, dhe shkonin të vendoseshin në Venecja ishin edhe pjestarët e trungut të një familjeje zulmëmadhe arbërore, ata të Buajve. Kjo familje e njohur fisnike arbërore kishte zbritur dhe vendosur në territoret e Peloponezit në mesin e shekullit të XIV prej krahinave të Artës dhe Prevezës. Të parët e tyre kishin lënë gjurmë të pashlyera në historinë e këtyre anëve, të Epirit- Arbërisë jugore, Ballkanit dhe më gjërë. Ndër ta, burri më në zë, ishte padyshim princi arbëror, Gjin Bua – Shpata. (3)

Në turmat e refugjatëve, që linin Morenë, prej bigjeve të Nafplios, në përbërje të familjes së njohur gjendej edhe një fëmijë katërmëbëdhjetë vjecar me emrin Mërkur Bua. (4)

KARJERA E NJË LUFTËTARI ARBËROR TË PAEPUR

Çuditërisht, dokumente dhe kronika të shumta mbushin arkivat francize, gjermane, italiane, spanjolle dhe vecmas ato të Venecjas, me emrin e këtij stratioti të kudondodhur në fronte luftrash. Mes tyre dallohet koleksioni numeroz me raportet e grumbulluara prej historianit venedikas të shekullt të XIV-XV, Marino Sanudo. Aq të shumta janë kronikat për këtë luftëtar arbëror, sa vështirë do të gjendet një figurë e dytë luftëtari aq present në frontet e betejave europine. (5)

Kronikat, vec të tjerave na bëjnë me dije se me të zbritur nga rrugëtimet e largëta të emigrimit, Bua katërmbëdhjetëvjecar ka shkuar menjëherë në frontet e luftimit në territoret e Friulit, në Italinë veriore. Një betejë mjaft e përgjakshme zhvillohej atje kundër forcave turke që i afroheshin kufijve të Republikës së Venecjas. Në këtë betejë të përgjakshme, në aleancë dhe në krah të venecjanëve reshtoheshin edhe disa reparte Stratiotësh shqiptarw – formacione të përbëra nga luftëtarë të ardhur nga Shqipëria dhe Moreja (Peloponezi). (6) Luftimet dhe aftësitë luftarake befasuese të kalorësisë së stratiotëve shqiptarë në këtë betejë tërhoqën aso kohe vëmëndjen e shumë kronistëve europianë dhe mikluan dëshirat për të patur formacione të tilla luftëtarësh në radhët e tyre. (7) Cuditërisht, që në këto kohë Mërkur Bua, megjithëse fare i ri ka habitur shtabet ushtarake me kurajon dhe aftësitë e tij luftarake. (8)

Kështu pati filluar karjera e këtij stratioti shqiptar. Shumë shpejt nga një luftëtar i thjeshtë ai do të fitonte statusin e "Kapostratiotit" "Kapokondotjerit" dhe si i tillë do të kishte në varësinë e tij reparte të tëra luftëtarësh shqiptare prej 200, 400 dhe gjer në 1 500 vetësh. Ai do të ndërmerrte misione të rëndësishme luftarake në shërbim të Venecjanëve dhe më tej në shërbim të Mbretit të Francës, për vite me radhë në shërbim të Perandorit Gjerman, të Papatit, etj. (9)

Ajo që e bën edhe më intriguese figurën e këtij komandanti është fakti se në mbi gjashtëdhjet beteja të zhvilluara nëpër frontet e Italisë dhe Europës ai ka vetëm një të tillë të humbur. Ai është ndoshta ushtaraku me i dekoruar në historinë e fronteve europjanë të luftrave. Trofetë e tij renditen në arkivin personal dhe heraldikën e pasur që ruhen për të. (10)

NJË DOKUMENT I ARKIVIT TË VENECJAS, QË KONFIRMON SE: "AI, BUA ËSHTË SHQIPTAR…"

Në një dokument, që ruhet në Arkivin e Venecias, i datës 23 Korrik 1513, shkruar nga kronisti venecjan Marino Sanudo, i cili ishte dëshmitar okular kur Mërkur Bua hynte i ftuar në Pallatin e Dozhëve në Venecja, thuhet: (11)

*"Mbriti në Kolexhio dominio Mërkur Bua, komandant i trupave të kalorësisë së lehte stratiote të perandorit, erdhi këto caste me rreth 35 (luftëtarë) të soit (kombësisë) të tij. Është i moshuar.... i shkurtër nga shtati. **Ai është shqiptar**, nga Nafplio e Moresë (Peloponezit), i cili në kohën e e luftimeve në Piza merrte rrogën nga ana e jonë.*

Ai ishte i veshur me një saio prej ari dhe një zhupon damasku ngjyrë të zezë. Mbante në kokë një një beretë ngjyrë të zezë prej kadifeje, ndërsa në qafë I varej një gjerdan I madh I trashë prej ari. Ishte i veshur sipas mënyrës francize…."

Sikundër shihet kronisti venecjan, Sanudo, deklaron fare qartë faktin se Mërkur Bua **ishte një shqiptar**, i ardhur nga Nafplio, qytet bregdetar i Pelopnezit, i cili aso kohe dominohej prej popullsisë shqiptare dhe që një pjesë e tyre, pas pushtimit Osman, riemigroi në Venecja.

DOKUMENTI KONFIRMON GJITHASHTU IDENTITETIN E MËRKUR BUAS NË NJË TABLO PIKTORIT LORENZO LOTTO

Por, ky dokumenti na ofron edhe disa të dhëna të tjera me mjaft interes. Sikundër shihet, në reshtat e kronikës, përshkruhet veshja e Kapostratiotit Mërkur Bua. Jo më kot kronisti ka evidentuar veshjen e tij, sepse aso kohe ajo ishte tregues i sërës së fisnikërisë, pra shkallës së lartë që zinte individi në hierarkinë sociale. Dhe, për cudinë tonë, ajo cfarë përshkruan Sanudo, përputheët plotësisht me një portret të një fisniku ("Një burrë fisnik") me mjekër të zezë, që gjithmonë është dyshuar apo hamëndësuar së duhet të jetë portret i Mërkur Buas, portret i punuar nga piktori i famshëm i Rilindjes italiane, Lorenzo Lotto, që ruhet në "Galleria Borghese" në Romë. (12)

Tani që kemi shtënë në dorë dokumentin e Sanudos, shohim se përshkrimi që i bën kronisti venecjan "Mërkur Buas që hyn në Colegio" vërejmë se ai përputhet plotesisht me paraqitjen dhe veshjen që ka burri i hamëndësuar si Mërkur Bua në portretin me ngjyra të Lottos. Kështu:

- Burri në tablo është i veshur në të zeza, edhe kronisti venecjan shkruan se *"Mërkuri është i veshur në të zeza",*

- Në tablo shohim se burri mban në kokë një kapelle kadife ngjyrë të zezë, edhe Mërkur Bua i përshkruar nga kronisti venecjan Marino Sanudo



Vene in Colegio domino Mercurio Bua capitanio di stratioti e cavali lizieri di l' Imperador, venuto hora di qua con zercha 35 di soi. È di età anni . . . , bel aspeto, picolo, di nation di Napoli di Romania, albanese, el qual al tempo di la guerra di Pisa si partì dil nostro stipendio. Era vestito con un saio d' oro et uno zupon damaschin negro, una bareta di veludo negro in capo, et una grande e grossa cola-dena d' oro al collo, vestito a la francese, e li soi ben in ordine e di seda et la † biancha a la banda dextra, ch' è hora la nostra insegna e di Franza, che prima si portava la † rossa. Fo carezato dal Principe et
. . . . . ,

"mban në kokë një kapelle kadifeje ngjyrë të zezë",

- Referuar tablos, vihet re fakti se veshja e burrit të hamëndësuar si Mërkur Bua nuk është ajo e modës venecjane të kohës, - edhe kronisti venecjan Sanudo na thotë se "*Mërkuri është i veshur sipas modës ala Franceze*"

- Duke e parë me vëmëndje portretin e burrit në tablon me ngjyra konstaton faktin se ai është shtatshkurtër, ashtu sikundër e përshkruan Sanudo në kronikën e tij.

- Një tjetër e dhënë që na vjen nga burime të tjera dokumentare të kohës, kur kronistët flasin për stratiotët shqiptarë i përshkruajnë ata *"me ca mjekra të dëndura dhe të zeza që të kallin frikë..."*, i tillë është edhe portreti i burrit në fjalë, ka imazhin e një stratioti tipik, sikundër përshkruhet luftëtarët shqiptarë nga kronistët e kohës.

Në këto kushte mund të themi se kronika e Marino Sanudos konfirmon bindshëm faktin se "Portreti i burrit fisnik", të piktorit Lorenzo Lotto, është shqiptari Mërkur Bua.

Mërkur Bua vdiq në moshen 70 vjecare në Trevizo, ku kaloi pleqërinë e tij, dhe u varros në kishën e Santa Maria Maxhores të këtij qyteti. [13]

Mërkur Bua – Tablo e piktorit Italian të Rilindjes, Lorenzo Lotto.

XHANE NGA KORONI STRATIOTI DHE POETI ARBËROR QË SHKROI PËR KOMANDANTIN E TIJ

"*Mërkur Bua nuk ka më pak fitore dhe akte të lavdishme sesa Pirrua i Epirit apo Aleksandri i Madh. Po përse mbeten këta luftëtarë në histori? Sepse dikush shkroi për ta. Nëse dikush nuk do të kishte shkruar ata me siguri do të ishin haruar ...."* Kështu shkruan në parathënien e kronikës poetike dedikuar Mërkur Buas, një luftëtar arbëror i repartit të tij, Xhani nga qyteti i Koronit në More. *"Atëhere përse të mos shkruaj edhe unë për bëmat e këtij burri të lavdishëm?"*- përfundon Xhane. [14]

Ky është motivi që Xhane është ulur dhe ka shkruar kronikën në trajtën e një poeme epike, të bëmave për komandantin e tij Mërkur Buan. Për fatin tonë ajo ruhet ende në dorëshkrim, në gjendje të mirë, në arkivat italiane. Ne kemi marë një kopje të saj. Poema përbëhet nga 291 faqe. Ajo është e shkruar në gjuhën greke (kujtojmë se greqishtja dhe latinishtja ishin dy gjuhët në të cilën shkruanin europianët ato shekuj) dhe ruan pothuaj në tërë shtrirjen e saj gjashtëmbëdhjetë rrokshin. Vargëzimi i takon rimës klasike "a" - "a"; "b" – "b". [15]

Poeti përmes vargut ruan rrjedhat e ngjarjeve dhe të betejave të Buas nën një kronikë korrekte kohore historike. Si e tillë poema ka shërbyer dhe do të shërbejë edhe në të ardhmen si një dokument me vlera unike historike për shkrime dhe hulumtime të mëtejme dedikuar këtij luftëtari. [16]

Në të, poeti rendit trembëdhjetë nga betejat më të rëndësishme të Buas, duke na sjellë informacione me shumë vlerë për Mërkur Buan dhe luftëtarët e tij shqiptarë në frontet e luftrave nëpër Europë, si dhe mjaft të dhena të tjera me inters historik të panjohura gjer më tash. Për to do të flasim me hollësi në botimin e hollësishëm që do ti ofrojmë publikut së shpejti.

POET DHE PIKTOR I NGJARJEVE TË KOHËS.

Mes informacioneve të shumta për beteja, aleanca, luftëtarë të panjohur shqiptarë, monarkë, robër, humbës dhe fitimtarë - Xhane, na bën me dije për titujt dhe gradat që ka fituar ky luftëtar i njohur i fushbetejave nëpër Europë. [17]

Bashkë me to, në faqet e poemës (dorëshkrimit), ruhen në origjinal edhe një numur akuarelesh të punuara në miniaturë nga dora e vetë poetit, duke shpalosur kështu edhe një vyrtyt dhe mjeshtari që gëzonte Xhane – atë të piktorit. Ndër akuarelet e punuara prej poetit renditen ato që paraqesin një numur flamujsh, trofe, stema dhe heraldikë të rëmbyera kundërshtarëve të mundur, apo të dhuruara nga mbretër dhe perandorë, për kontributet e tij në fitoret e aritura. Mes tyre gjenden gjithashtu skena luftrash, koka të prera turqish, si edhe stemat e familjes arbërore të Buajve, të cilat vetë poeti i identifikon dhe sqaron me detaje kuptimin dhe mesazhet që ato mbartin. [18]

Veç faktit që Xhane ishte luftëtar i reparteve të Mërkur Buas, që ai ishte shqiptar nga Koroni i Moresë (Peloponezit), që pati emigruar në Venecja së bashku me Buan, që në disa raste shfaqet si sekretar i Kapostratiotit të tij, Mërkurit, që jetoi për disa kohë në Venecia dhe Trevizo, si dhe dëshmisë noteriale, ku përmëndet si palë në një kontrate juridike, nuk kemi të dhëna të tjera për këtë poet dhe kronist me interes mjaft të madh për historinë dhe letërsinë tonë. Le të shpresojmë se në të ardhmen, kërkimet do të sjellin të tjera dëshmi me interes për këtë personalitet me vlera të vecanta dhe kontributet e tij në fushën e historisë dhe të letrave shqipe.

Punime në akuarel të poetit arbëror Xhane nga Koroni i Moresë (Peloponezit).

Dje ishte ditëlindja e Asdrenit
11 prill 1872

A mund të ndreqet ky “mëkat” i Asdrenit?

Nga Emil Lafe

Një “mëkat” i Asdrenit

Rasti më i ri kur kam dëgjuar nga afër Himnin e Flamurit të kënduar nga një kor, ka qenë më 21 nëntorin e shkuar, ditën e hapjes së Kuvendit Kombëtar për Gjuhën shqipe në Pallatin e Brigadave.

I kisha përballë dhe fare pranë vajzat dhe djemtë e Liceut Artistik “Jordan Misja”, që e kënduan me shumë ndjenjë e ngazëllim zemre, ndoshta për herë të parë në atë sallë dhe përpara kryeministrit.

Te vargjet 5-6 të strofës së parë:

Prej lufte veç ai largohet
Që është lindur tradhëtor...

vajzat dhe djemtë e korit dhanë gjithë frymën dhe frymëzimin e tyre për të arritur atë *kreshendo,* siç quhet në gjuhën e muzikës, dhe që kulmon te fjala **tradhëtor**. E kënduar te himni ynë ajo kumbon aq solemne, aq madhështore, aq sublime, saqë të duket sikur nuk është fjala për tradhëtorin, po për të kundërtën e tij, për trimin që vdes si hero legjendar duke mbajtur betimin që ka bërë mbi të shenjtin e të shenjtëruarin *“O flamur gjak, o flamur shkabë, O vend e vatr’, o nën’ e babë!”*. Pse duhet ta kemi dhe ta ekzaltojmë në himnin tonë (që është më parë një himn kombëtar i gjithë shqiptarëve e pastaj edhe i shtetit) fjalën **tradhëtor**? Kjo pyetje më ther së brendshmi sa herë e dëgjoj dhe më shkon mendja ta quaj **Një mëkat i Asdrenit.**

Dihet se teksti i himnit tonë është frymëzuar nga kënga patriotike rumune “Pe-al nostru steag e scris unire” (“Në flamurin tonë është shkruar bashkimi”), për të cilën shkroi muzikën kompozitori Ciprian Porumbescu (1853–1883):

Acel ce-n luptă grea se teme
Ce singur e rătăcitor,

shqip:

Ai qe ka frike nga lufta e rrepte
Eshte vetem endacak (d.m.th. pa atdhe)

Për këtë “mëkat” të Asdrenit ka rënë fjala edhe në raste të ndryshme me kolegë filologë, po edhe me njerëz të muzikës. E kemi njohur si një “cen” të himnit tonë dhe që “s’ke ç’i bën”! Por duke vrarë mendjen se si mund të kapërcehet ky cen, ka dalë edhe një propozim, që kam dëshirë ta bëj të njohur për atë që quhet “opinioni publik” e veçanërisht për njerëzit e botës së letrave e të muzikës:

Prej lufte kurrë nuk largohet
Kush është lindur arbëror!
Kush është burrë nuk frikohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor!

Ose, për të shmangur përsëritjen *kush ... kush* në krye të vargjeve 2 e 3:

Prej lufte kurrë nuk largohet
Ai që lindet arbëror!
Kush është burrë nuk frikohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor!

dhe kështu ai kumbim aq solemn, aq madhështor, aq sublim i muzikës së atij vargu, tani i vishet fjalës **arbëror**, emrit të popullit tonë në kohën e Motit të Madh, prej nga na vjen edhe Flamuri që kemi, prej nga na ka ardhur edhe frymëzimi e guximi për një “Shqipëri të lirë e të mosvarme”.

Sikur t’i kishte shkrepur në mendje Asdrenit fjala ***arbëror*** kur shkroi tekstin e këngës ”Betimi mbi flamur”, sa bukur e sa madhështor do të tingëllonte himni ynë, që i këndon simbolit të bashkimit, të krenarisë, të vendosmërisë e të qëndresës së paepur! A mund të ndreqet ky “mëkat” i Asdrenit? Them se e kemi lejen dhe mirëkuptimin e tij për ta ndrequr! Duhet pak vullnet i mirë ndërmjet nesh dhe mirëkuptim e interesim edhe nga institucionet që kanë tagrin për veprimet ligjore.

Himni Kombëtar Shqiptar

Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshir` e një qëllim,
Të gjith` atij duk` ju betuar
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ai largohet
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk friksohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor!

Në dorë armët do t`i mbajmë
Të mbrojmë atdhenë më çdo kënd,
Të drejtat tona ne s`i ndajmë;
Këtu armiqtë s`kanë vend.
Se Zoti vetë e tha me gojë
Që kombet shuhen përmbi dhe,
Po Shqipëria do të rrojë;
Për të, për të luftojmë ne!

O flamur, flamur, shenj` e shenjtë,
Te ty betohemi këtu,
Për Shqipërin` atdhen` e shtrenjtë,
Për nder` edhe lavdimn` e tu.
Trim, burrë quhet dhe nderohet
Atdheut kush iu bë theror;
Për jet` ai do të kujtohet
Mbi dhe, nën dhe si një shenjtor!



Një punim krahasimtar mes tregimit të E.Koliqit dhe M.Rousia

MITI I SHTOJZOVALLES

Nga Xheni Shehaj

Teksa përhumbesha në një antologji me tregime qipriote, ndesha në një autore të panjohur. Tregimi i saj kishte ngjashmëri të mëdha me tregimin e Ernest Koliqit, "Nusja e mrekullueshme". Ç'është e vërteta nuk ka ndonjë gjë të pazakontë në lëvrimin e motiveve të ngjashme, që motive të njëjta të gjejnë vend në librat e autorëve të ndryshëm. Sigurisht, çdo shkrimtar ka stilin, veçantinë dhe mënyrën e tij se si e trajton një tematikë. Edhe pse motivi mund të jetë universal, janë rrëfimi, forma se si ndërtohet ngjarja, personazhet, dialogjet që e bëjnë unik një tregim.

Por para se të ndalemi tek analiza e dy tregimeve në fjalë (*Nusja e mrekullueshme*[1], Ernest Koliqi) dhe (*Kur shtojzorreshta vdiq*,[2] Maria Rousia) do të japim shkurtimisht disa të dhëna për autoren qipriote (për Koliqin nuk e shohim të nevojshme pasi është mjaft i njohur nga lexuesit) duke qenë se është pak e njohur dhe besojmë se ka nevojë për një hyrje.

Maria Rousia

Lindi në Kajro më 1894 nga prindër me origjinë qipriote. Një pjesë të fëmijërisë e kaloi në Italinë e Veriut. Më pas u vendos në Aleksandri ku kaloi pjesën tjetër të jetës. Botoi tregime, novela publicistikë. Publikoi artikuj në një gazetë në Aleksandri të quajtur "Tahidromos" mbi çështjet sociale. Ajo shkroi artikuj mbi vendin e grave në shoqëri, mbi edukimin si dhe analiza letrare.

Mori pjesë si infermiere vullnetare në Luftën e Dytë Botërore, në armatën greke, në Lindjen e Mesme. Shkroi letra frymëzuese që i dërgoheshin ushtarëve që luftonin në front. Disa letra të tjera u publikuan nën titullin "Motër e ushtarit". Mes viteve 1939 dhe 1956 bashkëpunoi me revistën "Letërsia qipriote" në të cilën publikoi 26 histori.

Thënë këto nuk na mbetet gjë tjetër veçse të ndalemi në analizën e dy tregimeve. Motivi i shtojzovalles, motiv i përdorur gjerësisht në letërsi, duket se bën pjesë në kategorinë e motiveve universale. Shtojzovallet nuk janë pjesë vetëm e maleve tona hijerënda. Por le ta shohim më konkretisht se si ky motiv gjen vend në prozën e Koliqit dhe të Rousias.

Të përbashkëtat mes dy tregimeve:

- Po ja nisim me rrëfimin duke qenë se është gjeneza e një krijimi. Si Koliqi ashtu edhe Rousia kanë zgjedhur ta rrëfejnë ngjarjen në vetën e tretë. E kjo, si për të treguar se kur vjen fjala tek mitet, ato kalojnë gojarisht dhe nuk dihet kush është rrëfyesi fillestar.

- Personazhi kryesor në të dyja tregimet është një djalë. Koliqi ka zgjedhur Lekë Binakun, i cili kur ishte 15 vjeçar dilte në mal për të kullotur dhitë. Rousia, po ashtu ka si personazh kryesor një djalë 15 vjeçar, Jorgjin, i cili ngre çarqe e kurthe për zogjtë. Historia e dy personazheve fillon kur ata janë ende tepër të rinj, mustaqepadirsur. Ndoshta sepse ishte më e lehtë që djelmoshat të "binin" pre e perrive duke qenë të parritur, të pa mësuar, të njomë. Si Leka ashtu edhe Jorgji ndeshen me shtojzovallet gjatë kohës që ata ndodhen në natyrë duke gjuajtur. Kjo shkakton tek djemtë frikë, habi. Të ndodhur në rrethana të pazakonta, ata e përjetojnë thuajse njëlloj ndjesinë e takimit me shtojzovallet.

Përshkrimi i shtojzovalles

Një ngjashmëri e dukshme mes dy tregimeve është përshkrimi i shtojzovalleve. Në mitologjinë tonë, shtojzovallet janë vasha shumë të bukura, të pajisura me fuqi të mbinatyrshme, që rrojnë në bjeshkë e pyje dhe e kalojnë kohën me këngë e valle. Nëse do ti referohemi përshkrimit të mësipërm do të duhej konsideruar fat i bardhë takimi me një shtojzovalle. Por nga përfundimet e dy tregimeve, nuk rezulton kështu.

Ja si e përshkruan Koliqi shtojzovallen:

"Doli tue kërcye një dhi e egër, për mrekulli e bardhë. Dhia e shikoi me dy sy të thellë njerëzorë: mandej kapi një shpat malit dhe u zhduk si vetëtima. Sa i kaloi habia e parë, gjuetari joshi qentë idhnueshëm, i nxiti dhe iu vu mbrapa me tanë shpejtësinë që kishte. U hodh pa frymë mbi një rudinë të ngushtë dhe e pa dhinë e bardhë kah futej në një kaçubë të madhe kaçash në lulëzim. Shtiu dy herë dhe u vërtit me pa. E, qe, nga gjethet e lulet e kësaj del, me buzë në gaz, një vashë e bukur për mrekulli, curilat e artë lëshue mbi supa të krahëve".

Ndërsa autorja qipriote e përshkruan shtojzovallen më njerëzore. Koliqi i ka dhënë shtojzovalles së vet fuqi mbinatyrore, ajo shndërrohet në dhi, pastaj në vashë. Ndërsa Jorgji teksa i rrëfen së ëmës për perrinë që ka takuar ia përshkruan kështu:

"Nuk e di, moj nënë, ç'ishte. Vajzë nga ndonjë fshat këtupari apo shtojzovalle. E di që s'më gënjejnë sytë. Ajo ecte ngutthi para e unë e ndiqja nga pas. Këmbët erë, nuk i preknin tokë. Fytyrë hënë, ndrinte. Gërshetat thurur, deri në fund të këmbëve... Të zeza si dy gjarpërinj... Veshur në të bardha...".

Vihet re se ka pak ndryshime mes dy shtojzovalleve përveç faktit që të dyja janë të veshura me të bardha. Ajo e Koliqit duket si bijë e diellit, flokë të verdhë, të gjata deri në supe, e bardhë. Shtojzovallja e përshkruar nga Maria është bijë e hënës, me gërsheta të gjata, të zeza. E përbashkët padiskutim që është bukuria e rrallë që shkrimtarët i kanë veshur shtojzovalleve.

Tjetërsimi i personazhit kryesor

Pas takimit me shtojzovallen si Leka edhe Jorgji ndryshojnë. Nuk janë më të njëjtit. Ky ndryshim bie në sy tek familjarët, miqtë.

"Gjint e shpisë, tue pa djalin kryekëput të ndërruem, nisën me u ba vesvesë. Leka fliste rrallë, tretëte shpesh në bisedë, kërkonte vetminë, u ikte shoqnive të vjetra".

Edhe Jorgji pas takimit me shtojzovallen ndryshoi.

"Asaj nate mori ters dhe djali u kthye duarbosh, i verdhë meit, dridhej si lapurak. Djali, lënë e harruar në ëndrra e kujtime, i kish vënë fletë gojës dhe nuk bëzante. Sytë në terr, duart vënë kryq para gjoksit, larë në djersë".

Natyrisht që figura më e afërt në këtë rast është nëna. Autorët kanë përdorur personazhin e nënës për të çliruar nga gjendja e shokut djemtë. Shqetësimi i nënës, më i sinqerti, vjen e kthehet në pyetje, këmbëngulje për të mësuar se çfarë shkaktoi ndryshimit e birit. Leka i rrëfen së ëmës që është martuar me një shtojzovalle. Jorgji i thotë se ka parë një shtojzovalle. Të dy personazhet rrëfehen përpara nënës pa marrë parasysh pasojat që mund të vijnë. Leka e dinte se nëse do të fliste me dikë "ndëshkimi do të ishte i rreptë dhe i shpejtë".

Figura e priftit

Një tjetër ngjashmëri mes dy tregimeve është dhe prania e figurës së priftit. Prifi luan një rol të rëndësishëm në grigjën e tij të besimtarëve. Te "Nusja e mrekullueshme" Don Marku, ka një rol kyç gjatë rrëfimit, është ai që i tregon rrëfyesit historinë e Lekës. Edhe në tregimin e Marias, prifti zë vend të rëndësishëm. Besimi se duke iu kushtuar Perëndisë, e keqja do të kalonte ishte tejet i fortë. Nëna e Jorgjit i qan hallin igumenit plak dhe ai e këshillon se çfarë duhet të bëjë:

"Ngujoe djalin në Manastirin e Shën Mërisë. Shën Mëria bën çudira dhe do ta shërojë djalin tënd".

Forca e besimit ishte aq e madhe ndër ta sa gjithçka mund të zgjidhej duke besuar, adhuruar dhe duke u lutur.

Ndëshkimi

Egjithë rrjedha e dy ngjarjeve ka një vijë logjike se si shtjellohet. Dy djem, gjahtarë, njëri gjuan ditën, tjetri natën. Ndeshin në udhën e tyre shtojzovalle. Deri në këtë pikë duket se rrëfimet shkojnë paralel. Ndryshimi nis kur subjektet marrin një shtjellim më të gjerë e kjo lidhet me vazhdimësinë e pas takimit me shtojzovallet. Pra, çfarë ndodh pasi Leka dhe Jorgji janë ndeshur me vashat. Shtojzovallja e Lekës i kërkon atij të martohen. Por martesën e tyre ai duhet ta mbajë të fshehtë, në të kundërt do të ndëshkohet. Leka nuk arrin të ruajë sekretin e për pasojë dënohet me memecëri.

"Jam martue me një shtojzovalle e për natë bie me të". Dhe ia kallzoi fill e për pe martesën e çuditshme. Por, sa mbaroi tregimin, nisi me u mbrapshtue ndër fjalë. Ep e merr për me qitë zanin: s'asht punë e mundun. I ishte marrë goja. Qyshë atë ditë gjuha si punon ma...".

Shtojzovallja që hasi Jorgji nuk bëri asnjë kërkesë. Ishte vendosmëria e djalit për t'iu vënë pas e për ta bërë robinën e tij. Për pasojë, ndëshkimi i Jorgjit ishte më i rëndë. Ai u dënua me vdekje. Jetoi edhe një vit më vonë dhe sa hapi sytë zemra i pushoi së rrahuri.

Një tjetër ndryshim që vihet re është mënyra se si del nga rrëfimi figura e shtojzovalles. Koliqi e zhduk si me magji praninë e saj që në çastin që Leka humb aftësinë për të folur. Që prej atij momenti, lexuesi nuk e ndesh më shtojzovallen përgjatë tregimit. Ndërsa Rousia lë të hapur një shteg që krijon shumë mundësi. Jorgji "përleshet" me shtojzovallen duke ndjekur këshillën e gjyshit që nëse e kap e vërtit, e bën robinjën tënde. Djali ishte i vendosur për ta zënë vashën që i kish marrë mendjen. Por nuk ia doli teksa përlahej me të. E kështu, Jorgji natën e përleshjes me të humbi mendjen. Pastaj ra në gjendje kome për një vit, e kur hapi sytë pas një viti zemra i ndali së punuari.

Po atë natë, në bregun e lumit ku Jorgji ish përleshur me shtojzovallen, u gjet e vrarë e bija e çobanit.

"Dhe, tek e ngjisnin lart, i vareshin si dy gjarpërinj uji dy gërshetat e saj të shthurura".

Maria Rousia, hedh një hipotezë interesante: A kish parë Jorgji vërtet shtojzovalle apo në të vërtetë kish parë vajzën e bukur të çobanit? Koliqi zgjodhi të mbetej tek miti. Maria Rousia përdori simbolikën e mitit për të përcjellë mesazhin e saj mbi edukimin e shoqërisë. Jorgji kërkoi ta dominonte shtojzovallen, e goditi atë, e vrau e për pasojë gjeti vdekjen...

[1] "Hija e maleve", Ernest Koliqi, Shkodër, Camaj - Pipa, 1999.

[2] "Antologji e tregimit qipriot", Albin, Tiranë, 2003.

Mihal Hanxhari, një poet ndryshe

Nga Agim Vinca

(Vijon nga numri i kaluar)

Arketipi i dashurisë

Pjesa dërrmuese e poezive të Mihal Hanxharit trajton, në mënyra të ndryshme, temën e dashurisë. Erosi është, siç do të thoshte Rolan Barti, mitemë e krijimtarisë së këtij poeti. Këtë temë poeti e trajton në vjershat: *Gjersa erdhi* (që në një version tjetër haset me titullin *Të kam menduar*), *Pa ty, Ashtu ndofta ka filluar jeta, Dëgjoj një zog, Zemrën marr në duar, Natën vonë, Pranverë e dashurisë, U dashuruam, Trëndafili, Kur ti fle, Fjeta mbi rërë, Ku janë ato net, U ndezën diejt e shuar, Të mos zgjohesha kurrë, Konstelacion, Zambak deti, Re të zeza, Të jesh vetëm, Mesi i natës, Ti shkon ngadalë, U ktheva përsëri, Ti ankora ime, Pa thënë një fjalë, Veç një pranverë, Si ikën betime, Digjet në heshtje, I mjeri më i lumtur* e shumë të tjera. Për dashurinë poeti këndon me zemër në dorë, si thuhet në njërën nga poezitë e tij më të bukura të dashurisë: *Zemrën marr në duar*. Shprehja "me zemër në dorë" në gjuhën shqipe do të thotë: me ngrohtësi, çiltërsi e dhembshuri, por edhe me frikë se mos ndodhë diçka jo e mirë, me ankth.

Dashuria është muza e poetit; është ajo që ia zgjedh ngjyrat për pikturat dhe fjalët për poezitë; është ajo që e shpie buzë lumit "për të gjetur gurët si zemër" dhe buzë detit (dekor i përhershëm i frymëzimit erotik të poetit) "për të shkruar në rërë një emër"; është ajo që e bën të mjerë e të lumtur; është ankora që e lidh me fundin e detit. Kjo "muzë-grua" a "grua-muzë" vjen natën, sepse nata është e poetit, i cili përfytyrohet rëndom si "sonambul", siç shprehet poeti ynë në vjershën homonime, në të cilën kuvendon me hënën që noton mbi ujëra te ura e vjetër.

Në poezinë e Mihal Hanxharit nuk përmendet asnjë emër konkret gruaje, me përjashtim të Evës, personazhit të skicës *Ndizemi e shuhemi*, ku flitet për një dashuri të hershme të Mihalit (në këtë rrëfim autobiografik, krahas emrit të vajzës, Eva, shfaqet edhe emri përkëdhelës i autorit, Misha) me një vajzë hungareze gjatë kohës së studimeve në Budapest. Nuk e dimë në është kjo "dashuria e tij e madhe", "prelud i një lumturie të këputur në mes"[1], por meqenëse përmenden "studimet universitare", kjo duhet të jetë.

Për Mihal Hanxharin e edukuar në frymën e traditës më të mirë të poezisë shqipe dhe asaj botërore, sidomos franceze, dashuria nuk është thjesht pasioni për një grua, por shumë më tepër. Edhe pse në vargjet e tij nuk mungojnë, herë-herë, elementet sensuale, dashuria për të është, sikurse jeta, një mister; e tillë çfarë është edhe Gruaja, një qenie që njëjtësohet me Botën.

Ndoshta ti dhe Bota ishit një për mua
Dhe qiell e diell e stinë e mot
Unë pija jetën në buzët e tua
Kërkoja në gjirin tënd atë që s'gjendet dot
Ndoshta ti dhe Bota ishit një për mua

Gruaja për të cilën këndon Hanxhari qëndron mes gruas konkrete, tokësore, reale dhe qenies sublime, eterike, astrale. Një koncept pak a shumë i ngjashëm me atë të Lasgushit. Gruaja dhe Bota për të janë një: burim jete dhe mister.

Poetë të mëdhenj si Dante, Petrarka, Pushkini, Leopardi, Aragoni kanë kënduar për Beatriçet, Laurat, Anat, Silvat dhe Elsat e tyre reale, italiane, ruse ose franceze, të cilat me vargjet e tyre gjeniale i kanë bërë të pavdekshme, kurse poeti shqiptar Mihal Hanxhari, ky beqar i përjetshëm, ia blaton këngën e tij një femre të paemër, ekzistencën e së cilës, herë-herë, e vë në dyshim. *"Ndoshta ti s'ke ekzistuar/ Ndoshta ka qenë vetëm fantazia ime/ Ndoshta je imazh i ëndërruar"* - shprehet poeti në njërën nga poezitë e tij, që mban titullin *Ndoshta ti s'ke ekzistuar.*

Dashuria në vizionin e poetit Mihal Hanxhari, sikurse te pararendësit e tij (Naimi, De Rada, Serembe, Lasgushi), është e pandarë nga vuajtja dhe dhembja, e shkaktuar nga largësia dhe mungesa e së dashurës: *"Si iku kjo verë pa njëri-tjetrin"; "Si po ikën kjo jetë pa njëri-tjetrin"*, apo edhe për arsye të tjera, të njohura e të panjohura.

Librin *Ti vdekja ime mbushur me jetë*, pjesën dërrmuese të të cilit e zënë poezitë e dashurisë (gjithsej 57 sosh), Hanxhari e hap me një strofë të Arshi Pipës, në të cilën thuhet: "*Timonieri ynë asht fati/ Velat tona dashunia/ Për me vuejtë jemi ba gati/ Jemi nisë kah bukuria!*".

Kjo strofë, e vënë si moto në krye të librit, luan rolin e paratekstit, që shenjon orientimin tematik të poetit dhe shpreh konceptin e tij për poezinë. Hanxhari është, në radhë të parë, siç e ka cilësuar miku i tij i afërt, Zef Rrakacolli, poet i Dashurisë, i Dhimbjes dhe i Bukurisë. Mund të thuhet, prandaj, se koncepti i tij për poezinë është i ngjashëm me atë të simbolistëve, sipas të cilëve poeti s'është tjetër veçse një njeri që zbulon "fshehtësitë e jetës" dhe i këndon Bukurisë, e cila është burim i dhimbjes dhe pikëllimit. Gjakimi i së bukurës dhe i dashurisë vë në lëvizje imagjinatën poetike, kurse kërkimi i tyre në art dhe në jetë kalon shumë herë nëpër purgatorin e vuajtjes dhe të pësimit.

Poema *Aldebaran*, me të cilën hapet libri në fjalë, është cilësuar me të drejtë si një himn kushtuar dashurisë. Dashuria është ndjenja më e fuqishme e shpirtit njerëzor, universale në kohë dhe në hapësirë, ashtu siç është Aldebarani ylli më i ndritshëm i yllësisë së Demit (shenja e dytë e Zodijakut), që përbëhet nga gjithsej 126 yje. Për ta bërë më të qartë simbolikën e kësaj figure, të shtojmë se Aldebarani, ndonëse shumë larg nga planeti ynë, Toka (65 vjet drite larg), shihet me sy natën dhe duket sikur ndjek Yllësinë e Plejadës, që personifikon principin femëror, kurse në disa qytetërime është edhe simbol i flijimit.

Nuk ka dyshim se Aldebarani është në këtë rast simbol i Dashurisë, që vë në lëvizje universin - tok me njeriun si shëmbëlltyrë e tij - dhe krijon baraspeshë mes tokës dhe qiellit. Dashuria është e pavdekshme si koha dhe pavdekësinë e saj, sipas poetit, më parë se arti, e shpreh natyra, universi. Në natën e qetë, kur dëgjohet muzika e erës dhe e detit, shpirti i njeriut arratiset lart në qiell, tek ylli Aldebaran.

Fjala është për një krijim me përmbajtje dhe strukturë polivalente, që përbëhet nga tetë këngë të shkruara në vargje 12-rrokëshe dhe strofa pesëvargëshe të rimuara sipas skemës ABBAA, ku vargu i parë i secilës strofë përsëritet në fund të saj,[2] skemë kjo që poeti i përmbahet nga fillimi deri në fund.

O natë erdh muzika zbathur nëpër erë
Deti nisi zërat me gjemit' e tia
Këngë o këngë ku mbytet dashuria
Shpirti rri i zgjuar dhembjen ve të flerë
O natë erdh muzika zbathur nëpër erë

Nata dhe muzika, siç shihet që nga kënga e parë e poemës, që shërben si një prolog, janë dy koncepte pa të cilat nuk mund të merret me mend dashuria. Shtegtimi në qiell fillon nga toka dhe përfundon po aty: "*Pas çdo shtegtimi vijmë sërish në skelë*".

Hipur mbi krahët e fantazisë, në këngën e dytë, poeti shëtit në brigjet e Nilit, pranë piramidave të lashta madhështore, aty ku dashurinë e ka përjetësuar në gur faraoni Tutankhamon.

Natën ma sjell deti aty tek ballkoni
Një dashuri të hidhur të largët antike
Një dashuri shkretëtire të fshehtë e besnike
Dashurinë e vetme që kish Tutankhamoni
Natën ma sjell deti aty tek ballkoni

Për dashurinë dhe fshehtësitë e saj, sipas poetit, më mirë se papiruset, flasin gurët. (*Ata gurë të Nilit e dinë historinë*). Nga brigjet e Nilit, që ndryjnë në vete shumë histori dashurish dramatike, poeti zbret në brigjet e Egjeut, aty ku ka jetuar poeti i parë i botës, Orfeu, që s'pushon së kërkuari Euridikën e tij.

Në këngën e tretë, ku secila strofë fillon me fjalën Dashuri (me "D" të madhe), bëhen përpjekje të përkufizohet dashuria; të tregohet se ç'është ajo. Dashuria është "si lumi që derdhet në det", "si nata që s'di ç'është gjumi"; dashuri është "hëna që thyhet në gjethe" dhe "Aldebarani që digjet në ethe"; dashuri janë sytë, duart, buzët dhe "një e trokitur natën në derë".

Edhe kënga e katërt hapet me imazhin e detit dhe të natës, që zgjon ndjenjën e *mallit*, fjalë që arbëreshët e përdorin edhe sot në vend të fjalës dashuri. Ndërfutet, paksa i modifikuar, vargu i parë i *Milosaos*: *"Lis jeta e Poetit në ujë të kaltëruar"*.[3] Sistemi i të shprehurit poetik ruhet edhe këtu, në atë mënyrë që secila strofë hapet dhe mbyllet me togfjalëshin: "Ja deti...". Dëgjohet kënga magjepsëse e sirenave, ndërsa Odiseu i lidhur për direkët e anijes përpiqet t'i bëjë ballë tundimit...

Këngët vijuese, e pesta, e gjashta, e shtata dhe e teta, shpërfaqin, sikurse edhe të mëparshmet, aspekte të ndryshme të objektit të këngëtimit, yllit Aldebaran, që është sundues absolut i shpirtit të poetit. (*O Aldebaran ti ylli im i vetëm*). Ai është kudo: në tokë e në qiell, në det e në lumë, në rërë e në shkretëtirë... Me të poeti identifikohet plotësisht: "*O Aldebaran jam binjaku yt*" (f. 31).

Poema *Aldebaran* është krijimi më i gjatë poetik i Mihal Hanxharit. Ajo përbëhet nga gjithsej 355 vargje, të kompozuara në një tërësi kuptimore prej tetë njësish. Nuk besoj të jetë e rastit kjo ndarje e poemës në tetë pjesë (formalisht ato ndahen me nga një yllëz në mes), ngaqë Hanxhari si krijues me njohuri nga astronomia do ta ketë ditur se numri tetë është numër që shpreh "harmoninë kozmike".[4] Emri i yllit Aldebaran vjen nga arabishtja dhe ka kuptimin "ndjekës". Besohet se ai ndjek yllësinë e Plejadës, prandaj, sado spekulativ që mund të duket ky pohim, numri tetë në këtë rast - në poemthin erotik tetëpjesësh të Hanxharit - sugjeron shtatë yjet e Plejadës plus Aldebaranin si ndjekës i tyre.

Më shumë se me numrin e vargjeve dhe vëllimin e saj, poema në fjalë imponohet me gjerësinë e përmbajtjes, me thellësinë e mendimit, me shumësinë e metaforave dhe simboleve, me rrezatimet e shumta asociative dhe me strukturën e saj kompozicionale, solide në çdo pikëpamje. Si formë letrare *Aldebaran*-i mund të quhet poemë lirike meditative, pse jo edhe filozofike, që me frymën e saj ezoterike ta kujton *Bukurinë* e Naimit dhe sidomos *Vallen e Yjve* të Lasgushit, veçse është pak më e rëndë për lexim se të parat dhe kërkon angazhim më të madh nga lexuesit.

Aldebaran-i është nga ato krijime poetike që nuk shijohen që në leximin e parë.

I njëjti konstatim vlen, madje akoma më shumë, edhe për poemthin *Menhir*, që është mbase krijimi më kompleks i poetit.[5] Në shënimin e vënë në fusnotë (nga botuesi) lidhur me titullin e tij jepet ky shpjegim: *"Gur i lartë, zakonisht i pagdhendur, i drejtë, që përdorej në monumentet neolitike, i vetmuar ose pjesë e një rreshti ose rrethi"*. Poet me kulturë, Hanxhari solli në poezinë shqipe tema dhe simbole, që nuk hasen te poetët e tjerë. Menhirët janë gurë të mprehtë, që vihen pranë ose sipër varrit dhe që, sipas besimit, luajnë rolin e rojtarit të varrezës. Te keltët ata janë ngritur për nder të njerëzve të mëdhenj: priftërinj, poetë, profetë. Simbolika falike është po ashtu, sipas antropologëve, një nga kuptimet e mundshme të gurit prehistorik me emrin "menhir".

Nuk është aspak i lehtë deshifrimi i kësaj figure te Hanxhari. *Menhir*-i është një krijim poetik jolinear, ku mbresat, impresionet, ndjesitë dhe imazhet derdhen si në një ujëvarë. Subjekti lirik rrëfen udhëtimin e tij imagjinar vetë i dytë (*Kur u ngjitëm të dy për herë të parë mbi kodër*) në një kohë dhe hapësirë të papërcaktuar. Deti, rëra dhe retë janë tri figurat-bazë të tekstit poetik, që personifikojnë tri dimensione të kozmosit: tokën, ujin dhe qiellin. "*Rërë det e ré/ Menhirin e dashurisë sonë ah e keni ju*".

Poemthi *Menhir* është, siç është thënë, apoteozë e dashurisë. Në vargjet e tij himnizohet dashuria si ndjenjë në plan universal dhe evokohet një dashuri e pastër, sa reale, tokësore, aq edhe nebuloze, qiellore, që ndodh buzë detit: *"Kur u ngjitëm të dy për herë të parë mbi kodër/ Kur e ndjemë që deti ish atje përtej..."*.

Imazhi i kodrës ku ngjiten dy të rinjtë dhe i detit përtej - ta kujton doemos dashurinë e Milosaos me Rinën te vepra rinore e De Radës, *Këngët e Milosaos*. Dhe jo vetëm kaq. Më shumë se thjesht imazhi, është pasioni me të cilin i këndohet dashurisë: "*O dashuri/ Je ti që na bën të zgjohemi të ngazëllyer që u zgjuam/ Ashtu si klithi pulëbardha e poezisë Jeronim Poeti*".

Dashuria dhe natyra shkrihen natyrshëm me gjendjen shpirtërore të subjektit lirik, e cila i ngjan një dehjeje të shkaktuar nga nektari i dashurisë. Dashurinë poeti e sheh të shkrirë në natyrë, tek deti në tallaz dhe bunacë. Toni i ligjërimit është i lartë, emotiv, për të mos thënë edhe emfatik (vargjet fillojnë pothuajse secilën herë me apelativin: "o dashuri"), kurse vargu i gjatë, i çliruar nga konvenca e metrit dhe e rimës, por me një ritëm të brendshëm dinamik. Si në një kaleidoskop, poeti derdh fjalët, tingujt, ngjyrat, figurat, krahasimet, metaforat dhe apostrofimet e zjarrta: *"O dashuri lot i vesës në qepallë të mëngjesit/ Dashuri dashuri dritë e butë e muzgut plot gjemi"*.

Po përse poeti e quajti *Menhir* këtë krijim poetik, aq më shumë, që, pos në titull, kjo fjalë përmendet fare pak në vargjet e tij (gjithsej tri herë)?

Përgjigjja është e thjeshtë. Menhiri është arketip i dashurisë, por edhe i artit, poezisë, pavdekësisë. Ashtu si menhirët e lashtë monumentalë, edhe dashuria është e pavdekshme dhe në thelb edhe e pandryshueshme, që nga koha e neolitit e gjer më sot.

Mbi tok' e det e qiell në dritë e errësirë
O dashuri që mbive u bëre zog i lirë
Je gjithkund njëlloj si dit'n e parë

Dashuria është stina më e bukur e jetës; ajo



[1] Prof. Muzafer Xhaxhiu, *Shkrimtari i madh francez Andre Gide në shqipërimin e Mihal Hanxharit*. Parathënie e romanit *Ushqimet tokësore* , "Erik", Tiranë 2002, f. 4.

[2] Këtë tip strofe, që Hanxhari e përdor edhe në krijime të tjera, e hasim edhe te Agolli (*Poçari*, *Lamtumirë* etj.).

[3] Stilemën "Lis-Jeta" poeti e ka përdorur edhe në poezitë që ka përkthyer nga frëngjishtja: te *Abeli dhe Kaini* e Bodlerit, *Moti përtëritej* e Renjerit, *Perëndim IV* e Hygoit dhe *Përtëritje* e Malarmesë si zëvendësim për fjalë e shprehje që në frëngjisht shprehin rritjen, shtimin, gjallërinë dhe përtëritjen.

[4] Shih: J. Chevalier & A. Gheerbrant, *Rječnik simbola*, f. 465.

[5] Kam parasysh variantin e plotë, të botuar te libri *Gdhend një statujë* (2005).

është dehëse si muzika e Vivaldit.

Mihal Hanxhari këndon për dashurinë në mënyrën e tij, me pasionin e një romantiku latent, i cili e ngre lart atë si ndjenjë, duke i dhënë përmasa kozmike. Ai i ngre përmendore të lartë e të fortë si menhirët neolitikë ndjenjës së dashurisë, e cila sjell gëzim e lumturi, por edhe trishtim e vetmi.

Mihal Hanxhari e pasuron lirikën shqipe të dashurisë me tema, motive, përmbajtje e frymëzime pothuajse të patrajtuara nga poetët e tjerë, por edhe me mjete e forma të reja shprehëse. Por si krijues me kulturë të gjerë dhe me kërkesa të larta estetike, ai është i vetëdijshëm se mënyra e tij e të kënduarit për dashurinë nuk është as e vetmja e as më e mira, siç deklaron me modesti në vargjet e mëposhtme:

Le të këndojë kush di më bukur se sa unë
Më shumë ka këngë se dashuri në botë.

Dashuria është kudo si ajri, uji dhe zjarri. Yjet në qiell, gurët në tokë, lumi, deti, rëra, retë, zogjtë shpallin triumfin e saj në botë, ndërsa arti, muzika, poezia përjetësojnë zjarrin që ndez ajo në shpirtin njerëzor.

Atë zjarr në shpirt je ti që ma ndez
Je ti zë i detit që vjen e më kërkon
Që vjen si një ëndërr e si ëndërr shkon
Dhe kur vjen mëngjesi ëndrra prap më vdes
Atë zjarr në shpirt je ti që ma ndez

Si për Arshi Pipën e kohës së rinisë (strofa e cituar më sipër është marrë nga libri i tij i parë me poezi *Lundërtarë*, 1944), edhe për Hanxharin, që mbeti përherë i ri, në jetë dhe në poezi, Dashuria është shtysa që e shpie anijen e Fatit drejt limanit të Vuajtjes dhe Bukurisë. Udhërrëfyes në këtë rrugëtim të pasosur drejt Dashurisë është ylli i ndritshëm Aldebaran, kurse cak i tij guri prehistorik Menhir, që duke qenë gur varri e shndërron himnin në epitaf.

Kronotopia e Parisit

Në vitet 1994-1995 Mihal Hanxhari qëndroi në Paris si lektor i gjuhës shqipe dhe i qytetërimit shqiptar në INALCO, institucion në të cilin, krahas gjuhëve të tjera, mësohet edhe gjuha shqipe. Qëndrimi në këtë qytet, Mekë e poetëve dhe artistëve të botës, qe i frytshëm për të. Gjatë kësaj kohe ai shkroi, ndër të tjera, ciklin prej dhjetë poezish me titull *Poezitë e Parisit*, që përfshin vjershat: *Saint Merri, Chartres, Në muret e metrosë, Muzg, Bulevardi Saint-Germain, Stadiumi antik, Place de la Concorde, Centre culturel George Pompidou, Në Parkun Montsouris* dhe *Mais où sont le neiges d'antan*, ndonëse temës së Parisit poeti i referohet edhe në vjersha të tjera jashtë këtij cikli.

Janë këto ndër poezitë më të bukura të Mihal Hanxharit dhe ndër poezitë më të bukura kushtuar Parisit të shkruara nga ndonjë poet shqiptar. Siç është e natyrshme për poezitë e këtij lloji, ato evokojnë mjedise pitoreske të qytetit buzë Senës (kafene, parqe, sheshe, bulevarde, metronë e famshme parisiene, kejet me antikuarë etj.), si dhe objekte të njohura kulturo-historike (kisha, katedrale, muzeume, galeri e sallone, që frekuentohen nga piktorët dhe artistët), por më së shumti flasin për poezinë dhe poetët, aq sa mund të thuhet se në vargjet e këtij cikli zhvillohet një dialog në vargje me poezinë dhe poetët francezë të dy shekujve të fundit.

Cikli hapet me poezinë e bukur *Saint Merri*, e cila është një mrekulli e vërtetë tingujsh, rimash dhe figurash. Personazhe të saj janë dy klosharë parisienë, që strehohen në kishën "Saint-Merri". Bën ftohtë e bie shi dhe çifti i klosharëve të pastrehë gjen strehë në kishë. Aty, pranë ikonës, nën dritën e zbehtë të qirinjve, bëjnë dashuri dhe, ashtu të përqafuar, i zë gjumi. Të bësh dashuri në kishë e në xhami është mëkat - përdhosje e shtëpisë së Zotit, por ja që poeti nuk mendon ashtu. Dashuria është dhuratë e perëndisë, andaj bijtë e tij, njerëzit, qofshin mbretër a klosharë, e shijojnë njëlloj atë. Vjersha mbyllet me vargjet në të cilat mbizotërojnë, sikurse në strofat e tjera, rimat me zanoren *i* dhe *e*, që sugjerojnë heshtjen dhe qetësinë:

Dhe ajo fle dhe ai fle
Dy klosharë gji në gji
Zot askush nuk i përze
Që nga kisha Saint Merri

Pason vjersha dystrofëshe *Chartres*, e përbërë nga dy katrena, në të cilën subjekti lirik përsiat

për përkohësinë e njeriut në këtë botë, duke marrë shkas nga qelqet e ndezura të kishave të Shartrit, qytet në jugperëndim të Parisit, i njohur për katedralen e tij të bukur mesjetare, një kryevepër arkitektonike e llojit të vet.

Dhe ika që të mbetem mes fushave me ves'
Në qelqet me ngjyra të kishave të Chartres

Fantazinë e poetit e nxisin, doemos, krahas kishave e katedraleve, edhe metroja e famshme e Parisit, që është një botë më vete (*Në muret e metrosë*), pastaj muzgu parizien, që i shërben vizitorit si shkas për meditim (*Muzg*); bulevardi Sen-Zhermen me shenjat e tij dalluese (*Bulevardi Saint-Germain*); stadiumi antik i qytetit me shkallët e mbuluara nga bari (*Stadiumi antik*); Sheshi Konkord me Obeliskun e sjellë nga Egjipti i lashtë, që ëndërron mërmërimën e largët të Nilit (*Place de la Concorde*); Qendra Kulturore "Zhorzh Pompidu", e njohur me emrin popullor "Beaubour" (*Centre Culturel George Pompidou*) dhe Parku Monsuri në afërsi të Qytetit Ndërkombëtar të Studentëve, ku ka banuar një kohë Hanxhari gjatë qëndrimit të tij në Paris (*Në Parkun Montsouris*).

Secila nga këto poezi ofron një pamje, një peizazh ose një përjetim nga qyteti të cilin Valter Benjamini e quajti "kryeqyteti i shekullit të nëntëmbëdhjetë" dhe i tillë mbeti edhe në shekullin e njëzetë. Mirëpo, më shumë se vjersha përshkruese, që ofrojnë pamje tërheqëse për syrin si ato që ofron me bollëk Parisi, vjershat e mësipërme janë, cila më shumë e cila më pak, poezi lirike meditative, që duke marrë shkas nga kontakti me bukuritë e rralla të këtij qyteti, shprehin vizionin e poetit për jetën, dashurinë, artin, vdekjen dhe pavdekësinë, të ngjizura në mënyrë mjeshtërore në vargje kryesisht të rregullta, strofike, pa thyerje të mëdha metrike e formale, por të çliruara nga ngurtësia ritmike, figurative dhe semantike e poezisë tradicionale.

Raporti që vë poeti me Parisin është dialogues, në kuptimin që këtij nocioni i japin përfaqësuesit e teorisë intertekstuale. Hanxhari citon, parafrazon, komenton vepra, fakte, të dhëna, emra etj. Por mjeshtëria e tij si poet qëndron në mënyrën si e bën këtë: lehtë, natyrshëm, pa sforcime. Sintezën fatlume të këtyre motiveve dhe të kësaj teknike të shkrimit e gjejmë në vjershën përmbyllëse të ciklit, që mban si titull vargun e famshëm të Vijonit: *Mais où sont les neiges d'antan*.

Mirëpo, para se të kalojmë në analizën e kësaj poezie, le të themi ndonjë fjalë për poezitë e tjera të këtij cikli, të cilin vetë poeti e quajti thjesht: *Poezitë e Parisit*.

Qendra Kulturore me emrin e ish-presidentit francez, Zhorzh Pompidu[6], bëhet objekt frymëzimi në poezinë *Centre Culturel George Pompidou*. Atmosfera që mbretëron në këtë tempull modern kulturor është krejt tjetër nga ajo e tempullit fetar (*Saint-Merri*): e gjallë e dinamike dhe jo e heshtur e statike. Kjo është botë e librit, e kompjuterit, e konferencave shkencore, e ekspozitave, e koncerteve dhe e shfaqjeve filmike e teatrore, ku hyjnë e dalin njerëz të profileve të ndryshme, studentë, intelektualë e të tjerë. Pasi përshkruan në hollësi arkitekturën e këtij objekti dhe gjallërinë e tij, poeti e mbyll vjershën me një kontrast: klosharët që flenë nën hijen e këtij "tempulli" mbuluar me gazetën *Libération*.

Poezia *Bulevardi Saint-Germain* sajohet nga tri pamje, që shfaqen me këtë rend: statuja e Dantonit te stacioni "Odeon", ku vazhdimisht hyjnë e dalin njerëz në nëntokën e metrosë; kafeneja e frekuentuar nga Sartri po në këtë bulevard (nuk përmendet emri i lokalit, por fjala është për kafenenë "Flora" ose "Les deux magots", ku Sartri dhe Simonë dë Bovuar ishin mysafirë të shpeshtë) dhe një çezmë që rrjedh aty pranë.

Dantoni personifikon politikanin, që ëndërron të presë koka njerëzish në gijotinë, nga e cila pësoi edhe vetë; Sartri - filozofin dhe intelektualin, që mbi çdo gjë vë idetë dhe prestigjin e tij intelektual, kurse çezma - jetën e gjallë. Kësaj logjike i nënshtrohet edhe kompozicioni i vjershës, që sajohet nga tri njësi strofike (4+3+3). Figurën e Dantonit, poeti e karakterizon me fjalët prozaike: "i nxirë", "i enjtur", "shpirt demon", "me bulçiltë e mbushur plot", për ta përmbyllur tiradën me një "denoncim" klasik të këtij politikani kontravers, që ishte avokat me profesion:

Krekoset aty Dantoni por ai as sot s'e di
Që historia nxori që avokati i ndritur
Tek anglezët për flori pat shitur
Francë Revolucion dhe shpirt'n e tij

Nga Dantoni poeti kalon tek Sartri, për të evokuar në tri strofat vijuese bëmat e tij si shkrimtar, filozof e intelektual. Përmendet titulli i veprës kryesore filozofike të Sartrit *L'Etre et le Neant* (Qenia dhe Hiçi) dhe refuzimi i Çmimit Nobel nga ana e tij si akt rebelimi intelektual.

[6] Georges Pompidou (1911-1974), president i Francës në vitet 1969-1974, njihet, ndër të tjera, edhe si autor i një antologjie të poezisë frënge: *Anthologie de la Poésie française*, Hachette, Paris 1961.

Sa për shkak të rimës, po aq edhe në shenjë revolte ndaj konformizmit, poeti përdor fjalët: "përmori" dhe "shurruar", që nuk i shkojnë shumë poezisë së tij në përgjithësi skofiare, të kundërt me poezinë avangarde. (*Dhe në pllakë mermeri një ditë kan' për të shkruar/ Për kafetë që pinte për çmimin që s'e mori/ Për Nobelin që përmbi të përmori/ Por sa vetë lëpijnë atë që ai pat shurruar*).

Edhe në një mjedis si ai i bulevardit Sen-Zhermen, ku ka aq shumë gjëra për të parë, poetit i bën përshtypje një detaj në dukje i parëndësishëm, por kuptimplotë: currili i ujit që rrjedh pahetueshëm aty pranë. Prandaj, fton lexuesin të lërë Dantonin e Sartrin dhe të hedhë sytë tek çezma ku pinë ujë njerëzit dhe pëllumbat. Një mur i vjetër, një kishëz dhe dy cirka uji që rrjedhin pareshtur si nga një botë tjetër, mjaftojnë për të sugjeruar idenë se politika, karriera, fama e pasuria dhe, mbase, edhe arti e filozofia, janë hiçgjë përpara rrjedhës së ujit, që është simbol i jetës.

N'atë mur të vjetër pështetur në një kish'
Ku rrëmet' i rrugës sikur s'ndihet më
Harroi shpirt të gjitha nuk ia vlen asgjë
O shpirt me pëllumbat shko aty të pish

Poezia *Bulevardi Saint-Germain* është përsiatje për politikën, historinë, filozofinë, artin, jetën. E ngjashme me të është poezia *Në muret e metrosë*, veçse këtu poeti niset nga një fakt konkret: afishimi i vargjeve të poetëve anonimë në muret e metrosë parisiene. Udhëtarët i lexojnë në heshtje ato vargje, që flasin për gjëra jo të zakonshme. Vjersha ka tone elegjiake dhe i ngjan një përshpirtjeje për poetin "e mallkuar", që jeton me "vojtjen e bekuar". Fjalët: kryq, ikonë dhe rekuiem janë në funksion të krijimit të kësaj atmosfere.

Në poezinë *Place de la Concorde* poeti nuk flet për historinë e bujshme të sheshit me këtë emër, që në shqip do të mund ta quanim "Sheshi i Pajtimit", por apostrofon Obeliskun madhështor që ngrihet në qendër të tij. Animizimi i pirgut të ardhur nga brigjet e Nilit, që duket i fjetur gjatë ditës dhe zgjohet kur vjen nata dhe metaforat e tipit "kurm palme bërë gur", i japin tonin kësaj poezie dhe shprehin qëndrimin e poetit ndaj historisë.

Vjersha përmbyllëse e ciklit, që ka si titull një varg të Vijonit, vargun e famshëm *Mais où sont les neiges d'antan,* është një shëtitje poetike nëpër Paris. E shkruar me vargje të rimuara, të strukturuara në strofa katërshe sipas skemës ABAB, kjo poezi, që është më e gjata e ciklit (gjithsej 37 strofa), hapet me imazhin e fluturimit të një aeroplani që ndan më dysh qiellin e Parisit:

Brazd' e bardhë e një avioni
E ndan qiellin mes për mes
O sytë e mi çfarë po shikoni
Zemrën time në dy pjesë

Apostrofimi i syve dhe i zemrës që në strofën e parë, sugjeron aktin e të parit dhe të përjetuarit të Parisit jo vetëm si një qytet i madh e me bukuri të rralla, por edhe si djep i kulturës, artit dhe poezisë.

Balzaku, një nga kronistët më të mëdhenj të shoqërisë franceze të kohës, thotë se Parisi është qyteti më zbavitës dhe më filozofik në botë.[7] Poeti shqiptar Mihal Hanxhari, në poezitë e tij kushtuar këtij qyteti, mëton të kapë të dyja këto përmasa, por si poet me prirje refleksive, anon nga e dyta: ana filozofike e Parisit. "Fluturimin" e tij mbi qytetin buzë Senës, ai e fillon nga një pikë konkrete: nga streha e kafenesë me emrin e aktores së njohur franceze të viteve '20-'30, Sara Bernar, prej nga, në një ditë me shi, niset në "pushtimin" e tij.

Në kafe Sara Bernhardt
Rri nën strehë tek bie shi
Ah Sena shpie në Pont des Arts
Poet' e vdekur nji nga nji

Poetët gjethe poet' gjemi
Ikin mjegull nëpër lumë
Zot poetët nji nga nji
Vijnë tuliten në gji tek unë

Shtegtimi i poetit vazhdon në këtë frymë. Strofa katërshe dhe vargu i rimuar i përgjigjen synimit që i ka parashtruar ai vetes: të këndojë për urat, rrugët, sheshet, bulevardet, monumentet dhe kejet e Parisit, por akoma më shumë për ata

[7] Ky mendim i Balzakut haset te novela e tij e njohur *Sarrazini*, e përkthyer edhe në gjuhën shqipe.

që u japin frymë dhe kuptim atyre: artistët dhe poetët. "Takimi" me bardët e poezisë franceze, klasike dhe moderne: Apolinerin, Vijonin, Rembonë, Vërlenin, Desnosin, Lotreamonin, Aragonin, Elyarin, Sen-Xhon Persin; me piktorët gjenialë Pikaso e Modiliani dhe këngëtarët popullorë Zhak Brel, Zhilber Beko e Pjer Bulez, paraqesin shtresën kryesore të këtij kokteji poetik. Ata janë "ura" që lidh tokën dhe qiellin, kohën dhe hapësirën, realitetin dhe ëndrrën. Poeti dialogon me ta, evokon detaje nga jeta e tyre, përmend tituj veprash dhe citon vargje, shtron pyetje e bën vlerësime, krijon rima të bukura e interesante, tërheq paralele befasuese.

Mbi një urë ëndërroj
As Jacques Brel e as Becaud
Unë me Guillaumin kuvendoj
Si mbi urën Mirabo

Ashtu vetëm përmbi urë
Flokë thinja nëpër erë
Ah Guillaumi s'kthehet kurrë
Si dëborë që ran' një herë

Subjekti lirik identifikohet plotësisht me "poetët e vdekur", kurse teksti i vjershës i ngjan një rrjeti ndërtekstor të thurur me mjeshtri. Në tekstin shqip poeti fut fraza, shprehje dhe emërtime frëngjisht, kurse emrat e poetëve dhe titujt e veprave të tyre i shkruan në origjinal, duke përftuar kështu atmosferën autentike të mjedisit dhe ngjyrimin gjuhësor e stilistik të vargut.

Nuk mungojnë as aluzionet për degradimin e vlerave në shoqërinë e sotme të qytetërimit teknik. Kështu, lulet që rriten në xham janë pa erë; Trëndafilat e Saadiut s'gjenden dot; Lulet e hidhura të Bodlerit lypin lëmoshë në metro ose mbyten në smog; pikturat nxijnë; krijuesi gjenial i *Një stinë në ferr*, Artyr Rembo, mund të shesë çelësa në rrugën Rivoli, ndërsa *"Në ferr veturash ulërijnë/ Mija demonë me një zë"*.

Për titull të vjershës poeti ka zgjedhur vargun e njohur të Vijonit: *Mais où sont les neiges d'antan*, të cilin vetë Hanxhari e përkthen në shqip: "Por ku janë dëborët që ranë njëherë?". Koha rrjedh si lumi që kalon përmes qytetit, Sena legjendare, ndërsa shpirtin e poetit e kaplon pikëllimi. Kalueshmëria e jetës dhe fundi i saj i pashmangshëm - vdekja, është lajtmotivi i kësaj poezie të Hanxharit, që hapet me kujtimin e "poetëve të vdekur" dhe mbyllet me vargun që na përkujton ikjen nga kjo botë: *"Ditëlindje e tokës që do lëmë pas"*.

Vargu inicial i vjershës mbi poetët e vdekur, që vijnë "nji nga nji", haset edhe te poezia *Në Parkun Montsouris*, ku shiu që bie pa pushim - një element tjetër i përbashkët i të dyja vjershave, krahas ndjenjës së trishtimit dhe melankolisë, zgjon edhe asociacionin e përtëritjes së natyrës:

Dhe shiu i prillit bie
Me mërmërim' të mekur
Ja po vijnë si hije
Gjithë poet' e vdekur

"Festë lëvizëse" (A Moveable feast), e pat quajtur Hemingueji Parisin në librin e tij me të njëjtin titull, ku evokonte kujtimet e qëndrimit të tij në këtë qytet në vitet 1921-1923 dhe shtonte se "Parisi është qytet ideal për shkrimtarët".

Për Parisin është shkruar më shumë se për cilindo qytet tjetër në botë dhe është shkruar në mënyra nga më të ndryshmet. Mihal Hanxhari paraqet Parisin e vet, ashtu siç e sheh ai me sytë e tij: me simbolet, dritat dhe hijet e tij. Parisi i Hanxharit nuk është Parisi i Balzakut, i Hygoit, i Prustit, i Heminguejit, i Remarkut, i Preverit apo edhe i Kadaresë, për të përmendur vetëm disa nga korifenjtë e tij. Parisi i Hanxharit është para së gjithash qytet i artit dhe i kulturës, i poezisë, i muzikës, i pikturës, por edhe i idealeve të mëdha shoqërore dhe në radhë të parë i idealit të lirisë. Parisi i Hanxharit është para së gjithash Parisi i poetëve Bodler, Rembo, Vërlen, Apoliner, Aragon, Elyar e të tjerë (disa prej të cilëve ai edhe i përktheu në gjuhën shqipe) dhe akoma më shumë i "poetit të parë modern", siç është quajtur Fransoa Vijoni, tejet problematik si njeri, por gjenial si poet, i njohur sidomos për baladat e tij. Vijonit (apo Vilonit) poeti i referohet në së paku dy poezi: *Mais où sont le neiges d'antan* dhe *Variacion nga një temë e Villonit*, që mund të thuhet se edhe janë variacione të njëra-tjetrës. Shprehja: "ku janë" (frëngjisht: *où sont)*, nëpërmjet së cilës përftohet ideja e ikjes në pakthim të kohës, ia jep tonin edhe njërës edhe tjetrës.

"Poezitë e Parisit" Hanxhari i shkroi gjatë qëndrimit të tij në këtë qytet, në vitet 1994-95, pra vetëm 4-5 vjet para se të largohej edhe vetë përgjithmonë nga kjo botë.

Kënga për Kosovën

Krijimi i fundit poetik i Mihal Haxharit është poezia *Elegji për Kosovën*. Kjo poezi lindi në kohën e eksodit të shqiptarëve të Kosovës në Shqipëri e gjetkë (mars-qershor 1999), disa prej të cilëve poeti i strehoi në shtëpinë e tij në Tiranë. Vjersha mban në fund shënimin: "Tiranë, prill 1999", që do të thotë se ajo është shkruar rreth dy muaj para se poeti të ikte nga kjo botë. (Hanxhari vdiq më 3 qershor 1999). Fryma dhe përmbajtja e kësaj vjershe, me të cilën mbyllet vëllimi *Se sytë e mi kështu e shohin botën*, paralajmërohet qysh në titull: *Elegji për Kosovën*. E, elegjia, s'është tjetër, pos vajtim; këngë ku mbizotëron ndjenja e dhembjes dhe e pikëllimit. Mirëpo, edhe pse në krye të vjershës në fjalë qëndron fjala "elegji", ajo i ngjan më shumë një lutjeje të poetit drejtuar Zotit për shpëtimin e Kosovës nga tragjedia e madhe që i shkaktuan asaj pushtuesit serbë, që poeti refuzon t'u bëjë vend në vargje, veçse tërthorazi dhe vetëm në strofën e dytë, ku përmenden "zërat e çmendur", "tamtamet", "klithmat e marra", që zgjojnë asociacionin e dhunës dhe të propagandës.

Koha kur u shkruan këto vargje ishte kohë e lutjes së madhe për shpëtimin e Kosovës dhe njerëzve të saj të derdhur nëpër botë. Dashuria dhe dhimbja e poetit për këta njerëz është e madhe, ndërsa optimizmi i tij për fatin e tyre i përmbajtur, gjë që shprehet me përdorimin e shpeshtë, në secilën strofë, të lidhëzës "nëse", që përdoret rëndom në fjalitë kushtore.

Elegjia e Hanxharit për Kosovën, më shumë se elegji është psalm a litani, që fillon e mbaron me fjalën Zot, e cila, në tekstin prej gjithsej njëzet vargjesh të kësaj poezie, përdoret plot nëntë herë.

Zot nëse njerëzit s'dinë të shohin sot
Dhe nesër askush s'do të ketë më sy
Shpëto o Zot vetëm sytë e fëmijëve të Kosovës
Zot shpëto ata sy të kaltër të peshqve blu
Që flenë në shi dhe ëndërrojnë engjëjt e tu

Të vihet re gjithashtu edhe përdorimi i dendur i fjalës "sy" në këto vargje, që është jo vetëm fjalë e preferuar e poetit, por ka edhe funksion semantik: shpreh idenë e (mos) mbylljes së syve para fatkeqësisë së njerëzve dhe posaçërisht të fëmijëve të pafajshëm, që poeti i përqas me engjëjt dhe "peshqit blu", që janë peshq migrues, njësoj si fëmijët shqiptarë të shndërruar në refugjatë.

Ndryshe nga poetët tanë të tjerë, që e kanë trajtuar temën e fatit tragjik të Kosovës, përfshirë edhe Kadarenë (*Terrori në Kosovë*), më shumë se te shkaktarët e saj, vëmendja e poetit Hanxhari fokusohet te njerëzit e Kosovës të degdisur nëpër botë, në shi e në baltë, kurse në epiqendër janë vënë: fëmijët, pleqtë, gratë dhe përsëri fëmijët (foshnjat) dhe nënat e tyre (nuset), që krahasohen me yjet e "Yllnajës së Mjellmës", figurë kozmike me kuptim simbolik, nga ato që Hanxhari përdor shpesh në poezinë e tij (le të kujtojmë poemën *Aldebaran* etj.). E vetmja fjalë, që mbase stonon në këtë vjershë të shkruar me frymëzim dhe të kompozuar me mjeshtri, është fjala e huaj "delyzhë" (nga frëngjishtja: *déluge* - shi i rrëmbyer, rrebesh i madh, përmbytje, kijamet). Kjo fjalë, me origjinë biblike, është futur në këtë rast për të treguar përmasat apokaliptike të tragjedisë së Kosovës, që ishte tragjedi e një populli të tërë, që i kanosej rreziku i shfarosjes.

Dhe nëse s'do ketë shenjë nga delyzhi ku pirgu do bëhet
Gropë dhe gropa kodër mbill nëpër rrugët e Kosovës
Dyqind qiparisa dy mijë qiparisa dyqind mijë qiparisa
Dhe dy milionë rrape o Zot
Dhe ai do të jetë pylli i parë i Lirisë në botë.

Bie në sy, si thamë, përdorimi i shpeshtë i fjalës Zot në vargjet e kësaj poezie. Kurse Zotit njeriu i drejtohet kur është në kulm të hidhërimit dhe kur e humb besimin te njerëzit, por jo edhe shpresën, që vdes e fundit.

Nëse qiparisat t'i kujtojnë varret, rrapet simbolizojnë qëndresën.

Pylli i Lirisë, që del në vargun përmbyllës të vjershës *Elegji për Kosovën*, u bë realitet, ndonëse poeti që e krijoi këtë metaforë të madhe e vizionare, nuk arriti ta shihte dot me sytë e vet.

Imazhi poetik, muzika e fjalës

Poezia e Mihal Hanxharit është fryt i dhuntisë krijuese dhe i kulturës së gjerë letrare, që e karakterizon këtë krijues të talentuar e erudit, i cili, edhe pse nuk e studioi letërsinë në shkollë, tërë jetën ia kushtoi asaj. Poezia e tij, për shumëçka origjinale, është vazhduese e traditës poetike shqiptare, e pjesës më të mirë të saj, gjë që na kujton pikëpamjen e Eliotit se "pjesët më të mira dhe më individuale të veprës së një poeti janë ato me të cilat poetët e vdekur, *paraardhësit e tij*, e kanë dëshmuar pavdekësinë e vet". Hanxhari e njihte mirë verbin poetik shqiptar, që nga poeti anonim e gjer tek poetët e spikatur kombëtarë, si: De Rada, Naimi, Fishta, Çajupi, Noli, Asdreni, Lasgushi, Migjeni etj., emrat e të cilëve përmenden shpesh në poezinë e tij. Më i afërt nga të gjithë për të është Lasgushi, me të cilin e ka të përbashkët, përpos dashurisë për atdheun, gjuhën shqipe dhe natyrën shqiptare, edhe trajtimin e motiveve të përhershme poetike si dashuria, përjetësia, vizionet kozmike, simbolika që derivon nga kjo sferë dhe mbi të gjitha muzikën e vargut.

Poezia e Mihal Hanxharit është fryt i komunikimit me traditën poetike shqiptare, të cilën ai e njihte mirë dhe e çmonte lart, por edhe me traditën e poezisë evropiane e botërore dhe sidomos të poezisë moderne franceze nga Bodleri e deri në ditët e sotme. Sikurse edhe Kadareja, Agolli, Arapi, Bllaci, Spahiu e të tjerë, Mihal Hanxhari ishte jo vetëm poet, por edhe përkthyes i poezisë. Ai përktheu, po ashtu në heshtje dhe pa e bërë publike as punën e tij si përkthyes, poezi të poetëve francezë: Bodler, Hygo, Vërlen, Rembo, Malarme, Elyar, Renjer, Vijon, Sypervjel të tjerë, sonetet e Shekspirit, *Gitanjalin* e Tagorës, veprën me të cilën bardi indian mori çmimin Nobel; një libër me poezi të Mikelanxhelos, të cilin e shoqëroi me një ese të gjatë, model i esesë së vërtetë, çfarë mund të hasen rrallë në letërsinë shqipe etj. Në vargjet e tij, sikurse edhe në tregimet e librit *Na ishte një herë...* defilojnë emrat e shumë poetëve, filozofëve, shkrimtarëve dhe intelektualëve të kulturës perëndimore, por edhe asaj lindore; ka citate nga Bibla dhe Kurani, vargje nga cikli i kreshnikëve (*Lum për ty o i lumi Zot, shum po shndrit njaj diell e pak po nxe* dhe *Ç'pe merr frima rrapin e Jutbinës*), të cilat shoqërohen me komente; ndërkallet *Kënga e këngëve* e mbretit Salomon dhe tregimi i Psikes dhe Erosit i mitologjisë së lashtë greke, kurse për vargun e De Radës: *"U zgjua e ngazëllyer që u zgjua"* thuhet se është "mbase vargu më i bukur i poezisë sonë"[8].

Ndërkohë, që nuk ka asnjë referencë për poezinë e sotme, ndaj së cilës duket kishte rezerva të mëdha.

Mihal Hanxhari i takon kategorisë së poetëve të ditur (poeta doctus). Ishte njeri me kulturë të gjerë letrare, estetike, filozofike. Duket se ka pasur njohuri të gjera edhe nga astronomia, botanika, zoologjia. Përveç që shkruante vargje dhe prozë (në heshtje të plotë), merrej edhe me përkthime dhe pikturonte. E njihte mirë muzikën, si atë popullore, ashtu edhe atë klasike. Ishte në shërbim të dijes dhe kulturës. Ata që e kanë njohur dëshmojnë se me punën e tij si drejtor i Bibliotekës Shkencore të Universitetit të Tiranës, në krye të së cilës qëndroi plot 15 vjet, derisa e transferuan si të papërshtatshëm në një vend krejt të parëndësishëm (sportelist në bibliotekën e njërit prej fakulteteve), ai i bëri shërbime të çmueshme kulturës kombëtare.[9] I pasuroi fondet e saj me libra e revista; vuri kontakt me shumë biblioteka të botës dhe personalitete të shquara të kulturës; e shndërroi zyrën e tij në një klub të elitës intelektuale të Tiranës. Një dëshmi të shkruar për këtë mision të Mihalit, ka lënë edhe shkrimtari Mitrush Kuteli.

"Mihal Hanxhari i ka të gjitha çʼduhen për të qenë një shkrimtar i vërtetë: ndjeshmërinë, prirjen për filozofim, fantazinë, kulturën" - nënvizon Donika Omari në parathënien e librit të tij me tregime *Na ishte njëherë...*[10]. Poezia e tij, edhe pse nuk është në asnjë rast didaktike, ofron një informacion të gjerë artistik e, madje, herë-herë, edhe shkencor (ajo është poezi e një eruditi prej së cilës njeriu mund të mësojë mjaft gjëra që s'i ka ditur për artin, natyrën etj.), ndërsa në prozën e tij mund të lexohet një nga vlerësimet më të bukura e më origjinale, që janë shqiptuar ndonjëherë për letërsinë popullore. Te tregimi me titull *Liqeni B.*, që është proza më e gjatë e tij, personazhi narrator, pasi citon vargun e një kënge popullore shqiptare të dashurisë: *"Pash nj'at sy, qi ma çil e ma mbyll, posi hana nëpër pyll..."*, bën këtë koment për poetin anonim shqiptar dhe perlat që ka krijuar ai: *"sa e sa herë kam menduar për atë poet që i ka kënduar këto vargje, për gjithë ata poetë anonimë që kanë kënduar gjërat më të bukura të gjuhës sime, dhe janë pa dyshim nga më të bukurat që kanë kënduar poetët e gjithë kohërave të të gjithë botës, dhe s'kanë një emër, dhe as kanë kënduar për t'i shitur inxhitë e tyre, as i kanë paraqitur nëpër komisione për t'i gykuar, kjo s'bën, as kanë marrë porosi të këndojnë që të marrin një nishan, një titull, një çmim, as kanë menduar të bëhen të pasur me këngët e shpirtit të tyre, as kanë menduar t'i përkthejnë në të tjera gjuhë që të bëhen të dëgjuar dhe ashtu të marrin të tjera nishane, dhe të bëjnë jetë zotërinjsh, asgjë nga këto, vetëm kanë kënduar si u ka thënë shpirti, ashtu si janë dehur nga bukuria, ajo dorë e Perëndisë, nga bukuria e asaj që kanë dashur, dhe nga dashuria për bukurinë e vendit që kanë parë që në fëmijëri..."*.

Një profil i tillë poeti, që shkruan ashtu si i dikton shpirti dhe pa kurrfarë kompleksi e prapavije, pos dëshirës për të qenë në shërbim të bukurisë dhe i dehur prej saj, është vetë Hanxhari. Ai nuk këndoi për nishane, për t'u bërë i famshëm, e as për të përfituar në planin material. Krijuesi për të cilin flitet në paragrafin e mësipërm është gjedhe e krijuesit të lirë e autonom në çdo pikëpamje.

Hanxhari është i vetmi poet bashkëkohor shqiptar nga ata që kanë krijuar në Shqipëri që i hoqi shenjat e pikësimit nga vargjet (ndryshe nga çʼndodhte në Kosovë, fjala vjen, ku kjo dukuri ishte shumë e përhapur), duke mos i përdorur ato fare, kurse në prozë i reduktoi në maksimum. Natyrisht se heqja e shenjave të pikësimit nuk është *a priori* shenjë e modernitetit të poezisë. Përkundrazi, kur bëhet për modë, siç ka ndodhur shumë herë në Kosovë, mund të jetë edhe e kundërta e asaj që synohet - shprehjes moderne. Me vetë faktin që nuk botonte, Hanxhari nuk ishte nga ata krijues që duan të imponohen e bien në sy, prandaj shmangia e interpunksionit tek ai shkon në favor të forcimit të shprehësisë së vargut dhe është njëkohësisht edhe shprehje e dëshirës së autorit për të qenë kundër rrymës.

Mihal Hanxhari është poet që, siç pohon vetë në vjershën *Sytë e mi*, e sheh botën me sytë e fëmijës: "*Se sytë e mi kështu e shohin botën/ Se Zoti m'i la përgjithmonë sytë e fëmijërisë*".[11]

Nga ky aspekt ai ta kujton mendimin e kritikut dhe filozofit francez Zhorzh Bataj, i cili duke folur për Kafkën, njërin nga tre shkrimtarët e adhuruar botërorë të Hanxharit (dy të tjerët janë Prusti dhe Xhojsi), thotë se njerëzimi nëpërmjet naivitetit fëmijëror, në zanafillën e tij, shpreh thelbin e vet (f. 79).

Në hyrje të librit *Se sytë e mi kështu e shohin botën*, hasim edhe këtë paragraf: *"Jetova me mrekullinë e jetës, me bukurinë e saj e çudinë e saj të pafund, në gjithësinë plot gëzim e mister"*.

Poezia e Mihal Hanxharit është poezi për bukurinë dhe fshehtësitë e jetës; përsiatje për pozitën e njeriut në hapësirë dhe në shoqëri.

[8] Shih tregimin *Varrimi*, te libri *Na ishte njëherë...*, f. 77.



[9] Shih për këtë artikullin e Zef Rrakacollit "Oaza e Mihalit", botuar në gazetën "Drita", 4 shkurt 2001 dhe në librin *Mihal Hanxhari. Njeriu dhe vepra*, "Florimont", Tiranë 2004, f. 47-51.

[10] Donika Omari, *Parathënie*, f. 8.

[11] *Se sytë e mi kështu e shohin botën,* f. 141-142.

Poet me prirje të theksuar meditative dhe me një diapazon të gjerë kulturor, që ishte shoqëruar në vazhdimësi me korifenjtë e poezisë shqipe (Naimi, De Rada, Fishta, Noli, Lasgushi) dhe botërore (nga Mikelanxhelo, Bodleri, Vërleni, Nervali, Remboja, Malarmeja e gjer tek Elyari e Meterlinku) dhe kryeveprat e tyre, Hanxhari do të hulumtojë në vargje fshehtësitë e natyrës dhe të shpirtit njerëzor, duke e parë këtë të fundit në dy plane kryesore: në raport me botën që e rrethon dhe me shoqërinë që i takon. Ai është nga ai soj poetësh që gjejnë jetë edhe te një kokërr rëre dhe është i gatshëm të dialogojë me të, duke parë atë si pjesë të universit:

O rërë
Me një diell brenda çdo kokërrize
Me një stinë brenda çdo thërrmie

Ti rërë muzikë e fshehur që kumbon brenda çdo grimce
Rërë me pikëllimin e çdo ylli në gjirin tënd
Me pasqyrën e thërrmuar të hënës në më të vjetrin mot

Rërë rërë jetë e tërë[12]

Kur e lexojmë dhe rilexojmë poezinë e Mihal Hanxharit dhe veçanërisht vjershat dhe poemat e tij më të realizuara, që shquhen me thellësinë e ndjenjës dhe mendimit, por edhe me bukurinë e shprehjes dhe konkretësinë e imazhit poetik, na kujtohen fjalët e Marc Chagall-it, i cili thoshte: *"Kur mbaroj një pikturë, e mbaj pranë disa objekteve natyrale - një guri, një luleje, një dege peme apo dorës sime - si një lloj prove përfundimtare. Nëse piktura rri mirë pranë një objekti që nuk është bërë nga njeriu, atëherë piktura është autentike. Nëse nuk shkon diçka, arti s'është i arrirë"*.

Poezi si: *Dëgjoj një zog* (një alkimi tingujsh dhe ngjyrash; i afrohet principit bodlerian të sinestezisë, i quajtur ndryshe edhe "audition colorisé"), *Buzë detit nëpër rërë*, *Ika i vetëm*, *Dhe ti, Fije fije, Askush s'troket, Saint Merry*, *Mais où sont le neiges d'antan*, *Zemrën marr në duar*, poemat lirike *Aldebaran* e *Menhir* dhe shumë krijime të tjera të këtij poeti, i qëndrojnë denjësisht "provës" së Shagallit për të qenë të gjalla e autentike si një degë peme, si një gur apo një lule e gjallë, jo artificiale.

Është e vështirë, në mos edhe e pamundur, që poezia e Mihal Hanxharit të përcaktohet nga pikëpamja e përkatësisë së saj ndonjë rryme letrare a metode krijuese. Citatet, referencat dhe elementet e tjera ndërtekstore e afrojnë atë me gjedhen post-moderne. Shmangia e shenjave të pikësimit, që ai i përmbahet në mënyrë strikte në poezi dhe, pjesërisht, edhe në prozë, ku përdor vetëm presjen, t'i kujton poetët avangardë evropianë të viteve '20-'30 të shekullit XX, por ndryshe nga krijimtaria e futuristëve dhe surrealistëve, poezia e Hanxharit nuk është radikale as në formë as në përmbajtje. Poezia e tij nuk ka shumë risi formale e as eksperimente gjuhësore (përpos depunktuimit), siç ndodh në poezinë bashkëkohore në botë dhe, pjesërisht edhe tek ne, posaçërisht pas viteve nëntëdhjetë (në Kosovë edhe më parë). Në planin përmbajtësor dhe konceptual, madje, ajo afrohet më shumë me traditën romantike dhe sidomos atë pasromantike (simboliste në radhë të parë), me vetë faktin që temat më të preferuara të saj janë: tema e dashurisë, e natyrës, e vetmisë, e vdekjes dhe e vetë artit, poezisë.

E shkruar në vetmi, larg vorbullës së modës dhe shijeve letrare të kohës, por edhe larg vlerësimit të kritikës dhe lexuesve, poezia e Hanxharit i ik skemës së përkufizimeve teorike dhe historiko-letrare, të cilat, siç dihet, kur më shumë e kur më pak, e dhunojnë natyrën specifike të veprës letrare dhe të procesit letrar në përgjithësi.

Mihal Hanxhari është poet që "e pa botën me sytë e tij"; me sytë e një njeriu që synon të depërtojë në thellësi të gjërave e jo të mbetet në sipërfaqe të tyre (e ç'është tjetër arti, pos mënyrë të pari?) dhe që, falë këtij "shikimi" të thellë, sa transparent, aq edhe mistik, që ka ruajtur diçka nga shikimi i pafajshëm dhe naiv fëmijëror, arriti të krijojë një vepër jashtë skemave të kohës, një vepër origjinale e me vlerë, që tërhoqi, si rrallë ndonjë tjetër në letrat shqipe, menjëherë pas shfaqjes në publik, vëmendjen e lexuesve dhe të kritikës sonë letrare.

[12] *Ti vdekja ime mbushur me jetë*, f. 37.

Mbi atdheun dhe identitetin, mbi përkatësinë dhe të huajën, për shanset e barabarta në shoqëri - dhe nostalgjinë e Shqipërisë për Europën! Botohet në Gjermani libri me ese i Lindita Arapit, "Lulebliri për libra"

Kur largohesh nga atdheu nuk jeton më në njëjës!

"Lulebliri për libra" është një libër sensitiv dhe reflektues, me ese thellësisht humane, një libër për lirinë, vlerëson Svenja Frederike Bischoff nga Weidle Verlag, Gjermani, librin e ri të Arapit. Më tej Lindita Arapi e rikthen edhe njëherë vështrimin tek periudha e diktaturës, asaj kohe, kur për shqiptarët Evropa ishte si një planet i largët, i paarritshëm, i kushton vëmendje izolimit e persekutimit politik në Shqipërinë komuniste, por edhe rrugës së polarizuar dhe të vështirë drejt demokracisë.

Cila është marrëdhënia me atdheun, kur nuk jeton më aty? A e humbim identitetin apo fitojmë diçka tjetër? Autorja i kushton vëmendje distancës që lind kur nuk jeton më në atdhe, boshllëkut të përhershëm që dhemb por është edhe mundësi reflektimi. "M'u desh kohë për të pranuar se jeta ime nuk mund të kuptohet vetëm në njëjës, porn ë një shumës të ri, isha bërë "disa" duke jetuar në vend të huaj. Vite rrodhën brenda dy lidhëzave që nuk i afronin po ndanin gjymtyrët e identitetit tim "ose je si ne, ose je ajo tjetra, e huaja", dy lidhëza përçarëse që nuk të lenë të ndjehesh i plotë, po gjithmonë e ndarë. Një kërkesë e pashqiptuar për të zgjedhur njërën anë. Jetova gjatë brenda këtyre dy poleve. Ose jeton në vendlindje ose je e pa-atdhe! Ose je këtu ose atje! Ose shkruan në gjuhën amtare, ose nuk bën pjesë këtu! Ose vuan si ne, ose nuk ke të drejtë të flasësh për vuajtjet tona! Zëra që të ndjekin kudo. Të vjedhin qetësinë. Dilema dhe trazimi im. Nëse isha për njërën anë, përjashtoja tjetrën. Nëse isha për diçka, vihesha kundër tjetrës, që do të thotë se humb diçka."

Arapi i referohet në esenë e saj prekëse edhe shkrimtares britanike, Elif Shafak, e cila në "Udhëtimet e një nomadeje të gjuhëve", shkruan se edhe ajo e ka kaluar jetën e saj mes këtyre pikëpyetjeve. "A je një prej nesh apo një prej atyre?" Për Shafak si qenie njerëzore, nuk je kurrë vetëm një gjë e vetme. "Si poeti Walt Whitman, 'Unë jam i shumëfishtë'. '*I am large, I contain multitudes.*'" Një varg, por me fuqi shpërthyes që çliron ngurtësinë e të qenurit kyçur brenda "ose-ose".

Arapi shkruan, se ndonjëherë kthimi në atdhe, ku ajo vjen shpesh i duket si kthim në një tokë të njohur e të dashur, po edhe disi të panjohur. "Unë kam ndryshuar dhe vendi im ka ndryshuar gjithashtu. Ndonjëherë ndihem si turiste në vendin tim. Zbuloj gjithnjë e më shumë gjëra të reja, disa zona në qytetin tim janë krejtësisht të huaja për mua. Por kjo nuk do të thotë se nuk ndjehem më e lidhur me atdheun tim. Vetëm dashuria ime është bërë më e qetë dhe më e menduar, e krahasueshme me marrëdhënien e një çifti me dekada martuar.

Lindita Arapi i kushtohet edhe gjurmëve që le tek njeriu diktatura dhe mungesa e lirisë duke pyetur "një herë në diktaturë gjithmonë në diktaturë"? Ajo kujton dy shkrimtarët e famshëm rusë, Aleksander Solzhnicinin për të cilin vuajtja ishte purifikim dhe Varlam Shalamovin që mendonte se jeta në deportim e rrënon njeriun, dhe se nëse je një herë në kamp internimi, je gjithmonë në kamp internimi. "Jeta ime ndahet dyshas. Pjesa e parë: një jetë paliri. E dyta në liri. Të jetosh në liri nuk do të thotë patjetër të ndjehesh i lirë. I lirë do të thotë të marrësh frymë ndryshe. Zhdavaritet frymëmarrja e frikës. Këtë gjendje të lehtë si ajri, nuk kam për ta arritur kurrë, as në pjesën e dytë të jetës. Kjo shkujdesje, ky çlirim nuk është pjesë e ADN-së sime. Liria ime është e mundimshme. Hija e mungesës së dikurshme të lirisë është e gjatë. Pjesa e dytë e jetës është mëtim për të shpëtuar nga kjo hije. Se rrënjët e saj janë të ngulura thellë dhe dhembin kur shkulen. Ato janë historia ime. Vendlindja! Diktatura dhe izolimi! Baba e nënë! Fëmijëri e rini"! Traditë dhe ndrydhje."

ExLibris

SHPËTIM GARUCI: SHËMBËLLYESI I DRITËSHKRUESEVE BARDHEZI TË MARUBËVE NË PIKTURË

Ph.D. Oltsen Gripshi
Historian arti, kurator

Ekspozita: *"Shpëtim Garuci: Shëmbëllyesi i dritëshkrueseve*[1] *bardhezi të Marubëve në pikturë"*, vjen si një qasje tejet e rëndësishme për artin pamor shqiptar bashkëkohor. Frymëzimin për realizimin e dyzet e tre pikturave me teknikën e vajit mbi kanavacë, piktori shkodran Shpëtim Garuci e ka përftuar duke parë fotografitë e fondit të artë të Dinastisë Marubi, fotografive të Shan Picit, Kolë Idromenos dhe Pjetër Rraboshtës të cilat janë pjesë e koleksionit të Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi" në Shkodër, si edhe të Nikolin Babas dhe Grace Medina-s.

Kjo ekspozitë nuk është thjesht dhe vetëm shëmbëllimi i disa fotografive historike, por shumë më shumë se sa kaq, sepse falë tyre, piktori Garuci na fton të bëhemi bashkëudhëtar në udhëtimin e tij imagjinar, ndjesor e shpirtëror për t'i dhënë ngjyra e jetë të shkuarës së përjetësuar mbi celuloid.

Ai nëpërmjet magjisë së pikturës tonale me frymë midis romanticizmit oriental dhe hiperrealizmit mishërues mbi kanavacë, na shpie në një kohë të pajetuar, por që falë këtyre tablove të cilat kanë shëmbëllyer fotografi nga Marubët, Pici, Rraboshta, Idromeno, Baba dhe Medina duket sikur jemi pjesë përbërëse të tyre. Një udhëtim sa ndjesor, aq edhe mbresëlënës, që na udhëheq heshtur nëpër shtigjet e një Shqipërie tjetër, por të "rijetëzuar" përmes pikturës.

Falë cilësisë së lartë artistike dhe interpretimit pamor, kjo ekspozitë ka frymëzuar edhe shkrimin e një monografie të mirëfilltë shkencor, me autor Ph.D. Oltsen Gripshi. Një studim shkencor që analizon kodet stiliste-estetike dhe rrëmon proceset krijuese të artistit, që tejshkojnë: kohë, koncepte, gjendje psikoshpirtërore dhe qasje filozofike. Krijimatria e Shpëtim Garucit hulumton marrëdhënien e kahershme të tij në raport me Marubët, Picin, Rraboshtën, Idromenon, Baban dhe Medina-n. Ekspozita ngrihet në tjetër stad përmbajtësor, pasi ndërthur krijimin artistik të frymëzuar nga dritëshkruesja e Marubëve, Picit, Rraboshtës Idromenos, Babas dhe Medina-s me hulumtimin shkencor, duke përligjur marrëdhënien e ngushtë e të pandashme midis krijimit të artistit, që buron nga nënvetëdija e piktorit Garuci dhe dokumentimit të procesit krijues të tij nga historia dhe kritika e artit, nëpërmjet kësaj monografie shkencore.

Ekspozita *"Shpëtim garuci: shëmbëllyesi i dritëshkrueseve bardhezi të marubëve në pikturë"*, mbështetet në të dhëna historike dhe thellohet në teza filozofike gjatë procesit krijues për shndërrimin e imazheve bardhezi nga e kaluara në ato me ngjyra vibruese mbi kanavacë në bashkëkohësinë tonë. Proces, që shëmbëllen dritëshkrueset bardhezi të Marubëve, Picit, Rraboshtës, Idromenos, por edhe të atyre me ngjyra të Babas dhe Medina-s në imazhe të "ringjallura" në pikturë, duke i ofruar publikut jo vetëm një fushëpamje të gjerë për rëndësinë e madhe të pionierëve të fotografisë shqiptare, por edhe përjetimet ndjesore të vetë piktorit, që falë këtyre dyzet e tre tablove duket sikur prek "indet" e kujtesës së përbashkët të një kohe të dokumentuar magjishëm në celuloid.

Një ekspozitë dhe monografi shkencore që dritësojnë marrëdhënien antropike midis fotografisë si riprodhim i së vërtetës fizike, ashtu siç është dhe pikturës së Shpëtim Garucit, që dritëshkrueseve bardhezi të Marubëve, Picit, Rrraboshtës, Idromenos e atyre me ngjyra të Babas dhe Medina-s u jep shpirt nga shpirti i tij mbi kanavacë, për t'i bërë ato të pavdekshme në kohë të kohëve.

Garuci nuk ka bërë thjesht riprodhimin e disa prej fotografie më ikonike ikonike të këtyre fotografëve; ai ka ndërtuar një urë mes të shkuarës dhe të tashmes, duke përdorur pikturën për të kthyer një imazh të ngrirë në kohë në një kujtim të gjallë e poetik në pikturë mbi sipërfaqen e bardhë të kanavacës. Ndërsa fotografët janë kronikanët e heshtur të realitetit, Garuci është tregimtari që i jep shpirt figurës.

Ndaj tablot e realizuar nga Shpëtim Garuci janë kujtesë e rikrijuar, që nuk ka më funksion dokumentues, por rikrijues. Piktori shton elementë poetikë, si peizazhe reale nga Shkodra, duke i dhënë imazhve një të vërtetë reale, të prekshme dhe emocionale. Në vend të studios me sfonde falso, kemi natyrën — çka nënkupton një lidhje të re me rrënjët dhe tokën, një idealizim i jetës tradicionale që në realitet mund të ketë qenë më e ashpër në kohën kur Pjetër Marubi shkrepi fotografitë e para. Me shndërrimin e fotografive bardhezi në pikturë nga Garuci, e shkuara nuk shihet më si e "burgosur në kujtesë", por si një burim frymëzimi që mund të përqafohet dhe ripërjetohet në mënyrë estetike.

Në këtë dialog pamor mes Marubëve, Picit, Rraboshtës, Babas, Medina-s dhe piktorit Garuci, nuk kemi vetëm një ndryshim mediumi (fotografi kundrjetë pikturës), por një ndryshim mënyre të të parëit:

Marubi **arkivon** realitetin;
Garuci **interpreton** kujtesën.

Kjo është një bisedë mes së shkuarës dhe së tashmes — mes dokumentit historik dhe pikturës si përfaqësim i brendisë psikoshpirtërore dhe interpretimit semiotic nga ana e artistit Shpëtim Garuci.

1 Dritëshkruese – fotografi.

MARGARITA XHEPA DHE KUMTET E REVE

Nga Enver Kushi



Dy a tri vite më parë, aktorja e madhe e skenës dhe filmit shqiptar, mes të tjerash më ka thënë: "Prilli është muaji im. Pranvera është stina ime". Sa më lart, në një nga shkrimet e botuara në "Exlibris", kam nënvizuar: "Ajo lindi më 2 prill të vitit 1934. Ndoshta fillimprilli i atij viti në Lushnjë ka qenë me qiell të pastër apo edhe me re të bardha, që vinin nga hapësirat e paana të fushës së Myzeqesë dhe pasi kalonin mbi qytetin e vogël, iknin tutje kodrave të buta. Me siguri ka qenë një ditë me shumë dritë, siç janë shumica e ditëve në Myzeqe. Dhe nga kjo dritë ka marrë shumë Margarita Xhepa. Është një dritë e veçantë, që më vonë do të shpërfaqet në portretin, sytë, buzëqeshjen dhe nurin e saj...".

Ajo shkoi në amshim në orët e para të mëngjesit të 3 prillit. Lindja dhe shkuarja e saj nga kjo jetë, është muaji prill. Këto mendoja, teksa në orën 17:00 të kësaj dite të trishtë, ngjitja shkallët e katit të dytë të Shtëpisë Funerale "Alba", në anë të rrugës së Durrësit. Pastaj hyra në një ambient të madh, ku në qendër ishte arkmorti. U afrova, vura duart mbi xhamin e ftohtë dhe pashë trupin e pajetë të Margaritës. Mbi fytyrën e zbehtë, ishte hedhur një shami e bardhë, shumë e bardhë... Ajo dukej sikur flinte. Vështrova edhe një herë shaminë e bardhë dhe preka prap' lehtë, shumë lehtë xhamin e ftohtë, për të mos e zgjuar. Dhe përqafova Nastën, motrën e saj të pandarë. Edhe djemtë, Sokol dhe Ndriçim Xhepën.

Jashtë dita vazhdonte të ishte e mugët dhe Tirana m'u duk pa zë. Edhe qielli i saj i tillë m'u duk, i trishtë dhe memec. Ecja rrugës së Kavajës, mes këtij memecllëku të kryeqytetit dhe qiellit mbi të. Dhe i hodha një vështrim qiellit, ku ca re gri, përzier me të bardha, ardhur nga jugu, dukej sikur nxitonin e më pas qëndruan mbi Tiranë. Ç'ishte ajo shami e bardhë hedhur mbi fytyrën e pajetë të Margarita Xhepës? Ndoshta ishte një copë re e bardhë, ardhur nga fusha e Myzeqesë. Ishte reja e bardhë e prillit të Margarita Xhepës.

Këtë ja thashë të nesërmen Angjelina Xharës, skenariste e njohur, që ka shkruar një libër për aktoren e paharruar dhe me skenarin e saj regjisori Kujtim Gjonaj, realizoi filmin "Margarita". Ajo ishte pranë meje, poshtë shkallëve të Teatrit të Operas dhe Baletit, ku qindra njerëz, artistë, aktorë të njohur, regjisorë dhe të ardhur nga e gjithë Shqipëria, me nga një karafil në duar, prisnin t'i jepnin lamtumirën e fundit aktores së madhe.

Ora nuk kishte shkuar akoma 13:00, kur vura re që Angjelina, me celularin e saj, po filmonte qiellin mbi sheshin "Skënderbej" dhe ca re, që u shfaqën andej nga ishin varrezat e Sharrës.

E sheh? Mbi kokat tona qielli është blu, ndërsa andej nga Sharra ca janë gri dhe ca të bardha. Shih si lëvizin, shtoi. I thashë, se qielli ka alfabetin e vet dhe lum ai që e njeh këtë alfabet dhe di t'i zbërthejë kumtet që vijnë nga ato re dhe qielli. Pastaj, ajo me naivitet më pyeti, nëse unë e njihja këtë alfabet dhe çfarë kumtesh po vinin prej reve. Pse u shfaqën tani këto re, tha prapë ajo. Pikërisht tani që po presim t'i zbresë shkallët arkmorti i Margaritës. I fola për shaminë e bardhë, që pashë mbrëmë hedhur mbi fytyrën e pajetë të Margaritës, se ajo shami m'u duk si një copë reje e bardhë. Pastaj shtova, se është e vështirë të njohësh alfabetin e qiellit dhe kumtet që vinë prej tij dhe se shumë vite më parë, nga ballkoni i katit të katërt të hotel "Butrintit" në Sarandë, kam fotografuar retë që vinin nga Çamëria ime. Ato nuk ishin re, Angjelinë, por ishin shpirtra. Ishin shpirtrat e të parëve të mi.

Edhe këto që po filmon ti, janë re shpirtrash. Filmo, i thashë. E sheh atë renë e bardhë që po vjen me nxitim, sikur do të ulet mbi sheshin "Skënderbej"? Është shpirti i bardhë i Margaritës... Pastaj i fola për një ëndërr që kisha parë me Kadarenë dhe për pyetjen që ai më bëri për renë e bardhë, që shoqëroi familjen e nënës time, sapo kapërcyen Qafën e Botës. Kjo re, sipas nënës time, i shoqëroi deri në periferi të Kavajës... Ajo heshti, ndërsa vështrimet e të gjithëve ishin nga porta e madhe e Teatrit të Operas dhe Baletit. Po vijnë edhe re të tjera, tha Angjelina. Filmoje atë renë gri. E sheh? Atë, që herë është e bardhë dhe herë gri. Është Ofelia. Është Ofelia e Margarita Xhepës. Ajo është dhe do të jetë trëndafil i majit! Vajzë e dashur, Ofeli e ëmbël. Dhe m'u kujtuan fjalët e Ofelisë, thënë mrekullisht nga Margarita:

Të bardhë si dëbor' e kish savanin,
Me lule stolisur.
I vogël e i madh me lot e qanin,
Me zemër të zalisur.

Po ajo tjetra? Ajo tjetra që është si e nxirë? Është gruaja myzeqare e te filmi "Tokë e përgjakur". Ndoshta ajo re, kur të kalojë mbi sheshin "Skënderbej" do të hedhë ca pika shiu. Janë lotët e Margaritës te filmi që të thashë. Janë shpirtra resh pa zë. Memece. Sepse po të ishin me zë këto re shpirtrash, do të gjëmonte qielli i Tiranës, i Shqipërisë dhe Ballkanit.

Qielli mbi Tiranë u mbush me copa resh. Ca të bardha. Ca gri. Shumë gri. Ca të zeza. Ato përziheshin me njëra-tjetrën e pastaj ndaheshin... I thashë prap' Angjelinës të filmonte renë e zezë, që u shkëput nga të tjerat. Është Hekuba. Hekuba e tragjedisë "Trojanët", shkruar nga Euripidi. Unë dëgjoj zërin klithmë të Margaritës Hekubë:

Trojë moj Trojë
Trojë moj Trojë
E zeza Trojë!

Dhe m'u kujtuan fjalët e regjisorit të madh grek Vangjelis Theodhoropulos, që vuri në skenë "Trojanët". "Ajo (Margarita Xhepa) përcolli me energji tronditëse rolin e Hekubës, duke i dhënë frymë dhe ritëm në rritje gjithë shfaqjes. Dua t'i puth dorën për energjinë tronditëse dhe situatën dramatike".

Ndërsa Angjelina filmonte retë-shpirtra, doli arkmorti me trupin e pajetë të Margarita Xhepës. Qindra karafilë të bardhë u hodhën mbi të. Arkmorti u mbush me to... Dukeshin si copa resh të bardha, ardhur nga qiejt e Shqipërisë, Kosovës, Ballkanit.

Nuk e mbaj mend, se ku e kam lexuar një poezi që flet për mbrëmjen e një qyteti, pemët e menduara dhe gurët e kalldrëmta të menduara. Në Tiranë, mbrëmja e datës 4 prill, pasi përcollëm në banesën e fundit Margarita Xhepën, erdhi pa zë. Pemët, rrugët, gurët e kalldrëmta të lagjeve të vjetra të Tiranës, sheshet e kryeqytetit, banesat, ishin memece... Pastaj erdhi e nesërmja me qiellin e pastër e pastaj me re, që uleshin e ngriheshin në Sharrë, duke sjellë kumte të largëta dhe shpirtin e Margarita Xhepës.

Tiranë, më 4 prill 2025, mesnatë

RUDOLF MARKU

Si të ndërtojmë një poet

NË PRITJE TË PJETËR BOGDANIT

Nuk më thanë Sibilat para-shikimin, por atë që ndodhi me fatin tim,
Kohën kur endesha maleve dhe pyjeve si një ujk i vetmuar, me plagë,
Që ende kullojnë gjak, shkaktuar nga gjahtarët tinzarë.
Ndonjëherë jam vetë unë një shpatë
Që ka refuzuar të vendoset në Muzeum,
Për t'u admiruar nga njerëzit e veshur me lëkurë qëngji.
Vizitorët janë më të kënaqur, sepse Shpatë kurrë më s'do mbaj;
Në Muzeume armët mund të jetë paqësore deri në ndryshkje,
Fisin tim nuk e njoh, dhe as gjuhën e tij,
Kanë kaluar shekuj dhe ende dëgjojë zërin e Pjeter Bogdanit,
Që më thërret t'i bashkohem Çetës së Profetëve,
Por tani kordinatat kanë humbur,dhe askush nuk e di se ku është,
Kënga është thyer dhe fytyrat e njerëzve janë të errëta,
As drita e hënës së plotë nuk i ndriçon,
Bredh majëmalesh dhe pyjeve të dendur,
Pyes zogjtë e plagosur, larg nga qytetet moderne,
Që flasin një gjuhë që s'e kuptoj. Netëve shoh konstelacionet,
Dhe i ulërij Hënës me instiktin e lashtë të ujqërve,
Thjesht për ta mposhtur vetminë,
Këtu, në majën më të lartë të malit të Pashtrikut,
Në pritje se një ditë Çeta e Profetënve do më shfaqet,
Dhe unë prapë do shoh Pjeter Bogdanin,
Dhe mjekrren e tij si një kometë qiellore që vjen nga larg,
Në mesin e dy palë mjergullave të zeza,
Për të cilat ai flet në Librin e tij të mbathur me diell,
Thënë përmendsh, në gjuhën e vjetër të Perëndive, zëlartë.

mars 2025

RRUGËT ME GURË

1.
Na pëlqen të ecim në rrugën më gurë,
Mos thoni se rrugët e tjera i bëni për ne,
Rrugët e gjëra,të lëmuara si një sallon banke
Ku prisni të merrni çeqet tuaja,
Në rrugët me gurë dhe pluhur ne vazhdojmë të ecim,
Kokëfortë si një rënje;
Rrugëve që gjarpërojnë,
Pa e ditur se ç'ka pas ktheses që nuk e shohim.

Kurse rrugët tuaja janë të drejta, pa të papritura,
Të mërzitshme si një hapje goje pas një dreke të bollshme;
Nuk u besojmë parashikimit të motit,
Dhe as nuk na trembin lajmet tuaja,
Me avalanzhe dhe luftëra dhe ngritje çmimesh,
Ecim në rrugët me gurë të çveshur si një mençuri e lashtë,
Që mban përjetësinë e mbuluar me pluhur.

Na pëlqen të ecim pa u ndalë dhe kurrë nuk ndjehemi të lodhur,
Secili nga ne duke mbajtur mbi supe një mal,
Me atë lehtësinë që lypësit mbajnë trasten e fatit të vet,
Kur udhëtojmë drejt zotave sekret dhe fatlum
që askush veç nesh nuk i njeh.

mars 2025

NDONJËHERË

Ndonjëherë ndjej mallin e Odisesë,
Shtrirë në shtratin bashkëshortor pranë Penelopes besnike,
Për puthjen e sirenes mes dallgëve të detit;

Mallin e Akilit për atë frigen e papritur se mos nuk vdes,
Edhe pse Perenditë e Olympit
I kanë premtuar solemnisht pavdeksinë;

Ndonjëherë ndjej se jemi fare pak, si Orfeu
Ne jemi veç ata që do të vijnë pas vdekjes tonë,
Të joshur që të kthehemi pas, veç nga dorë shtrirë në terr;

Dhe ashtu si Dante Alighieri,
Ndonjëherë ne ndjejmë mallin për vendet që ende s'kemi qënë,
Mallin njëlloj për Parajsen a Ferrin skëterr!

prill 2025

NË BREG TË DETIT

Nga bregu i detit shoh sipërfaqen ku dallgët,
Vijnë dhe rrëzohen para këmbëvë të mia,
Në shkëmbin e trishtimit tim më të thellë si deti larg;
Ajo prapë është diku në një breg deti tjetër, a buzë oqeanit,
Më kot përpiqemi t'i bashkojmë në një drejtëz të gjatë distancat tona prapë,
Kam bërë rrugë më të largëta se dallgët, se alget,delfinët dhe peshkaqenët;
O shpresa të thyera, nga ju mësuan dallgët oshëtimat e përplasjes brigjeve.

Dëgjoj prapë poetët që besojnë se të vertetat janë larg, në thellësi,
Ndërsa unë vetë këmbëngul të deshifrojë humnerat e cektësive.

Prill 2025

DOBIA E DREJTSHKRIMIT

Shkruaj letra që kurrë nuk do arrijnë,
Njerëzve më të dashur, iu shkruaj pakujdes,
Letra që s'i marrin kurrë ndonjëherë,
Të vdekurve të dashur, yjeve në qiej,
Një planeti sekret, me të cilin nuk flas kurrë,
Iu dërgoj letra që asnjë postë nuk i merr,
Dhe ty, e dashur, të shkruaj netëve pa gjumë,
Për t'i grisur letrat në mëngjez copë e grimë.

Letra që nuk shkruhen kurrë, asnjëherë,
I shkruaj pa kaligrafi, pa bukurshkrim,
Me ë-të dhe ç-të dhe ll-të gabim,
Pa çarë kokën se nuk postohen kurrë,
Sepse të dashurit nuk na gjykojnë,
Shkruar nga zemra pa asnjë mendim,
Thjesht dashuri, siç e ndjen në fillim.

Kurse atyre që s'i duam iu shkruajmë me kujdes,
Me ortografi, bukurshkrim pa bërë gabime,
Politikanëve,bankierëve, borxhë-dhënësve me kamatë,
Drejtorì Ujnash, Dritash, e-Albanias në on-lajnë,
Sa shumë u pëlqen që t'u shkruajmë pa gabim,
Atyre që gabimisht u shfaqën në këtë botë,
Dhe që secili prej tyre në këtë Botë janë,
Një -ë- e pazëshme që bëjnë më shumë zhurmë,
Se trafiku i makinave në ditë-Festash në Tiranë.

Mars 2025

MË SHKRUAN...

Më shkruan me delikatesen e një gruaje të sofistikuar,
Ashtu siç je vetë- fjalët imitojnë atë që i shkruan-,
Pa e ditur se sa më qeta të jenë fjalët që më thua,
Aq më shumë zjarre në shpirtin tim ndez.
E di se jemi në shekulllin e Njëzet e Një,
Së shpejti Intiligjenca artificiale do të shpikë Marrëzinë Artificiale,
E cila do predikojë hapur paturpësinë dhe do të tallet
Me ndrojtjen time prej adoleshenti të moshës së tretë;
Ashtu si ai i aksidentuari buzë rrugës, në një vënd të shkretë,
Pret të dëgjojë i dëshpëruar një zë njerëzor, një lëvizje degësh,
A vetë sirenat e makinës së ndihmës së shpejtë,
Ashtu pres dhe unë të dëgjoj se si shkenca më në fund
Do shpall lajmin e shpikjes së mirëkuptimit të ndjenjave;
Se njerëzit si ti dhe unë kërkojmë një armëpushim me Terrorin brutal,
A me skërmitjen e dhëmbëve nga Ferri i njerëzve që nuk duan me dalë
Nga rrethet danteske, pse jo, komodë si një ves a plagë.

Kurse ti më shkruan me delikatesën e një shpirti të butë,
Dhe të tjerët na quajnë fajtorë, naivë
Se nuk dëgjojmë ulërimat e ujqërve në kafè, në Parlament, në rrugë.

Së shpejti Marrëzia Artificiale do na këshillojë një tjetër rrugëdalje,
T'i depozitojmë shpirtnat tanë në një bankë aty afër,
Që dhe ne të kthehemi në bashkësinë e njerëzve me lumturi të pafund!

mars 2025

SI TË NDËRTOJMË NJË POET

Më kanë ftuar që të shoh ofiçinën e ndërtimit të poetit,
Nuk mund të thuash se teknologjia është tepër moderne, nuk ka elektronikë,
Një poet mund të ndërtohet si një makinë, si ato modelet e vjetra,
Që ecën shpejt a ngadalë-sipas dëshirës së konstruktorit,
Natyrisht, pa kaluar limitin e shpejtësisë të vendosur me Ligj,
Ose si një anije e destinuar të vizitohet veç në breg të detit,
Pa lundruar asnjëherë, pa njohur kurrë shijen e athët të kripës,
Në fillim porositet një famë- bërës gazetash; një kritik me mision
I cili poezitë e Safos i ngatërron me tekstet e këngëve të Euro-Vizionit,
Nëse është burrë, nuk duhet të ketë opinion të lartë për gratë,
Dhe nëse është grua, nuk duhet të ketë fëmijë.
Poeti duhet të ketë vështrimin e qartë,
Që të mos përsëriten rastet e Homerit a të Borhesit të tmerrshëm;
Të verbërit besohet se shohin më mirë se ata me shikim të mprehtë,
Sepse shohim me imagjinatë, dhe dihen dëmet që imagjinata u sjellë njerëzve.
Nëse poeti do ndërtohet sipa modelit të anijeve,
Duhet ndërtuar që të qëndrojë jo në ujë, por në brigje gjithë jetën e vet,
Dhe nëse do modelohet sipas makinave, duhet te jetë elektrike,
Që t'ia heqim spinën nëse shohim tendenca mosbindjeje,
Dhe që të shmagen karambolet a rënjet në greminë gjatë ngjitjes për në Olymp;
Dhe nëse modelohet sipas arkitektures së grataqieleve,
Te këtë më shumë dhoma ngrënjeje se shtretër a sofa seksndjellëse,
Dhe nëse kërkohet të ndërtohet si anije kozmike
Të konstruktohet si një dhomë-komandë ,me elektroskopër gjigandë
Që shohin qiejt e errët netëve,
Ku flenë të qetë botuesit, rrethuar me llampat të ndezura butonesh
Të cilat do t'i pandehim si yje të një Universi që do zbulohen së shpejti.

mars 2025

NGA UDHËTIMET NË FRANCË

Sa herë që të udhëtosh qyteteve, maleve në Provancë,
Deti do të shfaqet papritë, çdo herë;
Ishte Një Janar. S'e mbaj mënd vitin e as nuk dua në mend ta mbajë.
Me dorën e djathë shtërngoja timonin me targë Ju Kej,
Ndërsa dora tjetër prehej në prehërin e saj.
Në mendjen time vinin emra trobadurësh me radhë,
Daniel Arnô, Rydel,Fransua Vijô, udhëtonim në Provancë
Dhe dora im e majtë zbriste poshtë, më poshtë, ngadalë,
Dhe nuk flisnim asnjë fjalë, por kuptoheshim më mirë se

kurrë më parë;
Ishin Trobadurët, Provanca a Dielli i saj?
Flisnin në heshtje veç shpirtnat tanë,
Derisa u ndalëm buzë një rruge. Natën e kaluar kishim qënë në Versajë,
Kishim admiruar shtretërit e mëdhenj mbretëror,
Portrete mbretërish, mbretëreshash numërikisht në radhë,
I dhjeti, i dymbëdhjeti, i Katërmbëdhjeti- ruá solei,
Dhe i gjashtëmbëdhjeti- numër terc, i pafat (gjashta është djallë).
Kurse ajo Ditë - Jona ishte Një Janar,
Dhe dihet që nga të vjetërit se atë që bën së pari atë ditë,
Do e bësh çdo ditë gjith' atë vit,
Dhe u çveshe krejt, dhe më the-Këtu në makinë,
Do bëjmë seks çmendurisht,
Le ta lëmë mënçurinë për Akademì Fransez,
Le t'ia lëmë shtratin më të madh Luigjit të gjashtëmbëdhjetë
Ai ka nevojë për dy vende njëherësh- trupi dhe koka të prerë barbarisht,
Kërkojnë më vend, natyrisht;
Le t'ia lëmë moralistëve shprehjet gjithë delikatesë,
Dhe vetë Volterit t'ia lëmë cinizmin shterp,
Dhe bëmë si të marrë në makinë seks
Ashtu me orë dhe orë, si askush tjetër më parë, dhe ishte Një Janar.

Dhe e dinin mirë të vjetrit- atë që bën në Një Janar,
Do e bësh një vit rrjesht, çdo ditë, pa u ndalë!

mars 2025

ECJA LAKURIQE E GRUAS

E çveshur lakuriq kalon përmes dhomës,
Madhërishëm, si një gjeneral perandorak në fushën e betejës,
Tek numëron fitoret dhe humbjet e ditës që shkoi.

Kjo është ecja lakuriqe e gruas pas aktit të seksit,
E sigurt dhe e pushtetshme, si një Mbretershë e Egjiptit të Lashtë,
Ndërsa unë vetë rri shtrirë mbi shtratin e madh të Fushë Betejes,
Si një ushtar – krenar nga çdo plagë që kam marrë.

Çdo gjë të sheh me admirim, Perendeshë lakuriqe e zbritur nga Olimpi,
Pasqyrat, pikturat e varura në murë, librat e bibliotekes,
Ekrani i fjetur i tv-s që zgjohet nga gjumi,lulet e ballkonit jashtë,
Madje dhe nudot e mjeshtrave pikturuar në Renesansë.

Ndërsa rrobat e tua perandorake hedhur mbi dysheme pakujdes-shëm,
Bëjnë ende dashuri ngatërrruar me rrobat e mia të ushtarit pa gradë.

mars 2025

SI NË METAMORFOZAT E OVIDIT...

Erdhe në dhomën time,
Duke parë me kujdes mos të shihnin të tjerët,
Me hapin e lehtë të mos dëgjohej ecja jote gjithë frikë,
Shtyve lehtë deren e dhomës,
Me lehtësinë e shfletimit të fletës së një partiture në muzikë,
Dhe mbyllëm më çelës dhomën nga brënda me lloz,
Si një libër modern hermetik.
Le të trokisnin tani forcat speciale a togat e ushtarëve,
Batalionet a Natos a mercenarët e Rusisë, a fuksat dhe patrozhonistët e Tiranës,
Le të merrnin në telefon- le të lëshonin urdhëra arrresti,
Ishim veç ti dhe unë, dhe yjet lart përreth
Që dinin çdo gjë rreth nesh...
Dhe si në metamorfozat e Ovidit,
Dalëngadalë ti u shndrove në një mosqënie që të kisha në krahë,
Në një mosqënie që do jetoje përjetësisht,
Pa u prekur nga ikja e viteve, nga plakja e kohës,
Nga harresa a frika e vdekjes,nga fjalët e njerëzve,
Dhe nga zilia çmontuese e pa-lumturisë së të tjerëve;

Me hapin e lehtë, të mos dëgjohesh nga askush,

Veç unë me të mbajtë prapë, në mosqënie, shtërnguar pranë meje...

Shkurt 2025

FLUTURIM MBI QIEJT E EUROPËS

Fluturoj mbi qiejt e zhubrosur të Europës plakë;

Jashtë dritareve, ca re hutaqe, dhe poshtë reve
Ushtritë që marshojnë. Duhet të jetë diku afër Fusha e Vaterlosë,
Ndërsa fqinji pranë, pi nje lumë shampanj dallgësh
- ndoshta Danubin, Rinin, a Lumin Volgë-,
Dhe fshin here pas here buzët me borë të virgjër Alpesh.

Më thotë se është drejtor i Bankes së Shpresave të Thyera,
Më tregon një pikë në tokë,
Ky është Strasburgu, këtu do ta bëjmë takimin, më thotë,
Për depozitimet me kamate të Ëndrrave Kote.

..E di se dhe në qiej kujtesa është një mjek i kujdesshëm
që përpiqet të mos ndjesh dhëmbje plagësh.

... Jashtë dritares kërkoj atdheun tim, nuk duket. Është larg,
Nuk është të pakten as dhe një pikë e vogel në hartë,
Fqinji im sapo ka ngrënë 12 shtete, në biznes klas,
Dhe unë që këmbëngul të arrijë në Tiranë sa më parë!

Veç pas dy orëve Stjuardesa lajmëron se ja, arritëm
Teksa avioni fillon të ulet në mesin e shkretëtires, në Saharë.

avion në fluturim, Shkurt 2025

NË ÇASTIN E FUNDIT

E di se në çastin e fundit,
Do të shtrish dorën drejt dorës time të pajetë,
Për t'i lypur mëshirë yjeve që shohin nga lart.

Vdekja nuk është asgjë. Veç të ikësh larg nga ti,
Është dhëmbje që nuk durohet as dhe përtej vdekjes,
Qoftë dhe për një çast.

Shkurt, 2025

DËGJOJ ERËN

Dëgjoj erën që fryn me vrull përmes pemëve,
Dhe ndalet papritë , sapo ndjen praninë time perreth.
Është natë, nuk e shoh nga cila pikë e horizontit vjen,
Por e ndjej se si trishtohet,
Kur e kupton se thjesht jam një qënie njerëzore,
Kur e kupton, se nuk jam as bimë e as pemë.

Jam i brishtë dhe i pafuqishëm para elementëve,
Dhe nuk mësova ta lexoj natyrën asnjëherë,
Si librat e vështirë që lexoj çdo mbrëmje.

Por era që unë nuk e di nga vjen,
Mbështillët rreth trupit tim,
Si një nënë rreth trupit të birit,
Kur sheh një rrezik të papritë,
Para se shtërngata të fillojë
Para se rrebeshi të pushtojë çdo gjë;
Vetë pemët më hedhin mbi trup gjethe,
Që t'më mbajnë ngrohtë, degët e pemëve përkulen,
Dhe më japin strehë. Një kurorë gjethnajesh e shtrirë,
Më bëhet më e sigurt se një çati shtëpie;

Por më vjen turp që as era dhe as gjethet nuk e dijnë,
Se ditëve jam druvari që i pres pemët pa mëshirë.

Shkurt 2025

LUTJE MIQVE PUPLORË

Mblidhen nga gjithë anët e botës zogjtë,
Me gjuhën e tyre universale të cicërimave, që s'ka nevojë për fjalorë,
Është koha për t'i ikur sa më parë të ftohtit,rrebeshit që vjen,
Unanimisht votojnë të fluturojnë larg, në një vënd të ngrohtë.

Sepse të gjithë zogjtë e dijnë se është një vënd i largët,
Mijëra kilometra larg,me diell dhe lule që sapo kanë çelë,
Veç njerëzit nuk kanë ndërmend të lëvizin as kur stuhitë fillojnë,
Nesër në ditëlindjen e udhëheqësit të tyre, kohë e mirë patjetër do jetë.

Njerëzit që besojnë te parashikimi i Motit, te leximi i qiejve,
Kjo vranësinë që sapo filloi, s'e ka të gjatë, nuk ka rrrebesh a shi,
Ata që nuk arritën t'i parashikonin as lindjet e veta,
Ata që vuajnë nga marramendja, kur shohin në qiell pafundësi.

Ndërsa zogjt nuk kanë as nevojë të përgaditen për udhëtimin e gjatë,
Udhëtojnë pa u ndalë,nuk bëjnë pushim as në ditën e Djelë
Dhe asnjërit prej zogjve nuk i kërkohet vizë. Miqt e mi puplorë,
Ju lutem, më bëni një vënd dhe mua drejt vendit tuaj me diell.

shkurt 2025

LETRA E FUNDIT E POETIT

Vetëm Lumi Danuvius më ndanë nga barbarët,
Më flasin tej bregut në një gjuhë të pakuptueshme, dhe i kuptoj menjëherë;
U lexoj poemat e mia, pa marrë vesh asgjë, tundin kokat e tyre mendueshëm,
Përpara se qetësisht të shpërndahen, si të treteshin në erë.

Po në Romën time, ku lashë miqt e mi poetë,lexuesit, librat e botuar,
Dhe dashuritë e mia, Korinen e çthurur, dhe gruan time të panjollë,
Perandorin e plotfuqishëm,kritikët e zinj letrarë,bibliotekat, akademitë,
A ka të paktën një njëri të vetëm mes tyre që prapë të më kujtojë?

prill, 2025

ARBEN BLLACI

Funerali i Sheme Shkretës

Tregim

Sheme Shkretës po i bëhej një jetë që i kishte lënë shëndenë punës së shtetit. Për pak vite, koha e pensionit thuajse i barazohej me kohën që pati punuar. Po zgjimi herët, pikërisht në kohën kur gjithë qyteti niste vrapin e zakonshëm e të mërzitshëm për të kapur oraret, i që bërë zakon me fuqi kushti. Pa atë kusht rrezikonte gjumin e madh...

Vishej me stërmundim. Dukej sikur rrobat i kalonte në një kënd të drejtë, në një skuadër ku brinjën vertikale e vishte me pantallona prej vitesh të njëjta, horizontalen e vishte me këmishën dhe një xhaketë ushtarake, po aq të njëjta sa edhe pantallonat. Vetëm në dimër shtonte kapotën e gjatë gjer te këmbët, si të pështillte e të varej në një degë shkarpe, jo në kurrizin horizontal të Sheme Shkretës. Në të vërtetë veshja dimërore që i tundej në kurrizin e shtrirë, thuaj paralel me rrogën ku zhvendosej, e tregonte më shumë si gërdallë njëthundraku të gdhirë jashtë, me shpinën mbuluar me batanije, sesa si njeri. Tek e shihje duke u zhvendosur ashtu, me ritëm të shuar, absolutisht të njëjtë, kokën, këmbët dhe duart vetëm mund t'ia merrje me mend, me sy nuk dallohej gjë.

Sheme Shkreta më lehtë sesa të quhej i kërrusur, mund të quhej i thyer. Aq i thyer, sa edhe shkallët nga kati i dytë i pallatit, gjer në rrugë i zbriste praptas për të mos u rrokullisur

Ndihej gjithnjë ligësht sa herë i duhej të thoshte a të shkruante, dikur në borderonë e rrogës e tani në letrat e pensionit, se tjetër s'kishte ku, emrin e tij. *Sheme Shkreta*... Akoma i dukej e s'i ndahej dot shija sikur shkretia bërë e plotë i lëshohej nga një lartësi e madhe, drejt e në kurrizin e thyer nga barra e pandarë në çdo hap të jetës së gjatë. Kush dëgjonte për herë të parë emrin e tij, aty për aty mbiemrin ia pandehnin si pasojë, si të ngjitur pas ndonjë gjëme të madhe..

E trashëgonte qysh se s'kujtohej më, nga një fis i rralluar që dukej se e mbante si nëmë, si aksident që e kishin pranuar të pafuqishëm për të ndryshuar gjë në fatin e tyre.

Rasti i Sheme Shkretës s'kishte lidhje me asnjërën nga këto mundësi. Fati i tij qe tërësisht i tij. Sikur qe prerë si mallkim, si ilustrim i gjallë shkretie, aq sa edhe tjetër mbiemër, më festiv të kishte trashëguar, dora - dorës atij vetë do t'i shndërrohej në shkreti. Shkreta...

Sa ishte akoma i ri bëri ca përpjekje për të mbjellë ndonjë shenjë gjelbërimi në shkretinë e vërtetë që paralajmëronte mbiemri i ngulur si tabelë. Po nuk i kishte ecur. Siç dukej nuk i pati ndodhur asgjë e posaçme që të mund t'i lëvizte diçka të dukshme monotonisë si lëngatë në jetën e vet. Ato pak lëvizje u ndjenë, ose më mirë, më shumë u nënkuptuan, siç ndodh të ndjesh në shkretëtirë një çlirim të brendshëm disasekondësh dhe të mendosh se fryu fresku i ndonjë flladi që përfshihet sakaq në rrymën furrë.

Përfundimisht kishte mbetur beqar. Po t'ia vije re pak në vëmendje jetën dhe mënyrën e të sjellurit me gratë, mund të mendoje se ishte ndoshta edhe i virgjër, pavarësisht se aty për aty mund të qesëndisje veten me këtë përshtypje në dukje anormale. Nëse e shihje pak me thellë, nuk rezultonte aq.

Qe kërrusur me shpejtësi që në moshën kur te një burrë vëmendja ndaj femrës zë e bëhet intensive. Për këtë arsye, përballja me to ishte një sforcim i madh, veç të tjerash, edhe fizik. Për të zgjeruar këndin e shikimit që ia ngushtonte mizorisht kërrusja, mbante gjithnjë një farë distance me këdo që fliste. Vështrimi thuajse i vëngër për shkak të deformimit të orbitës së njërit nga sytë, i vinte vulën përshtypjes së kontaktit të pamundur me femrën.

Dukej si krijesë e sajuar vetëm për të shkretuar.

Edhe vetë Shemja dukej i mësuar prej kohësh me këtë gjendje. Me dhimbje të thellë e të gjatë, po ishte mësuar më në fund. Vetminë ia bënte veçanërisht të pikëllimtë brenga se nuk arriti kurrë të kishte sikur edhe një fëmijë. Sidomos kjo mungesë i kishte dhënë vetmisë formë të prerë, e kishte bërë solemne duke i dhënë vit pas viti trajtën e një paniku të vërtetë për frymën e fundit, për funeralin e tij vetmitar. Kjo e tmerronte më shumë edhe se vdekja vetë.

* * *

Përpara se të merrej me çikërrimat kronike të ditëve të tij, i qe bërë zakon i hershëm të shkonte në të tria tabelat mortore që kishte ajo lagje. Njihej si qytet më vete për shkak të largësisë që e ndante nga blloku tjetër i qytetit. Banorët e ardhur vite më parë nga rrethina e deri provinca të largëta, njiheshin imtësisht si në një fshat të madh.

Për shpinën e dërrmuar të Sheme Shkretës, të lexonte a të shihte vetë kush kishte vdekur, qe punë e pamundur. Pyeste gjithnjë këdo që të ndodhej te tabela. Kur s'kishte njeri, thërriste kë t'i zinte syri në rrugë. Shumë prej tyre e dinin ç'donte Shemja. Ndodhte të ktheheshin edhe pa i kërkuar ai, kur e shihnin tek rropatej të drejtohej për të lexuar vetë lajmërimet.

"Në ç'orë është varrimi?"

Ishte pyetja më e rëndësishme sa ta fiksonte orën. Pastaj rrugës së kafenesë sikur e mbante nga krahu mërzia për të vdekurin.

Kafenë e tërhiqte me nge të madhe duke parë plot neps sesi tymosnin të tjerët rreth e rrotull. Vetë e kishte lënë prej kohësh duhanin, po siç dukej ia kishte dalë mbanë vetëm të mos e ndizte më, jo edhe të mos e donte.

Përhumbej me minuta të tëra në jetën e të vdekurit të mortit ku do të shkonte pas pak. Kujtonte për të edhe hollësitë më të imëta, pastaj i dorëzohej mërzisë që e bluante me veten. Në rastet kur i ikuri ishte bashkëmoshatar, ashtu larg e larg shpinte nëpër mend radhën e tij. Ndihej aty për aty i dërrmuar nga paniku i njohur, pikërisht funerali i tij i shkretë. Shkreta... edhe funerali. Për ta larguar si gjendje, ngrihej e çapiste për nga shtëpia e të ndjerit. Me shumë mundim ngjitej për të rënkuar, pastaj me mundim edhe më të madh, sa thua zvarritej në shkallët e autobusit të funeralit, zinte një nga vendet e para në krah, ose pas shoferit.

Në varreza ishte gjithmonë në vendin më të dukshëm.

"Ja ku jam, erdha!"

Kështu e dorëzonte qenien e tij të lexohej nga të afërmit e të vdekurit, besonte bile se edhe nga i vdekuri vetë.

Drekat mortore i zgjonin ngazëllim të çuditshëm. Ndoshta nga që të gjithë ishin dëshmitarë të pranisë së tij. Nuk e pranonte kurrsesi, po këtë çrregullim e pësonte edhe për arsyen se kishte rast të provonte kënaqësinë e gatimeve që vetë i shijonte shumë rrallë. Nga tavolina ngrihej gjithmonë i fundit, i fundit u jepte dorën të afërmve që viheshin në radhë në dalje. Pa mundur t'i shihte dot në sy, iu shtrëngonte dorën fort dhe ua shkundte dy-tri herë për t'iu kujtuar se ishte aty. Pa kaluar të shtatat bënte qokën me lekët e ndara qëllimisht për atë punë. Vetëm pas kësaj, në shtëpi, në një fletore të hershme, të lyrosur aq sa herë - herë stilolapsi shkiste pa lënë gjurmë në letër, shkruante emrin e të ndjerit dhe sa lekët kishte hedhur në qokë. Duheshin ditur...

Qysh nga koha kur kishte nisur të mbante këto shënime, i qenë bërë njëqind e nëntëdhjetë pjesëmarrje në varrime njerëzish të njohur e të panjohur. Që do të thoshte ndryshe, se po aq e më shumë njerëz do të ishin edhe në funeralin e tij.

"Mirë, shumë mirë!", thoshte i kënaqur me veten.

Sikur ndiente një padurim satanik ta vinte në provë mundin e gjatë për të bërë bashkë aq shumë njerëz në një kortezh. Në kortezhin e tij, në kortezhin e një shkretani si Sheme Shkreta.

Përfytyronte funeralin, lauzin e gjatë e të përzishëm tek e shoqëronte në varreza. Të tjerët tufë, ai në krye të të gjithëve. Një herë, vetëm një herë në tërë jetën e gjatë shkuar në krye të fundit. Përfytyrimi i mprihej habitshëm. Sikur ndiente në gjoks atë zbrazëtinë që zgjojnë gjendjet pezull, atë efektin e shkëputjes nga pirgu i dheut dhe zbritjes në varr, për çudi shpejt, aq shpejtë sa quhej i papranueshme për rastin.

Këtë mendonte gjithnjë, në çdo varrim. E revoltonte, i kallte panik ajo saktësia absolute e orës kur ngrihej arkivoli.

"Sa të saktë! Pastaj... pse kaq nxitim për ta mbuluar, mos do zbulohet gjë prapë e do shkojë në shtëpi...", habitej me vete.

I bëhej në vesh breshërimi i dheut të thatë a shumicën e herës të lluctë në dimra, mbi dërrasën e kapakut të arkivolit ku qe shtrirë vetë. I dukej sikur përpara se të shkëpusnin çdo lidhje me të, i hidhnin në gropë edhe mbiemrin, atë Shkretën e tij kobzezë dhe pastaj rrihnin me lopata faqet e kapules së dheut përsipër, thua siguroheshin se kthimi tani e tutje qe i pamundur.

Në raste të tilla dalldie, truri i Sheme Shkretës që kurrë nuk qe dalluar për ndonjë mprehtësi të veçantë, ndihej i lodhur, dhimbte si krijesë mjerane e rrahur barbarisht...

* * *

Varri ku do kallej Novruzi, miku i tij i vjetër, iu duk më i errët nga sa janë rëndom varret. Drita e ditës sikur pritej e tërhiqej te buza gropës, duke lënë të zbriste gjer thellë atë të errëtën e tepërt që nuk po i pëlqeu Sheme Shkretës. Edhe pirgu i dheut ku kishte hipur vetë, iu duk shumë më i lartë se herët e tjera, aq sa ndjeu t'i merrej lehtë mendja. U ndje i përfshirë edhe nga një shije kotësie, mungese dëshire të lëvizte sikur edhe gishtin.

E pse duhet të binte se s'bën në sy që kishte ardhur? Shumica e njihte, e dinte edhe lidhjen mes tij dhe mikut që po përcillte në botën e tejme. Ndonjë rrufjan e kishte nuhatur edhe shkakun e zellit të jashtëzakonshëm për të qenë përcjellës i çdo të vdekuri në atë lagje, po edhe lart, në qytet.

"Ka hall mos e lënë mbi dhé a mos përfundon mësimore për kasapët e rinj të spitalit", tallej pas shpinës së thyer të Shemes ndonjë vrromash.

Zbriti nga pirgu ku kishte hipur dhe ndenji afër fare, buzë varrit. U përpoq të gjente brenda në gropë atë dritën e zakonshme si të spërkatur me pluhur neoni të verbër. Po shihte errët. Për pak besoi se faji s'qe i dritës, qe i tij.

Nëse të tjerët përkuleshin, mbushnin dorën me dhé për të hedhur mbi Novruzin e shkretë, Sheme Shkreta qe gati, ashtu i thyer më dysh, me hundë as një pëllëmbë mbi pirgun e njomë. Vetëm sa zgjati dorën, mori një grumbull kokrrash balte dhe i hodhi mbi tabut. Iu dukën më të rënda se rëndom dora me dhé. Iu bë sikur arkivol bëri zhurmë si të kishte hedhur saçme metali mbi kapak, jo baltë aq sa i mori dora e dobët.

Pa rrotull, por te askush nuk e ndeshi pandehmën e tij. I qe dukur...

Takimit me rreshtin e të afërmve të përzitur, si rrallë herë, iu shmang. Ashtu, si të shkelte në një rrugë shtruar trashë me pambuk, ku hapi e humbte peshën dhe më shumë ndihej në rënie të vazhdueshme sesa në ecje, arriti te autobusi dhe pa kuptuar fare si ia doli ta bënte, u ul në vendin e tij. Pati shijen se nëse do ishte vonuar edhe pesë minuta, nuk do mund të ngjitej dot më në ato shkallë që iu dukën tmerr të larta.

"Ka qëndruar pjerrët", tha me vete dhe picërroi sytë të sigurohej nëse në autobus qe mjegullt apo i dukej atij. Po ndiente lodhje në duar e në këmbë, iu duk sikur shpina i qe kthyer befas në një barrë plumbi që po i thyente shpatullat.

"Ah, Noke, Noke!", qortoi me zë mikun sikur të kishte bërë faj pse kishte vdekur dhe mbështeti tëmthin në xham.

* * *

Nga autobusi nuk zbriti dot vetë. As praptazi si zakonisht. Nuk mori vesh kush e ndihmoi. Kuptoi vetëm që e pa veten ulur në stolin rrëzë një rrapi të lartë, degëdendur, hapur si parashutë e madhe qiellore.

Gumëzhinte nga zogjtë dhe nga zhurmërima e rrëkeve të një shatërvani që e shndërronte atë zhurmëri në një psherëtimë masive përshpirtjesh.

Sheme Shkreta ndjeu këputje, përtesë të lëvizte sikur edhe gishtin. Sytë i mbetën mbërthyer mbi gjelbërimin e sheshit të shtruar me bar. Iu bë se shquajti hije që afroheshin. Shtoheshin...

"Kortezhi... Lauzi..."

Ndjeu mendjen t'i gjallërohej si një mëhallë ndaj mëngjesi kur zë e zbardh dita. Sikur u çlirua nga mpirja.

U vu të numëronte.

"Njëzetë... pesëdhjetë e... njëqind... njëqind e shtatëdhjetë e..."

Hijet sa vinte lidheshin e ngjisheshin. E ndjente të vështirë ta ndante në hije të veçanta atë bllok të murrmë që mbuloi sheshin e lulishtes.

"Njëqind e nëntë..."

Nuk arriti ta shqiptonte të plotë numrin e artë që për ta mbërritur i kushtoi jetën. Një goditje së brendshme i sosi frymën, i thau sytë, i plasi zemrën.

Infarkti shkarkoi njëherësh, si përqendrim tërmeti, shumë më i rëndë nga ç'nevojitej për të zbërthyer nga kolona atë grusht eshtrash të mbuluara me lëkurë, atë send të thyer që quhej Sheme Shkreta. Mbeti i gozhduar, mbështetur në stol si në gjumë. E fundmja gjë që mundi t'i mbërrinte në vesh e të ngurosej aty si në një fole akulli, qe ulërima e gjatë e zogjve dhe zhaurima e shatërvanit. Përshpirtja e kortezhit të tij...

Gjithë pasditen e gjer vonë natën, kushdo që kaloi andej pari e pandehu në gjumë. Vonë, përtej mesnate punëtorët e pastrimit e panë, i folën, e tundën, e shkundën...

Po Sheme Shkreta kishte ngrirë. Me njërën dorë mbështetur te dërrasa e stolit si në një të ngritur të pamundur, me tjetrën kapur në njërën nga degët e rrapit që për çudi vareshin gjer përdhe. Ashtu patën qenë apo u nderën të kapej pas tyre Sheme Shkreta, si të mbërthehej pas një parashute që do ta ngrinte nga krateri që po e rrufiste duke gromësirë bubullima. Nofulla e varur në gjoks, zbulonte gjuhën e zgjatur si këmbëngulje e mbrame për ta thënë të plotë atë "njëqind e nëntëdhjetë", si porosi lënë gojës nga shpirti që ndërkohë kishte marrë qiejt, duke lënë Sheme Shkretën një dorë kufomë, mbuluar pa kujdes vetëm nga varrmihësit e lodhur, në një rrëzë varreze caktuar nga ndërmarrja funerale.

Si një i shkretë...

KOSTA NAKE

Te sitka e koles

Përsiatje

Kanë kaluar më shumë se gjashtë dekada që atëherë, janë ndërruar dy breza njerëzorë, prandaj këtë largësi kohore, nganjëherë e përcaktojmë me shprehjen "në kohën e qepës", një mënyrë të jetuari që nuk do të kthehet më kurrë. Kishte edhe një hosten diell kur im atë ngarkoi dy vandakët me bar në samarin e kalit, më ngriti në krahë, më vendosi mes tyre dhe morëm rrugën e dherit për në fshat. Arat tona ishin buzë lumit, ishin pjesë e Ormanit që e kishte marrë rrjedhën në mes dhe duhej rreth gjysmë ore në këmbë për t'u në shtëpi. Te cepi perëndimor i arës kishte një kryqëzim rrugësh bujqësore që përshkoheshin nga kafshët e samarit, qerret dhe rabat. "Rabë" ishte fjala devollite për karrocat që ishin me dy rrotë dhe tërhiqeshin përgjithësisht nga një kalë i vetëm. Djathtas rruga shkonte drejt vendit të shenjtë Inonisht dhe më tej drejt Kuçit, djathtas drejt fshatit Dobranj, përpara – drejt veriperëndimit ishte rruga e Poloskës. Sa morëm të përpjetën, mbërriti një këngë që, me sa dukej, nisej nga Sitka e Koles dhe shpërndahej një trajtë elipsi prej shtytjes së erës. Burra e gra kishin mbaruar korrjen, kishin lidhur duajt, i kishin bërë kapule dhe, në pritje të qerreve, kishin filluar të këndonin. Ishte fundi i korrikut, toka e kuqe që fillonte nga Inonishti dhe shtrihej deri në krye të pllajës së Dëmbravës, ishte e thatë dhe e plasaritur, linja milingonash të ngarkuara dhe gërshërëzash të veçuara ende nuk i kishin mbyllur punët e ditës.

Kur kaluam Sitkën e Koles, kishte edhe një mashë diell, re të lehta puplore atje larg mbi malin e Moravës dukej sikur po prisnin uljen e lëmshit të zjarrtë në perëndim, që të zbehte blunë mbi shpatet e largët dhe t'i ngjyroste me të florinjtën duke hedhur tufa të ndritshme mbi gjithçka. Në të majtë, nga lugjet e Verinjve u shfaq një tufë dhensh që dukej sikur kishte marrë një nuancë të kadifejtë nga pluhuri që ngrihej dhe nga rrezet që e përshkonin. Përfund tufës vinte Shabani me tre qen të mëdhenj, bariu i fshati tonë që po kthehej nga kullota, edhe në verën e nxehtë më shfaqej si imazh me gunën e bardhë dhe fyellin e gjatë. Tufa u shfaq dhe humbi se bariu zgjodhi rrugën ndanë korijes që dilte në jug të fshatit dhe Shabani e kishte vendosur fyellin dhe mbante në dorë kërrabën.

Sitka e Koles ishte një lëndinë e ngushtë që shtrihej nga lindja në perëndim dhe burimet që mbanin gjallë barin e shkurtër dhe sitkat e gjata, shfaqeshin aty-këtu vetëm në dimër e pranverë, prandaj më shumë shërbente si shesh lojërash për fëmijët se sa si kullotë. Rruga jonë e priste vertikalisht Sitkën e Koles dhe pas nja dyqind hapash futej në mes të korijes me dushk për të zbritur te një luginë tjetër, paralele me Sitkën e Koles. Pikërisht në hyrje të korijes kishte plasur kënga. Burra e djem këndonin dhe korija e dendur, e freskët, rrethuar me lule dhe mbushur aroma, u përgjigjej këngëtarëve me tinguj të këndshëm, e pranonte dhe e merrte këngën e tyre aq lirshëm saç e këndonin. Fshatarët e mi ishin njerëz të shkujdesur, miqësorë, të etur për punë dhe me këngët spontane zbulonin pavetëdijshëm bukurinë e shpirtit dhe kënaqësinë e punës. Prej më shumë se një shekulli, deri në mbylljen e kufijve, ata shkonin deri në thellësi të fushave të Greqisë si korrës dhe kositës me nam, mësonin ca fjalë greqisht sa për biseda të thjeshta dhe sillnin bashkë me të ardhurat edhe histori nga fqinjët. Mbrëmja ishte e këngës, se këta djem e burra e kërcenin mjeshtërisht devolliçen dhe ishin në një përballje të vazhdueshme me fshatrat e tjera jo vetëm në festivalet e përvitshme folklorike,

por edhe në dasma dhe mbrëmjet e vallëzimit. Më tërhoqi vëmendjen Zahiri, një hamshor që ishte roje fushe, por shokët e vet të grupit Refiku dhe Shefiku kishin dërguar ndonjë fëmijë për ta thirrur, sepse hijet që zgjidhte ai, ishin pak a shumë të njohura.

Nga shpina e kalit i pashë që ishin ulur te ledhi ndanë rrugës e këndonin, vajzat e grate iknin ca më pare, se kishin punë të tjera shtëpie për të bërë pasi gjithë ditën kishin korrur më shumë se dy dynymë nga deti okër I grurit, të tjerë shkonin të mbushnin ujë te çezma në fund të lëndinës dhe shërbente si burimi kryesor i ujit edhe për vendin e shenjtë nën lisat shumëshekullorë. Shishet e qelqit të mbushura me dhallë dhe të taposura me koçanka misri tashmë ishin zbrazur, prandaj i lanin e shpëlanin te çezma dhe i sillnin të mbushura me ujin e ftohtë për të tjerët. I shikoja si pinin ujë me shishe duke e mbajtur grykën e përmbysur pak larg gojës së hapur, nën dritëne diellit dukej kur uji kalonte nga një grykë te tjetra me dy gurgullima të ndryshme; pinin aq gjatë dhe aq ëmbëlsisht si pinë vetëm kafshët dhe siç pijnë bujqit e mirë e të shëndetshëm.

Lelekët që prisnin si brisk, me ato qafat e gjata si lejlek dhe që ndrisnin ende, pallamarët që ishin si dorashkë druri, ishin lëshuar mbi trastat e zbrazëta të bukës. Herë të tjera i kisha parë si kositës, me kosat që i hidhnin mbi sup dhe shkëlqenin si jataganë pas shpinave. Kur fillonin kositjen, lëviznin duke i hedhur kosat e tyre në çerek rrethi pa përpjekjen më të vogël, duke llamburitur presat në gjysmëharqe të gjerë, duke goditur ndonjë cung, gur a shkurre me ato "ah!"-et e rregullta pa tendosjen më të vogël, secili në mënyrën e vet, por edhe në harmoni, me atë gjurmën jashtëzakonisht të bukur që linin pas, bashkë me barin ose jonxhën e korrur. Dhe ishte një bukuri shumë të veçantë, safi devollite, ndjenjat që shfaqeshin me pëshpërima dhe copëza fjalësh përkëdhelëse që të kujtonin Naimin me "vendëthit e bekuar" me shpresat dhe lumturinë e tyre.

Perëndimi ishte ende i ndritshëm pas drurëve të gjelbër dhe dukej sikur edhe kënga merrte dritë prej diellit dhe trishtim prej korijes. Im atë e vuri re me sa vëmendje po i shikoja, ai vetë ishte këngëtar, prandaj e mbajti kalin për të dëgjuar. Nuk do t'i harroj kurrë ato buzëmbrëmje me atë bukuri mahnitëse të këngëve. Ndoshta bukuria e tyre fshihej në atë përgjigje që vinte nga korija, në fëshfërimën drithëruese të dushqeve. Ishte bukuri që lidhej me gjithçka që pamë dhe ndjemë, ishte bukuri që i bashkonte njerëzit sikur të ishin të një gjaku, një lidhje me kalimtarëve dhe atyre, mes nesh dhe korijes isombajtëse, arës së korrur dhe kapuleve me duaj si njerëz që luajnë kaladibrançe, lëndinës që dukej sikur lëshonte një afsh si ai i flakëve të zjarrit. Ishte ky ajër fushe që kishte mbushur mushkëritë tona që në fëmijëri, në buzëmbrëmje si kjo, me re të trëndafilta mbi mal, me lulet që i kishin bërë ballë korrikut dhe kokrrat e egra të panumërta, mes të cilave manaferrat me ato kërcejtë e thatë që ca bletëza të imta ua hiqnin palcën dhe i mbushnin me një ëmbëlsirë të verdhë si mjalti, por të ndarë në porcione të vogla dhe përbënin një ushqim shtesë për fëmijët që kullosnin lopët e familjes.

Bukuria ishte në atë që edhe sikur të mos këndohej aspak, por vetëm të pëshpëritej, kënga mbinte e rritej në kraharor, spontane, me një lehtësi e natyrshmëri të pakrahasueshme e cila ishte aq karakteristike sa nuk dallohej cila këngë ishte e njohur dhe cila e porsakrijuar. Kjo bënte që njeriu të ndjehej aq i freskët, aq i fortë, aq naiv për fuqinë dhe talentin e tij. Shumë këngë dukej sikur kishin nevojë vetëm të pëshpëriteshin se korija do t'i përgjigjej me mirësi dhe ëmbëlsi dhe nganjëherë duke lartuar fëshfërimëm për ta kthyer në fishkëllima që mbushnin fushën dhe luginat.

"Më fal, dhe lamtumirë, mikja ime e dashur,

Lamtumirë, o fshat, të them zemërplasur..."

Secili dukej sikur kishte një rënkim në mënyrën e vet, me një masë të caktuar trishtimi dhe dashurie, me shkujdesje dhe qasje të pashpresë.

"Mikja ime jo besnike, në do që ta dish,

Për ty s'ma nxe goja të them që u prish..."

Këndonin tre vetë duke u ankuar dhe dëshiruar në mënyra të ndryshme, duke theksuar fjalët në mënyra të ndryshme dhe isoja e të gjithëve bënte që të gjithë të shkriheshin në një harmoni perfekte duke ndier deklarimin deri në ekstazë, duke zbuluar kokëkrisjen rinore para fatit dhe një zemërgjerësi të jashtëzakonshme për të falur.

"Nëse ti s'më do se je zemërngrirë,

Harromë, harromë, në se gjen më të mirë..."

Gjithçka në korije i përgjigjej me një forcë miqësore, lirshëm dhe tingëllimi gjoksor i zërave të tyre tretej tutje dhe përsëri buçiste me zë të lartë:

"Në gjen më të mirë, harromë përherë,

Por, po qe më i keq, si do bësh, moj e mjerë?..."

Ç'ishin gjithë ato pandehma të pashpresa? Një njeri nuk mund ta besonte ndarjen falë forcës së pamposhtur edhe në çastet kalimtare me mungesë shprese, se dashuria ka vetëm lindje. Më vonë do të arrija në përfundimin se këto nuk ishin këngë të shpirtrave të dobët, sepse për ata nuk ka shteg apo rrugë askund, nuk qajnë me ëmbëlsi dhe nuk u këndojnë brengave të tyre.

"Dielli i kuq pas korijes së errët u ul,

Mbi këngët e zogjve heshtja heshtën e ngul..."

Nata e errët na rrethon me pushtet shkretëtire, megjithatë gjithkush ndjehet i lidhur ngushtë me këngën, duke jetuar për të, i virgjër dhe plot fuqi magjike sepse rreth e rrotull ka një strehë, ka mall, dikush ndërmjetëson për ata që ndjehen në periferi, dikush kujdeset që mos mbetet ose harrohet nga inventari i mjeteve të punës, një zë pëshpërit, një dorë bën shenjë për të dërguar mesazhe dashurie.

"Mos u bëj, pra, për mua egërsirë

Se mëngjesi nesër vjen më i mirë,

Asgjë të pamundur s'kam patur,

Fli tani, gjumë të ëmbël, e dashur!"

Kishte edhe një gjë në ato këngë, diçka që fshatarët e mi e dinin mirë: në thellësi të zemrave të tyre ishin pafundësisht të lumtur. Tani ato këngë më duken të largëta, të paarritshme dhe të pakthyeshme. Sepse ka një segment të kufizuar kohe për gjithçka, përrallat pothuajse u zhdukën nga bota e fëmijëve, bashkë me to mbrojtësit imagjinarë, prandaj që në adoleshencë ata e kanë marrë në dorë fatin duke mohuar profetët dhe duke zgjedhur mjete të dhunshme për hapjen e rrugëve dhe shtigjeve.

YLLI AJDINI

Kopshti i ëndrrave

Pasi dërgova mesazhin, lashë butësisht aparatin e celularit mbi tavolinë dhe pas pak sekondash u ndodha i vetëm në hapësirën e ngushtë të ballkonit. Që nga aty po sodisë i papërqëndruar asgjë të kuptimtë. Për shkak të pozicionit, rrezet e diellit nuk bien kurrë mbi ballkonin tim. Ndoshta për këtë arsye ajri këtu është gjithmonë i freskët. Ra zilja. Nuk e pata vështirë për ta dëgjuar pasi tonin e volumit të celularit e kam regjistruar në maksimumin e vet. Por edhe sepse derën që të çon në sallon, nuk e kam mbyllur plotësisht. Në formën e një engjëlli menjëherë më erdhi e më pushtoi një kënaqësi e çuditshme. Nuk e besova. Kaq shpejt!!! U gëzova! Shkëputa mendimin mosbesues nga trupi dhe u futa menjëherë e rrëmbyeshëm përsëri në sallon. Aty për aty fytyrën e freskuar nga ajri i përjashtëm, ndjeva që ma rahu ngrohtësia e kondicionerit "Midea". Nuk preka gjë tjetër, por morra me vrull celularin nga mbi xhami i errët e i trashë i tavalinës së mesit dhe lexova emrin. E pashë qartësisht, por...nuk ishte askush. Fillova e vazhdova ta shikoj përsëri ekranin edhe kur u ula në divan. Pavarësisht zhgënjimit, mendimi më shkon përtej imagjinatës. Por ky është vetëm një çast. Pastaj u qetësova siç më ndodhë ngahera. Për këtë jam mëse i sigurt. Por është pikërisht përsosmëria jote që mua më ushqen ende ëndrën mbi ekzistencën e parajsës. Por nuk e di a jam i denjë për të?

-Jam veç për ty,-dëgjova. Pastaj shtoi,-Por dua të mbetem e padukëshme, jo reale për të tjerët.

"E vërtet është kjo dëshirë që po më thëret"? Gjithsesi, thënia veç që më befasoi, edhe më lumturoi. Fundja unë nuk jam një heretik i ndjenjave e i dashurisë njerëzore. I ekzaltuar shtriva menjëherë krahët dhe me gishtrinjtë në formë peneli, e vizatova Atë në ajër, në mënyrë të atillë, që ta shohë e ta prek vetëm unë. Me ta formësuar, ndjeva dorën e kësaj fryme të shenjtë të shtrëngoj timen.

-Mikja ime! E di që më beson, por kurrë mos dysho tek unë. Heshtjen dhe besnikërinë e kam gjëndjen time normale, i pështpërita dhe menjëherë e tërhoqa pranë vetes për të marr bekimin. -Për mua ti je tepër e veçantë, vazhdova dhe i thashë. Isha në momentin e heshtjes, kur ajo ndërhyri:

- E di. Edhe ti për mua! Ndërkohë më shikon dhe e shikoj. Pushtohemi natyrshëm. E para më puth ajo, pastaj unë. Midis nesh nuk ka më hapësirë. Në vazhdim më prek, e prek gjithandej. Nuk lëvizim. Pastaj lëvizim. Ndjejmë që jemi e pse jemi. Mbyllim sytë dhe bëjmë dashuri. Më pastaj mbajta frymën për mos ta trembur. Tani po që kam një arsye për të besuar. Por nuk mund të vazhdoja e ta shikoja më me sy të mbyllur. Më duhet dhe ta shohë jo vetëm në parafytytrim. Kur i hapa sytë, për fat të keq imazhi s"ishte më pranë meje. Pash ngultasi përqarkë sallonit. Por nga ç'po kuptoj, gjithçka ishte veçse një iluzion i momentit. Kjo më shkakton ndjesinë e zemërimit. Sidoqoftë, nuk duhet ta largoj më kurrë celularin nga vetja", mendova. Ndoshta ishte dhe kjo distancë midis meje dhe celularit, pse s"ishte realisht dikush. Por edhe pse këto janë detaje të parëndësishme, vendosa që në vazhdim edhe në ëndrra, gjithmonë do e mbaj aparatin nën vesh. Ku i dihet, herën tjetër mund të jesh vërtet Ti! Sa më pëlqejnë çastet kur bie zilja apo kur lexon një mesazh përkëdhelës! Dhe është kjo arsyeja, pse nuk dua të fshehë as diçka që ndoshta jo të gjithë e dinë: Lumturinë e sjellin shpeshë herë edhe disa aluçinacione e gjëra të thjeshta! Dhe pavarësisht se kjo mund të jetë me të vërtet një perceptim e ndjesi e gabuar, gjithsesi unë e ndjeva veten mirë nga ky lloj zhgënjimi e ankthi njëherësh.

U ngrita. Nuk kam më arsye të qëndroj i vetëm në sallonin me shumë pak dritë natyrale. Dola. Nxitoj të dalë në rrugën kryesore. Sidoqoftë, kësaj rradhe telefonin e kam me vete. Ku i dihet. Ndoshta më çfaqet përsëri. Dhe kjo "përsëri", nga ç'po më thotë intuita, është e sigurt që do të ndodhë nesër. Gjithsesi, kuptoj se mendimet më janë mbushur plot e përplot me dëshira të pafundme.

SIMBOLI I TRËNDAFILIT TE "PRINCI I VOGËL"

Një histori dashurie e pakushtëzuar

Nga Laura Born/ Eagle's Nest

Simboli i trëndafilit te "Princi i Vogël" zë një vend thellësisht të rëndësishëm në histori. Përveç bukurisë së tij delikate, ai shërben si një simbol i fuqishëm, duke ofruar kuptime mbi kompleksitetin e dashurisë, marrëdhënieve dhe individualitetit. Pra, çfarë simbolizon trëndafili në "Princi i Vogël"?

I frymëzuar nga lulja ikonike e "Princit të Vogël", ky simbol magjepsës kap thelbin e dashurisë, bukurisë dhe rezonancës emocionale.

Por përtej hijeshisë së tij estetike, trëndafili mbart një domethënie të thellë simbolike. Në letërsi dhe art, trëndafili ka qenë prej kohësh i lidhur me temat e pasionit, përkushtimit dhe kompleksitetit të marrëdhënieve njerëzore.

Po te "Princi i Vogël", çfarë simbolizon trëndafili?

Në të njëjtën kohë, edhe brishtësinë, edhe qëndrueshmërinë e marrëdhënieve. Ashtu si trëndafili i princit, çdo person dhe përvojë në jetën tonë është unike dhe meriton kujdes. Qoftë në një lidhje romantike, në një miqësi apo në një lidhje familjare, trëndafili na kujton të duam dhe të kultivojmë lidhjet që i japin kuptim jetës sonë.

Trëndafili prek disa tema universale të lidhura me marrëdhëniet dhe me dashurinë. Le t'i eksplorojmë se çfarë mund të mësojmë nga ky simbol i përjetshëm.

Dashuria dhe përkushtimi

Trëndafili përfaqëson dashurinë e madhe dhe përkushtimin e princit. Pavarësisht të metave të saj dhe kryengritjeve të herëpashershme, princi e adhuron dhe kujdeset për nevojat e saj, duke e mbrojtur nga kërcënimet e jashtme. Kjo paraqitje vë në pah fuqinë transformuese të dashurisë dhe dëshirën për të investuar kohë, përpjekje dhe energji emocionale në kultivimin e marrëdhënieve.

Brishtësia dhe papërsosmëria

Trëndafili përfaqëson gjendjen njerëzore dhe vështirësitë e brendshme në marrëdhënie. Edhe pse ka një bukuri të jashtme, trëndafili nuk është pa të meta dhe shpesh shfaq tipare kotësie dhe krenarie. Kjo na kujton se dashuria e vërtetë kërkon pranimin dhe kuptimin e mangësive të ndërsjellta, si dhe dëshirën për të falur dhe për t'u rritur së bashku.

Dëshira dhe largësia

Largësia fizike e trëndafilit nga princi, për shkak të vendndodhjes së saj në planetin e tij të lindjes, simbolizon mallin dhe distancën në marrëdhënie. Gjatë romanit, princi ndien vetmi dhe dhimbje ndërsa mendon për trëndafilin e tij të dashur dhe shqetësohet për mirëqenien e tij. Kjo dëshmon vështirësinë e krijimit të lidhjeve emocionale pavarësisht largësisë fizike.

Identiteti unik dhe rëndësia

Megjithëse është një prej shumë të tjerëve, trëndafili i princit është i rëndësishëm për të për shkak të kohës dhe përkujdesjes që i ka kushtuar. Kjo vë në pah nevojën për të njohur dhe vlerësuar veçanësinë dhe rolin e çdo personi në jetën tonë. Trëndafili i thotë princit se bukuria e vërtetë nuk qëndron në formën e jashtme, por në thellësinë e lidhjes dhe rezonancës emocionale që ndajnë qenie njerëzore.

Mësimet nga simboli i trëndafilit në "Princi i Vogël"

Simboli i trëndafilit te "Princi i Vogël" na ofron mësime të rëndësishme mbi dashurinë, marrëdhëniet dhe rritjen personale. Ai tregon se lidhjet domethënëse formohen përmes kujdesit, durimit dhe përpjekjes. Të metat e trëndafilit na kujtojnë të përqafojmë brishtësinë, si tek vetja ashtu edhe tek të tjerët, gjë që nxit rritje dhe mirëkuptim në marrëdhënie.

Për më tepër, trëndafili forcon idenë se ajo çka e dallon me të vërtetë diçka ose dikë është koha dhe dashuria që i kushtojmë, duke theksuar nevojën për të kultivuar dhe ruajtur marrëdhëniet e rëndësishme.

Përktheu Noe Dajani



TINKA KURTI

Prishtinë 2.0

IZMIR

Quhem Izmir
Jam fëmija imagjinar i nënës sime
emrin e mora prej një romi
dashnor i saj, kur ishin gjashtë vjeç
nëna më tha se poezia është pështjellim
    fjalësh
babai më dha sallatat e ngrohta të
    hamburgerëve të globalizmit
mërzinë e mësova vetë dhe iu thashë
që vuajtja s'është, pos përpëlitja e lindjes
    së poezisë

mendova gabim
pasthirrmat janë fjalët e vetme të vërteta
e frazat e shkruara mes luftrash
marrin vlerë pa të drejtë
lufta është e përditshmja
me zotrat e ndërgjegjës

quhem Izmir
dhe emri është një shpagim i historisë
    njerëzore
nëna ime humbi shumë kohë në
    redaktimin
e letrës së vetëvrasjes
s'e vrau as poezinë
jetoi me mallkimin që e refuzoi romin
    sepse ishte i zi
të dy do të ishin vrarë rrugës
sikur të kishte pirë ujë nga duart e tij
nën një mal me gështenja
ose do të bënin kurora me ujë ujëvare
dhe kurrë nuk do ta mësynin parajsës

quhem Izmir,
s'ka rëndësi sa vjeç
para meje ishte një Izmir tjetër
me alamet sy
me mimikë shumë të gjallë
mirësinë e mori me vete në fatin rom

quhem Izmir
nëna ime nuk bëri asnjë hap
për të flakur tutje asnjë emocion
nga dashuria për Izmirin
lotët i ngacmon me pamje të lajmeve
    ndërkombëtare

quhem Izmir,
jam pendesa e nënës sime

quhem Izmir
nuk më pëlqën Z-ja në emrin tim
nuk ka zonja e zotërinj në qenien time
nuk ka emocione të drunjta
ka përçmim për ata që iu frikuan fundit
ka veç kujtime si inçizime të turbullta

quhem Izmir
jam zemërgjerësia e babait tim
magjepsja e grave me sytë e zi
jam një poezi e mjegullt
rivale e festivaleve
ma gjasë jam analfabet
por di që poezia është një vdekje e vogël
vargu i saj i fundit është çasti pasorgazmik
nuk jam purgator
jam hapësira në mes dy të dashuruarve

2016

PRISHTINË (2.0)

Prishtinë ti shet shumë sheqer
pse nuk e pastron ajrin si Parisi
Prishtinë pse nuk i nderon njerëzit tu sa
    janë gjallë
a i njeh hapat e poetëve kur ecin granitit
    tënd
pse nuk e ndalon screen time në çerdhe
a je ti Prishtina e megafonave
e grafiteve që flasin me njëri - tjetrin
Prishtinë ti ke plot kangë
dhe disa poezi
ku thuhet qyteti je ti
Prishtinë a e di që portretet më të mira t'i
    bënë ata nga provinca
pse nuk i pranon qetë divorcet
a ke qenë ndonjëherë e re Prishtinë
ti je edhe kafe Edhe raki edhe xhami
veç ti

Prishtinë edhe te ti u vranë gratë
për cilën qave më shumë
Pse nuk i do fëmijët Prishtinë që i shtyn
    ata në qendra tregtare
nje lulishte Prishtinë të lutem

cilit shkrimtar do t'i bësh statujë
a do të bëhesh e sigurt
pse flas nganjëherë në standard kur ti
    tingëllon kaq bukur
çka me bë të martën masdite
pse fle kaq shumë Prishtinë që prej
    pandemisë
cili është çifti më i dashuruar
pse nuk e bën një konkurs i cili do të
    anulohej
gjethet tua të dardhës ta fshehin gëzimin
një gëzim i shkurtë, i pakuptimë, i dikujt
    që nuk ka qenë asnjëherë perandori
    andaj s'ka pse të jetë nostalgjik
edhe pse burrat tu janë të palëvizshëm si
    pashallarë

pse i fsheh aq mirë njerëzit që lexojnë
a mund tw betohesh në Zot që e kupton
    çdo fjalë të anglishtes nëpër menytë e
    restoranteve
megjithëse e ke perfeksionuar këtë gjuhë e
    cila po zëvendësohet nga koreanishtja
pyeti tinejxherët
në tavolinat tua ti i ul të gjitha partitë
i shërben edhe pse tash askush s'pin më
    makiato
veç ti e di që ylberët kanë shndritë edhe
    para se të vendoseshin si pins në
    çantat e shkollave të mesme
ndoshta ke dëgju për sukseset në
    kinematografi, je e mirë edhe në letërsi
    e muzikë, por ende ke ndrydhje
qytezat vinin erë blini para teje
kur u shndërrove nga mahallë në lagje

Prishtinë nuk di çka të jap dhe s'e di çka
    më dhe
pos disa çertifika dhe relaksit në kolonat
    tua
më fal për mosmirënjohjen
sepse më dhe jetë, vullnet, mërzi, balet,
    shkronja, teatër, dashni, politikë,
    shoqni
dhe kamarierët më sollën ujë
pastaj më përcolle

Unë të braktisa ty për Vjenën dhe burrin
    që të do ty më shumë se Vjenën
a të pengoi kjo Prishtinë
a do të jesh me mua sidoqoftë
a më pranon nëse kam nevojë
si në shtatorin e 2007 kur ishe aq
    mikpritëse

ti nuk ishe qyteti im i parë, as i dytë dhe as
    i fundit
pse duhet të kthehem bash te ti krejt e
    plakur
por do të vij
nëse oborri i shtëpisë sime do të ketë ende
    trëndafila vjeshtës dhe jo një banesë

unë ende të dua, edhe pse më le të
    shkoj pa ndalesa në rrugën time të
    shkëputjes

DJALI I PARË

Kur doktoresha më tha
djalë
është pika jote në bark
Çka bëj me të i thashë
Unë kisha rritur 4 motra
dhe një më kishte rritur mua
unë isha vajzë
mes vajzash
kisha një mbesë
kisha pasur një gjyshe të mirë
asnjë gjysh
veç një baba
i vetmi djalë në jetën time

Si mund ta lind unë një djalë?
di për fustane
për shnolla
me folë për hënën
për yjet
një pjesë të qiellit
dhe nja dy përralla
a iu interesojnë këto djemve

Çfarë qenie janë ata
më duhet një emër
dhe një kumbar

edhe në terminin tjetër
pika djalë ishte

Pështillesha mes pse-ve dhe si-ve
edhe më vonë
derisa e kuptova pse ndodhi
fillimisht kisha zgjedhur balerinën si
    profesion
fiks në kohë
parashkollore
dhe universi u kujtua
ma dha një rol skenik
dhe një partner
sa nuk është krejt vonë
për trupin tim

djali më tha
veshu
me një fustan
që hapet si çadër kur rrotullohesh
dhe kapmi duart
të fluturoj
aty ku s'ke qenë ti

NE,

që çohemi nga dheu
që ecim kilometra me takat e ngrëna
që thembrat na janë çarë nga peshat e
    rënda të injorimit
ne që flemë salloneve
që s'kemi një dhomë në shpi
një vend në botë
ne që flokët na mbajnë erë darke pa mish
ne që presim në radhë për pak dashuri të
    nënës
ne që ndjekim hijet e paprivatizuara ende
që pimë ujë nga gypat e ndërgjegjeve të
    ndryshkura
ne që s'kemi pos ujit
dhe lahemi në faj
duke imagjinuar fëmijë afrikanë tek
    lëpijnë dritaret pas shiut
ne që lexojmë lajme
se thonjtë i kemi lyer me kozmetikë
    kancerogjene
e mendonim të fshinim gjurmët e
    lëndimeve shpirtërore,
ne që nuk qajmë kollaj
por që i respektojmë lotuesit
ne, që pasi shoqet na kanë dëshpëruar
vazhdojmë të bëjmë shoqni të reja,
ne që shokët na kanë zgjënjyer,
vazhdojmë ta rrisim besimin tek njerëzit,
ne që të drejtën e llogarisim me shumën e
    problemeve në jetët tona
ne që dhurojmë lule
dhe këpusim nga shpirti ynë tek prejmë
    trëndafilin,
ne që e prekim fundin,
por e shohim dhe dritën,
ne që ëndërrojmë tej muzgut, tej agimit
ne që mund të zgjedhim mes poshtë ose
    jashtë
derisa jemi pezull,
ne që marrim borxh për t'i bërë motrës
    tortë,
ne që shohim lart e i hapim sytë
s'flasim
se duhet ta rikapitullojmë çdo përrallë në
    botë,
ajo që na shkëlqen, nuk është lakmia në sy,
është cipa e zemërimit
që na thotë
shqyni
derrat
secilin
të egër
të sigurt
të kënaqur

WON-PYUNG SOHN

Djali që nuk e njihte frikën

Përktheu: Xhoina Salaj

Fragment nga romani "Almond"

Disa ditë më vonë, Goni erdhi në librari me një kuti plastike në duar. Brenda saj kishte zënë rob një flutur. Kutia ishte shumë e vockël, prandaj ajo përpëliste krahët një më dy.

- Ç'është kjo?

- Test ndjeshmërie, - tha Goni pa iu dridhur qerpiku dhe nuk iu gërvisht asnjë grimë buzëqeshjeje. Pra, hijerëndë nga koka te këmbët. Futi me kujdes gishtërinjtë në kuti dhe kapi fluturën, krahët e së cilës vazhdonin të kërkonin një fije shprese. – Si mendon se ndihet? – pyeti.

- Sikur do të lëvizë, - ia ktheva. Goni e nxori, e kapi në secilin krah me mollëzat e gishtave dhe nisi t'ia tërhiqte pak e nga pak. Ajo mblodhi forcat dhe po përpiqej të shpëtonte. – Nëse po e bën këtë për të më bërë të ndiej diçka, jepi fund!

- Pse?

- Sepse fluturës duket sikur po i dhemb.

- E nga e di ti? Ty nuk po të prek kush.

- Sepse kur dikush të tërheq krahët, të dhemb që ç'ke me të! E di nga përvoja.

Ama Goni nuk ndaloi dhe flutura vazhdoi të luftonte me aq sa mundte. Gati sa nuk po ia shkulte krahët fare, kur pa tej dhe tha:

- *Sepse fluturës duket sikur po i dhëmb!* Nuk mjafton kaq.

- Po ç'të bëj tjetër?

- Duhet të ndihesh sikur po të dhemb edhe ty.

- Pse? Unë nuk jam flutura.

- Mirë, pra. Le të vazhdojmë derisa të ndiesh diçka, - tha teksa vazhdonte të hapte krahët dhe hidhte sytë rrotull sikur po kërkonte diçka.

- Ndalo! Nuk është mirë t'u hysh në hak gjallesave.

- Mos më llomotit gjëra që i ke lexuar në librat e shkollës. Të thashë që do të ndaloj, nëse vërtet ndien diçka, - tha dhe pikërisht atë çast i këputi njërin krah. Lëshoi një ofshamë, ndërsa flutura vazhdoi të tundte kot e më kot krahun e mbetur. – Nuk të vjen keq për këtë? – më pyeti i xhindosur.

- Duket e sikletshme.

- Jo, jo, lëre sikletin. Të pyeta nëse të vjen keq, dreqi e mori!

- Mbylle këtë bisedë!

- Jo! – tha ai dhe nxori me nxitim diçka nga xhepi: një gjilpërë. E pozicionoi pranë fluturës, e cila vazhdonte të përpëlitej në dysheme.

- Çfarë po bën?

- Plasi sytë!

- Mjaft!

- Mos guxo t'ia ndash sytë ose e shpartallova këtë vend! More vesh?

Nuk doja që të ma shkatërronte librarinë dhe e dija që nuk thoshte kot fjalë në tym. Qëndronte sipër fluturës si të ishte një peshkop para një rituali. Një çast gjilpëra shpoi trupin e saj. Flutura luftoi në heshtje, duke u përpëlitur dëshpërimisht aq fort sa mundej. Goni më pa vëngër, shtrëngoi dhëmbët dhe vazhdoi t'i copëtonte ato mbetje të krahut të saj. Nuk isha unë ai që po përjetoja ndonjë ndjesi ndjellakeqe, por Goni. Kishte ngrysur vetullat dhe po kafshonte buzën, të cilën pak më parë e kishte mbuluar përqeshja.

- Po tani? Ndien ndonjë gjë? Apo vazhdon të të duket e sikletshme? Vetëm kaq? – tha me zërin që i dridhej.

- Tani mendoj se po i dhemb, shumë madje. Po tani dukesh *ti* në siklet.

- S'do mend, nuk më pëlqejnë gjëra të tilla. Do të ishte më mirë ta vrisja me një lëvizje të vetme, punë e kobshme. E urrej të bëj tortura të ngadalta.

- Atëherë, pse po e bën? Fundja, nuk mund të të jap atë që do.

- Qepe gojën, kokëkrisur!

Fytyra e Gonit ishte tjetërsuar kryekëput, njësoj si në ditën kur m'u hakërrye në piceri. U përpoq t'i bënte diçka më shumë fluturës, por nuk ia doli. Ajo qenie pa krahë, që dridhej lehtë me një gjilpërë të ngulur në trup, nuk mund të quhej më flutur. Insekti po shprehte dhembjen e vet me çdo forcë, duke lëvizur sa para e mbrapa, sa majtas e djathtas, që po luftonte me jetën e shenjtë. Mos po na lutej që të ndalonim, apo po përpiqej të mbijetonte?

Insektet duhet të jenë të zhveshura nga emocionet dhe ndoshta qe thjesht instinkt i nxitur nga shqisat.

- Dreqi e mori! Heq dorë!

Bam, bam, bam! Goni e hodhi fluturën në dysheme dhe e shkeli me gjithë fuqinë e tij.

***

Në vendin ku kishte qenë flutura, mbeti vetëm një pikë e vogël. Shpresoja të kishte shkuar në një vend më të sigurt. Do të kisha dashur ta kisha ndihmuar ta shmangte atë fund të hidhur.

Mendoj se ajo që ndodhi atë ditë me fluturën ishte si çelja e një gare. Një lojë e thjeshtë, nga ato që nëse mbyll sytë i pari, humb. Gjithmonë kam dalë fitimtar në lojëra të tilla. Njerëzit e tjerë luftonin për të mbajtur sytë hapur, ndërkohë që unë nuk dija si t'i mbyllja.

Kishin kaluar disa ditë që nga vizita e fundit e Gonit. Pse u zemërua me mua pas masakrës që i bëri fluturës? Sepse nuk reagova? Sepse nuk e ndalova? Apo hahej me veten për atë që bëri? Ekzistonte vetëm një person që mund t'ia bëja ato pyetje.

***

Doktor Shimi përpiqej gjithmonë t'i jepte drejtim pyetjeve të mia. Gjithashtu, ishte i vetmi që më dëgjonte pa paragjykime për marrëdhënien e veçantë me Gonin.

- Kështu do të jetoj gjithë jetën? Duke mos ndier asgjë fare? – e pyeta duke u kollofitur para tasit me *udon*. Ai më blinte shpesh ushqime dhe dukej se i pëlqenin *noodles*-at. Gëlltiti një rrepkë turshi, fshiu buzët dhe më tha:

- Pyetje goxha e vështirë, por më lër të të them, se thjesht fakti që ti më shtrove këtë pyetje, tregon një hap të madh. Pra, le të vazhdojmë të përpiqemi.

- Të përpiqemi për çfarë? Ti vetë më the se truri im kishte një problem madhor. Mami më ushqente çdo ditë me bajame, por pa dobi.

- E po, në vend të konsumimit të bajameve, po mendoja se ndonjë nxitje e jashtme mund t'ia vlente të provohej. Truri i njeriut është më budalla nga ç'ta pret mendja.

Doktor Shimi më tha se nëse vazhdoja të krijoja emocione, qoftë edhe të rreme, bajamet e vogla të trurit mund t'i merrnin si të vërteta dhe do të ndikonin në rritjen dhe aktivitetin e amigdalave të mia. Pastaj ndoshta do të isha në gjendje t'i lexoja më kollaj emocionet e njerëzve.

- Truri im ka qenë i njëjtë për pesëmbëdhjetë vjet. Si mund të ndryshojë tani krejt papritur?

- Prit, të të jap një shembull. Një person që nuk ia thotë për patinazh, ndoshta nuk do të bëhet patinatori më i mirë, edhe sikur të stërvitet me muaj të tërë. Një njeri që nuk ka vesh muzikor, nuk do të këndojë kurrë një solistikë të përsosur dhe për të nuk do të duartrokasë kush. Ama me pak punë, të paktën mund të shmangë një pengesë në akull ose të arrijë të kapë disa nota muzikore. Ja, këtë gjë të ofron praktika: mrekulli, por gjithashtu edhe kufizime. - Tunda ngadalë kokën. E kuptoja, ama ende nuk isha i bindur. Mund të funksiononte edhe për mua? – Kur nise t'ia bëje vetes këto pyetje?

- Para disa ditësh.

- Kishe ndonjë arsye apo incident specifik?

- Jo, thjesht po mendoja atë filmin që e kanë parë të gjithë, përveç meje. Sigurisht, jo se e vras mendjen shumë, por nëse do ta kisha parë, ndoshta do të kisha më shumë gjëra për të folur me të tjerët.

- Oh, çarritje! Kjo që sapo the, nënkupton gatishmërinë tënde për të komunikuar me të tjerët.

- Ndoshta është thjesht çështje moshe.

Doktor Shimi qeshi.

- E po, meqë je në këtë fazë, praktikoji emocionet me argëtime. Në thelb, je si një telajo borë e bardhë, kështu që më mirë ta ngjyrosësh me gjëra të mira sesa të këqija.

- Do të përpiqem. Nuk e kam idenë se si, por më mirë ta provoj sesa të qëndroj në vend numëro.

- Nuk është edhe aq mirë kur kupton disa emocione, që më parë kanë qenë të papërfillshme. Fundja, emocionet janë një lëmsh i koklavitur. E sheh botën në një dritë të re. Çdo gjë rreth vetes mund të të duket si një armë e mprehtë. Vetëm një çast delikat apo qoftë edhe disa fjalë të godasin më shumë se plumbi. Imagjino një gur në rrugë, që nuk ndien asgjë dhe nuk lëndohet kurrë. Ai nuk e ka idenë kur njerëzit e shkelin, por si do t'ia dilte nëse do ta ndiente sa herë shkelmohet, rrokulliset, gërryhet nga dita në ditë? Nuk e di nëse po qullos gjë me këtë krahasim... por ajo që dua të them është...

- Oh, e kuptoj. Edhe mami më thoshte gjëra të ngjashme, më shumë për të më bërë të ndihesha më mirë. Ti e di që ajo ishte shumë e zgjuar.

- Shumica e nënave kështu janë, - tha doktor Shimi dhe vuri buzën në gaz.

- Mund të të bëj edhe një pyetje? – ia beha pas një copë here.

- Patjetër! Çfarë do të dish?

- Për marrëdhëniet njerëzore.

Doktor Shimi shpërtheu në të qeshura. Afroi karrigen dhe vendosi dorën mbi tavolinë. Si fillim, i tregova incidentin e fluturës. Ndërkohë që flisja, çehrja e tij u zbut.

- Çfarë do të dish saktësisht? Pse reagoi në atë mënyrë? Apo se ç'mund të këtë ndier në atë rrethanë?

- Të dyja, besoj.

Ai tundi kokën.

- Duket sikur Goni dëshiron të jetë shoku yt.

- Shoku, - përsërita pa u menduar dy herë. – Edhe ti ia këput krahët një fluture nëse do të bëhesh shok me dikë?

- Jo, sigurisht që jo! – tha ai duke shtrënguar duart. – Po masakrimi i një fluture para syve të tu, duket se ia lënduar vërtet krenarinë.

- Po pse ka dashur që t'i prekej krenaria? Fundja, ishte ai që e vrau. – Doktor Shimi lëshoi një psherëtimë të thellë dhe unë menjëherë shtova: - E di që nuk është e kollajtë të më ndihmosh t'i kuptoj këto.

- Jo, por po mendoja se si mund ta shprehja më thjesht. Pra, çështja është kjo: Goni ka goxha interes ndaj teje; dëshiron të të njohë, por do edhe të ndiejë atë që ndien ti. Pasi dëgjova historinë që më the, më duket sikur ai është gjithmonë i gatshëm për të hedhur hapin e parë. Si thua sikur ta provosh edhe ti njëherë këtë gjë?

- Po si?

- Në këtë botë ka qindra përgjigje për një pyetje të vetme, kështu që zor se të jap një përgjigje të saktë. Në moshën tënde, bota është e ngjashme me një lojë formuese, ku duhet t'i kërkosh vetë përgjigjet. Po nëse do të dëgjosh vërtet këshillën time, do të të përgjigjem me një pyetje: çfarë bëri Goni për t'u afruar me ty?

- Më goditi.

Doktor Shimi ngriti supet.

- Oh, më fal, e harrova atë pjesë. Më mirë ta përjashtojmë. Ç'ishte gjëja tjetër që bëri më shumë për t'u afruar?

- Mmm... – u mendova një copë herë, – më takoi.

Doktor Shimi i ra lehtë tavolinës dhe tundi kokën.

- E po, duket sikur e ke gjetur përgjigjen.

Karikaturë nga Arben Meksi

Bota, Gjuha dhe Mendimi në filozofinë e Ludwig Wittgenstein-it

nga Ndue Gjika

Ludwig Wittgenstein-i (Vjenë, 1889 – Kembrixh, 1951), një ndër filozofët më të mëdhenj të shekullit XX, mbetet nga figurat më të shquara të filozofisë bashkëkohore. Ai e vendosi gjuhën në qendër të filozofisë së tij, duke e parë atë si mjetin përmes të cilit kuptojmë dhe ndërveprojmë me botën. Në trajektoren e mendimit të tij, që përfshin dy periudha kryesore—"Tractatus Logico-Philosophicus" dhe Philosophical Investigations (Hulumtime Filozofike)—ai eksploroi natyrën komplekse dhe dinamike të gjuhës.

Në veprën e tij të hershme, "Tractatus Logico-Philosophicus", Wittgenstein-i e përkufizon gjuhën si një pasqyrë të realitetit. Në filozofinë e kësaj periudhe, gjuha pasqyron realitetin përmes strukturës logjike; fjalitë marrin kuptim kur korrespondojnë me faktet. Në këtë periudhë, gjuha shihet si një hartë që përshkruan marrëdhëniet logjike midis objekteve, duke na ndihmuar të kuptojmë realitetin brenda kufijve të saj. Kjo ide përmblidhet në pohimin e tij të famshëm: "Kufijtë e gjuhës sime janë kufijtë e botës sime." Pra, vetëm ajo që mund të artikulohet përmes logjikës mund të kuptohet dhe të shpjegohet. Kështu, gjuha është një strukturë e ndërtuar mbi rregulla logjike, ku secila fjalë përfaqëson një objekt dhe marrëdhëniet midis fjalëve reflektojnë marrëdhëniet reale të botës. Një fjali është e vërtetë nëse pasqyron saktësisht realitetin dhe e pavërtetë nëse nuk e bën. Por ai thekson gjithashtu kufijtë e gjuhës: ka tema—si etika apo metafizika—që nuk mund të përshkruhen me fjalë dhe për të cilat duhet të heshtim.

Filozofia e mëvonshme e Ludwig Wittgenstein-it sjell një qasje revolucionare ndaj konceptit të botës dhe të gjuhës. Ai sugjeron se bota nuk është thjesht një realitet objektiv që ekziston në mënyrë të pavarur nga ne. Përkundrazi, ajo formësohet nga ndërveprimi ynë përmes gjuhës dhe përvojës. Kuptimi i botës, sipas tij, nuk është i pandryshueshëm, por ndryshon dhe evoluon bazuar në kontekstet njerëzore ku ndodhet. Kjo qasje sfidon idenë tradicionale të gjuhës si një pasqyrë e thjeshtë e realitetit dhe zbulon një mënyrë më dinamike të të menduarit. Gjuha është një fenomen që evoluon dhe përshtatet bazuar në nevojat, veprimet dhe kulturën e një grupi njerëzor.

Në veprën e tij madhore Philosophical Investigations (Hulumtime Filozofike), Wittgenstein-i prezanton konceptin e "lojërave gjuhësore", ku gjuha dhe bota ndërthuren përmes praktikës njerëzore. Kuptimi i një fjale nuk vjen nga struktura e saj logjike, por nga përdorimi i saj në situata konkrete. Për shembull, fjalia "kulla është e lartë" nuk pasqyron thjesht një fakt fizik; ajo ndan një kuptim të përbashkët të lartësisë bazuar në përvojën dhe kontekstin ku përdoret. Në një bisedë mes arkitektësh, kjo fjali mund të reflektojë detaje teknike, ndërsa për turistët ajo mund të përfaqësojë një përjetim vizual dhe emocional. Nga ana tjetër, kur një fëmijë mëson të luajë me një lodër dhe përdor fjalën "top," kjo fjalë merr kuptim të veçantë brenda kontekstit të lojës—jo vetëm si një objekt fizik, por edhe si pjesë e një bashkëveprimi. Kjo ndërthurje mes gjuhës dhe veprimit e bën ndërveprimin njerëzor një proces aktiv dhe të ndërlidhur.

Në tërësi, qasja e tij praktike e largon filozofinë nga një kornizë teorike dhe e zhvendos atë drejt një analize përvojë-bazë. Me këtë, ai i përgjigjet pyetjes: "Çfarë do të thotë të kuptosh botën?" Jo si një proces pasiv, por si një marrëdhënie dinamike, ku gjuha, veprimi dhe përjetimi janë të pandashme.

Për Wittgenstein-in, vërtetësia dhe pavërtetësia e fjalive janë thelbësore për filozofinë e tij, veçanërisht në Tractatus Logico-Philosophicus. Gjuha përshkruhet si një sistem që pasqyron strukturën logjike të botës, ku fjalitë paraqesin figura logjike që përfaqësojnë fakte. Një fjali ka kuptim vetëm kur posedon strukturën e duhur logjike që lejon përputhjen me një fakt konkret në realitet. Pa këtë përputhje, fjalia humb funksionin referues dhe nuk është e dobishme për përfaqësimin e botës. Në këtë kontekst, fjalitë funksionojnë si një formë vizuale ose përshkruese e realitetit, duke "pikturuar" situata që mund të jenë të vërteta ose të pavërteta, si në rastin e thjeshtë "Maceja është mbi dysheme," ku fjalia varet nga ekzistenca faktike e konfigurimit që përshkruan.

Wittgenstein zhvillon gjithashtu konceptin e fjalive elementare, të cilat përfaqësojnë lidhjen bazë midis fjalëve dhe objekteve në botë. Këto fjali, që janë themelet e strukturës logjike të gjuhës, tregojnë marrëdhëniet më të thjeshta që mund të ekzistojnë midis simboleve dhe realitetit. Përmes këtyre fjalive, gjuha lidhet ngushtë me realitetin duke krijuar një sistem të strukturuar të përshkrimit.

Një tjetër aspekt i filozofisë së Wittgenstein-it mbi gjuhën është analiza e fjalive logjike, si tautologjitë dhe kontradiktat. Tautologjitë janë fjalitë që gjithmonë janë të vërteta për shkak të formës së tyre logjike, si për shembull "ose pi, ose nuk pi". Megjithatë, ato nuk pasqyrojnë asnjë situatë konkrete dhe nuk mund të krahasohen me faktet e botës, duke qenë se mungon një lidhje referuese me realitetin. Në të njëjtën mënyrë, kontradiktat janë gjithmonë të pavërteta, sepse ato përmbajnë një mospërputhje logjike brenda vetes dhe nuk mund të përputhen me asnjë fakt ekzistues. Ky dallim nënvizon kufirin mes strukturës logjike dhe aftësisë së saj për t'iu referuar realitetit.

Gjuha ka kufijtë e saj, thotë Wittgenstein-i, dhe nuk mund të përshkruajë gjithçka. Ka realitete që janë përtej strukturave logjike-metafizike, etike apo shpirtërore, të cilat mbeten të pashprehshme. Këto ide janë përmendur në Tractatus përmes pohimit të tij të famshëm se për atë që nuk mund të flitet, duhet të heshtet. Përmes kësaj kornize, Wittgenstein na udhëzon të kuptojmë se gjuha është e fuqishme, por gjithashtu e kufizuar nga natyra e saj logjike dhe referuese.

Wittgenstein-i e trajton logjikën si skeleti mbi të cilin ndërtohet marrëdhënia mes gjuhës, mendimit dhe realitetit. Ajo është struktura themelore që i jep formë dhe rregull çdo shprehjeje, duke e lidhur mendimin abstrakt me botën konkrete. Për të, logjika nuk është thjesht një grup rregullash të shkëputura—ajo është pjesë përbërëse e mënyrës se si ne kuptojmë dhe ndërveprojmë me realitetin.

Një mënyrë për ta kuptuar këtë qasje është të imagjinojmë logjikën si rregullat e lojës së shahut, ndërsa realiteti është loja vetë. Rregullat e shahut përcaktojnë se si mund të lëvizin figurat, duke krijuar një strukturë dhe kufij për lojën. Pa këto rregulla, loja do të humbiste kuptimin dhe organizimin e saj. Në mënyrë të ngjashme, logjika përcakton rregullat që e bëjnë mendimin të kuptueshëm dhe të përputhshëm me botën—ajo na tregon se cilat shprehje kanë kuptim dhe cilat dalin jashtë kornizës së përshkrimit të faktit.

Për Wittgenstein-in, fjalia "Maceja është mbi dysheme" është kuptimplote sepse ka një strukturë logjike që mund të krahasohet me një fakt konkret në realitet. Në këtë analogji, fjalia është si një lëvizje e lejuar e figurave në shah—ajo ndjek rregullat e logjikës dhe, për këtë arsye, mund të krahasohet me një gjendje konkrete të botës. Nga ana tjetër, fjalitë metafizike apo tautologjitë, si "ose pi, ose nuk pi," janë si lëvizje të



paefektshme në lojë—ato nuk pasqyrojnë një situatë konkrete dhe nuk kontribuojnë në përshkrimin e realitetit.

Kjo analogji ndihmon të kuptohet përse Wittgenstein e sheh logjikën si bazë strukturore dhe si një mjet kufizues. Ajo e shpjegon botën në termat e saj më të thjeshtë dhe më të qartë, duke vendosur kufij mes asaj që mund të shprehet dhe asaj që tejkalon të menduarit dhe gjuhën. Në lojën e realitetit, logjika është ajo që i jep strukturë mendimeve tona dhe na ndihmon të ndërtojmë kuptime kuptimplote mbi atë që ekziston.

Në qendër të filozofisë së Wittgenstein-it qëndron një botë e thurur nga mendimi, gjuha dhe realiteti—si një lule që hap petale ndërsa ne e përjetojmë dhe e kuptojmë atë. Duke lëvizur nga logjika rigoroze e Tractatus-it te dinamika dhe praktika e Hulumtimeve Filozofike, ai krijon një rrugëtim që nuk është thjesht filozofi, por një reflektim mbi qenien tonë.

Ai na kujton se bota nuk është një mister për t'u zgjidhur, por një realitet për t'u përjetuar. Ajo që mund të shprehet është pjesë e lojërave tona gjuhësore; ajo që na tejkalon është mistika e ekzistencës, që vetëm përjetohet dhe nuk thuhet. Në këtë mënyrë, Wittgenstein-i na fton të shikojmë përtej fjalëve dhe logjikës, drejt dimensioneve të thella që sfidojnë mendimin dhe gjuhën tonë.

Konteksti historik dhe krahasimi me traditat para dhe pas tij e vendosin Wittgenstein-in si një urë mes dy botëve filozofike. Para tij, logjika ishte mbretëresha e një sistemi të ngurtë. Pas tij, filozofia kthehet drejt njeriut, drejt praktikave të tij dhe mënyrës se si ndërton kuptimin përmes gjuhës dhe veprimit. Ai u jep filozofëve një pasqyrë: gjuha nuk është thjesht një mjet, por një proces që flet për të gjithë ndërveprimet tona, një shprehje dhe një krijim i botës që na rrethon.

Dhe ja, brenda kësaj "luleje" filozofike, gjendet një pusullë: të mos harrojmë që mendimi ynë nuk është i ngujuar në një kornizë fikse, por është si një rreze që lëviz lirshëm përmes fjalëve, kufijve dhe heshtjes. Vetëm duke njohur kufijtë e logjikës, mund të kuptojmë thellësinë e asaj që qëndron përtej saj. Wittgenstein-i na dhuron një gjuhë për të reflektuar mbi botën tonë, por dhe një hapësirë për të përjetuar misterin e saj.

Kjo lule mbetet në duart e lexuesit si një simbol—i thjeshtësisë dhe thellësisë, i strukturës dhe lirimit. Është një ftesë për të menduar, për të parë dhe, mbi të gjitha, për të përjetuar botën me një ndjesi të re.

"Kronikë e një vdekjeje të lajmëruar" e Gabriel García Márquez-it

RRËFIMI SI KRONIKË

Nga Fatlum Meholli

Stili narrativ dhe koha e rrëfimit

Narratori mbizotërues i novelës "Kronikë e një vdekjeje të lajmëruar" të G. G. Markez, cilësohet si narrator-personazh, i cili duke qëndruar në sfond të novelës mbetet misterioz (anonim), ndonëse jepen disa detaje rreth tij, të shpëndara në tekst. E gjithë kjo krijon një portret të mjegullt të tij. Bëhet e ditur që ai është mik i Santiago Nasarit, protagonistit tragjik të ngjarjes/ve; është mik i Anhela Vikarios, një ndër figurat kyçe të veprës, e po ashtu ka lidhje familjare me personazhe të tjera si Margot, Luis Enrike, Kristo Bedoja... me ç'rast ky rrjet marrëdhëniesh e bën narratorin një dëshmitar të afërt dhe të përfshirë emocionalisht në ngjarjet që rrëfen.

Ngjarjet kanë ndodhur rreth 30 vjet më parë, duke vendosur gjithë rrëfimin në kohën e shkuar. Ky aspekt kohor, së bashku me kalimin e viteve, ndikon në mënyrën se si kujtimet dhe rrëfimet e të tjerëve bashkohen për ta ndërtuar historinë (*story*). Pavarësisht kësaj distance kohore, narratori ruan një ton të freskët/emocional, duke i dhënë lexuesit ndjesinë e aktualitetit, sikur ngjarjet zhvillohen para syve të tij.

Një nga veçoritë më të spikatura të këtij rrëfimi është mungesa e një kronologjie të drejtpërdrejtë. Kjo bën që modeli kompozicional fabular t'i përgjigjet një renditjeje jo-lineare, duke reflektuar natyrën kaotike të kujtimeve të narratorit dhe mënyrën e transmetimit të tregimeve të dëshmitarëve të tjerë, të cilët kryesisht japin informacione fragmentare.

Fillimi dhe fundi i novelës

Novela i shmanget një hyrjeje klasike, sepse nis drejtpërdrejt me përshkrimin e një ëndrre që kishte parë Santiago Nasari në të cilën dukej sikur e kishin glasitur zogjtë, gjë që paralajmëron fatkeqësinë që do të pasojë. Santiago zgjohet nga gjumi dhe, pa ditur çfarë e pret, fillon ditën e tij të zakonshme. Kur del nga shtëpia për të pritur ipeshkvin, ndodh që ngjarjet të marrin një kthesë të errët me ç'rast Santiago vritet mizorisht nga vëllezërit e Anhela Vikarios, Pedro dhe Pablo Vikario.

Narratori zbulon menjëherë se vrasja e Santiagos është ngjarja qendrore e novelës, që si akt tragjik në mënyrë atipike jepet në fillim të veprës, më pas teksti fokuesohet te motivet, detajet dhe ndikimet e kësaj vrasjeje. Ky model kompozicional narrativ krijon një ndjenjë tensioni, pasi lexuesi kërkon të kuptojë se ç'ndodhi para dhe pas këtij akti.

Rrethanat që çuan te vrasja

Pas zbulimit të aktit tragjik, narratori kthehet pas në kohë për të treguar rrethanat që çuan drejt një fundi të tillë. Ardhja e Bajardo San Romanit në fshat paraqet një moment kyç fabular. Bajardo, një burrë i pasur dhe shumë i pashëm, bie në dashuri me Anhela Vikarion, një vajzë nga një familje e varfër. Pavarësisht se ajo nuk e dashuron atë në fillim, presioni i familjes e detyron që të pranojë martesën, e cila megjithatë zhvillohet në mënyrë dramatike dhe dështon në fund. Nata e parë e çifit paraqet momentin turpërues, kur Bajardo kupton se Anhela s'ishte e virgjër, andaj, i ofenduar dhe tejet i zemëruar, ai e kthen nusen në shtëpinë e familjes së saj, duke bërë që nëna ta dhunojë fizikisht.

Pas këtij incidenti, vëllezërit e Anhelës, Pedro dhe Pablo, e marrin atë në pyetje dhe e detyrojnë të zbulojë se kush ia kishte marrë virgjërinë. Ajo përmend emrin e Santiago Nasarit, një pretendim i cili mbetet i pavërtetuar gjatë gjithë novelës. Edhe pse mungojnë provat, vëllezërit vendosin të hakmerren për nderin e familjes së tyre. Me këtë vendim, ata marrin thikat e kasapit dhe nisin planifikimin e vrasjes.

Një nga aspektet më të veçanta të kësaj ngjarjeje novelistike është mënyra se si Pedro e Pablo Vikario e bëjnë publik vendimin për krimin para se të ndodhte, pra nuk e mbajnë sekret qëllimin e tyre për ta vrarë Santiagon. Madje duket sikur e bëjnë këtë duke besuar se do t'i ndalojë dikush për ta konkretizuar qëllimin, por një gjë e tillë nuk ndodhë.

Në qumështoren e Klotilda Armentes, vëllezërit presin që Santiago të dalë nga shtëpia. Aty janë të pranishëm disa dëshmitarë, të cilët nuk dëshirojnë ose nuk munden që ta parandalojnë kërcënimin/qëllimin fatkeq. Andaj, kjo mund të merret edhe si pasqyrë e fuqishme e dështimit kolektiv të shoqërisë për të mrojtur një jetë njeriu.

Kur Santiago Nasari del nga shtëpia, ai është plotësisht i pavetëdijshëm për fatin që e pret. Pasi pret për ipeshkvin, ai shkon në shtëpinë e të fejuarës së tij të bukur, Flora Migel. Aty, ai mëson për planet e vllezërve Vikario, por nuk kupton arsyen pas këtyre kërcënimeve. I hutuar dhe shqetësuar, niset për në shtëpi, duke mos ditur që është ndjekur nga Pedro e Pablo, të cilët në një skenë mizore dhe të dhimbshme e godasin disa herë me thikë duke e lënë të vdekur.

Rrëfimi si kronikë

Novela i ngjan një kronike, ku çdo fragment është një pjesë e mozaikut tërësor që formon historinë e plotë. Narratori përdor informacione nga burime të ndryshme: përvojat e tij personale, rrëfimet e personazheve të tjerë (të shumtë) dhe dokumente reale siç ishte ta zëmë procesverbali prej 200 faqesh i një hetuesi. Kjo qasje shumështresore e bën rrëfimin më të pasur e gjithashtu më kompleks, duke i dhënë lexuesit një pamje të gjithanshme të ngjarjeve.

Përmes stilit të tij, Markez eksploron tema të thella si nderi, faji kolektiv dhe mënyra se si shoqëria e trajton drejtësinë. Vrasja e Santiago Nasarit nuk është vetëm një akt individual, por është një pasqyrim i një komuniteti të tërë që dështon në mënyrë kolektive për të parandaluar një tragjedi të parashikueshme/planifikuar. Ky aspekt bën që novela të jetë më shumë se një histori individuale/personale - kjo vepër letrare bëhet një reflektim i natyrës njerëzore dhe marrëdhënieve shoqërore.

Në vend të përfundimit

Pavarësisht se narratori përpiqet të rindërtojë ngjarjet me sa më shumë saktësi, pyetje e pyetje mbeten pa përgjigje. Ishte Santiago Nasari vërtet fajtor? Apo ishte vetëm një viktimë e një sistemi shoqëror që vlerëson "nderin" mbi drejtësinë? Ky mister i pazgjidhur i jep novelës një ndjenjë të vazhdueshme tensioni dhe reflektimi, duke e bërë atë një vepër të jashtëzakonshme letrare

STUDIMET ALBANOLOGJIKE NË KINË

Iljaz Spahiu, Sinolog



Në tetor të vitit të kaluar isha i ftuar për disa leksione në Katedrën e Gjuhës Shqipe dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike në Universitetin e Gjuhëve të Huaja në Pekin. Sigurisht si sinolog, takimet me kolegët albanologë kinezë, janë gjithmonë sa emocionues, aq edhe të frytshëm, përfitues, një rast i mirë për të shkëmbyer mendime e përvoja, për të hedhur ide e thurur projekte për forcimin e shkëmbimeve kulturore, studimore, akademike, letrare, etj. Por ajo që për mua ishte befasuese dhe mbresëlënëse, që tejkaloi njohjet e mia për këtë katedër, ishte puna e jashtëzakonshme që bëhet aty jo vetëm në drejtim të mësimdhënies së gjuhës shqipe, por edhe të studimeve të gjithanshme në fushën e albanologjisë, nga një staf i mrekullueshëm nën drejtimin e albanologes së njohur Ke Jing, ose Gjina siç e thërrasin shqiptarët. . Pa asnjë dyshim kjo katedër është kryeqendra e albanologëve dhe albanofonëve të Kinës.

-Katedra e Gjuhës Shqipe në Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit (BFSU) është themeluar në vitin 1961. Me një ndërprerje të shkurtër në vitet 1980, ajo e vijon veprimtarinë mësimdhënëse dhe kërkimore prej më se 65 vjetësh. Kjo katedër është qendra më e rëndësishme universitare dhe akademike në gjithë Azinë. Gjatë këtyre dekadave të punës së saj, ajo ka formuar dhjetëra breza njohësish të shqipes, nga të cilët kanë dalë përkthyes, albanologë, studiues, gazetarë dhe diplomatë të njohur, që kanë punuar e punojnë në institucione qendrore shkencore-kulturore në Kinë dhe jashtë saj. Profesorati dhe studentët e formuar nga kjo katedër dhe bashkëpunëtorët e saj kanë luajtur një rol themelor për njohjen e vijueshme të gjuhës, kulturës, letërsisë dhe vlerave të qytetërimit shqiptar në Kinë. Aktualisht në Katedrën e Gjuhës Shqipe studiojnë 25 studentë, në tri nivelet, bachelor, master dhe doktoraturë. Nga viti 2017, pranë këtij Universiteti, në kuadër të Katedrës së Gjuhës Shqipe, funksionon edhe Qendra e Studimeve Albanologjike, të cilat , të dyja së bashku kanë kontribute të spikatura në disa drejtime të punës kërkimore shkencore, si studime monografike, hartimin dhe botimin e disa fjalorëve, në fushën e përkthimeve, në hartimin teksteve mësimore, të studimeve akademike etj.

Në fushën e studimeve monografike, do të veçoja "Katër të tjerët në Veprën e Kadaresë"- Studim mbi identitetin kombëtar shqiptar, të Prof. Dr. Ke Jing, një studim mbi identitetin kombëtar shqiptar ", sjell një tezë ku ndërthuret letërsia, antropologjia, me nacional-komunizmin, dhe për të cilën profesor Shaban Sinani shprehet se, duke analizuar Katër të tjerët, "Ke Jing kërkon rrënjët e identitetit shqiptar përmes pasqyrës, dhe kjo pasqyrë është vepra e Kadaresë. Kjo vepër e ofron *tjetrin* në pamje që ndryshojnë, ashtu siç ndryshon vetë identiteti". Sipas autores, "Kadare mendon se identiteti nuk ndryshon dhe ne kemi identitet evropian dhe kjo përputhet me vizionin që ai ka për të ardhmen e shqiptarëve. Në veprat e tij, shprehet albanologia, "identiteti ka qenë gjithmonë i pranishëm si një temë qendrore. Identiteti mund të ndërtohet apo rindërtohet. Kadare ka qenë një figurë shumë e rëndësishme, sidomos nga pikëpamje letrare, për të orientuar popullin shqiptar në identifikimin e tyre".

Gjithashtu një vepër me mjaft vlera informuese e studimore jo vetëm për lexuesin kinez, është edhe "Studime mbi Kulturën dhe Arsimin në Shqipëri", me autorë Profesoreshë Chen Fenghua dhe Profesoreshë Jin Qiao, një botim i plotë që synon të japë për lexuesit kinezë një pasqyrë të përgjithshme për historinë, shoqërinë, kulturën e arsimin në Shqipëri, gjendjen aktuale dhe perspektivat. Në kapitullin e parë dhe të dytë të kësaj vepre, me anë të materialeve të detajuara nga burime të sigurta të dorës së parë, jepet një përshkrim i përgjithshëm i mjedisit gjeografik të Shqipërisë, sistemit shtetëror, jetës sociale, historinë, traditat e zakonet si dhe kontekstin historik të zhvillimit të arsimit në Shqipëri. Ndërsa kapitujt e tjerë i kushtohen tërësisht çështjeve të arsimit.

Një kontribut i jashtëzakonshëm i Katedrës së Gjuhës Shqipe janë një numër fjalorësh dy gjuhësh, të cilët mund të them se janë të vetmet botime serioze në këtë fushë si në Kinë ashtu edhe në Shqipëri. Do veçoja këtu Fjalorin Shqip-Kinezisht dhe Kinezisht Shqip, hartuar nën drejtim shkencor të profesoreshë Ke Jing, "Fjalorin Diplomatik shqip-kinezisht dhe kinezisht- shqip", të Profesoreshë Xiao Guifen, Fjalori me ilustrime "Shqip-kinezisht , kinezisht –shqip", nga profesoreshë Jin Qiao, "Fjalë të urta nga gjuhët e vendeve të Evropës qëndrore e lindore"(Pjesa për Shipërinë), nga Jin Qiao.

Gjithashtu është në procesin e hartimit edhe një fjalor tjetër i madh me mbi 80 mijë fjalë, një vepër tjetër fryt i punës serioze, shkencore e të palodhur, të profesoreshë Ke Jing dhe bashkëpunëtorëve të saj, si albanologu i shquar Zheng Enbo, profesoreshë Chen Fenghua, e të tjerë. Edhe më parë ka pasur përpjekje sporadike për hartimin e fjalorëve dygjuhësh, por fjalorët mësipërm janë të vetmet botime të vërteta e të plota shkencore.

Katedra dhe Qendra e studimeve albanologjike është dalluar edhe në fushën e përkthimit të autorëve shqiptarë në kinezisht. Kështu veçojmë romanet "Aksidenti", i Kadaresë, "Hoteli i Drunjtë" i Diana Çulit dhe "Otello, Arapi i Vlorës" i Ben Blushit, përkthyer nga Chen Fenghua.

"Enciklopedi e shkurtër e historisë dhe e trashëgimisë së Shqipërisë", përkthyer nga Ke Jing dhe profesoreshë Ma Sai.

Veprimtaria shkencore e Katedrës së Gjuhës Shqipe shtrihet edhe në fushën e përgatitjes së teksteve mësimore universitare, ku veçojmë "Gramatika praktike e shqipes", me autorë Ke Jing dhe Chen Fenghua, "Kurs dëgjimor i gjuhës shqipe", nga Chen Fenghua dhe Ruzhdi Stringa, "Kur i gjuhës së folur shqipe", nga Ke Jing, etj.

Ndërkohë me ngritjen e Qendrës së Studimeve Albanologjike, Katedra e gjuhës shqipe është angazhuar gjerësisht në një veprimtari të mirëfilltë studimore shkencore mbi Shqipërinë dhe botën shqiptare në tërësi, e cila ka rezultuar me botimin e një sërë artikujsh e analizash mjaft interesante, me vlera të rëndësishme studimore për tema të veçanta të albanologjisë. Do të veçoja këtu disa studime për veprën e Kadaresë si, "Personaliteti i personazheve kryesore në "Prilli i thyer" dhe "*Çështja e Kosovës në veprat e* Ismail Kadaresë" nga Prof. Ke Jing, "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur" në median kineze", nga Chen Fenghua apo "Interpretimi i emrave në veprat e Kadaresë", nga Ma Sai.

Përmendim gjithashtu edhe "Përmbledhje vjetore e Letërsisë Shqipe" (2016-2022) dhe "Shpëtimi i hebrenjve në Shqipëri dhe Kinë gjatë Luftës së Dytë Botërore", shkruar nga profesoreshë Ma Sai, studimet fetare "Kombi shqiptar dhe sekti mysliman-bektashi (2013), Toleranca fetare në kulturën shqiptare dhe kineze" (2017), nga profesoreshë Jin Qiao, disa artikuj të profesoreshë Chen Fenghua për filmat shqiptarë dhe ndikimin e tyre në Kinë gjatë viteve 60-70 të shekullit të kaluar, të tillë si "Spektatorët kinezë të filmave shqiptarë të viteve 60-70: Shembull "I teti në bronz", "Përkthimi i filmave shqiptarë: me referencë "Ngadhënjim mbi vdekjen" dhe "Horizonte të Hapura" dhe "Mbi ndërveprimin mes shoqërisë kineze dhe filmave artistikë shqiptarë në vitet 60-70", apo studimet kulturore si "Familjet dhe martesat në Shqipëri",

nga Xiao Guifen, “Prejardhja e simbolit “shqiponjë” të shqiptarëve” dhe “Besa” në kulturën tradicionale shqiptare”, nga Chen Fenghua.

Nuk mund të lë pa përmendur këtu edhe dy nisma tepër të rëndësishme të Katedrës së Gjuhës Shqipe të BFSU, krijimin e portalit “Syri i Kaltër”, nga Qendra e Studimeve Albanologjike, në të cilin publikohen rregullisht informacione të gjithanshme për Shqipërinë, por edhe studime shkencore, shkrime e analiza politike, duke luajtur një rol dashamirës për promovimin e imazhit të Shqipërisë në Kinë.

Një tjetër nismë është projekti universitar “Shqip plus”, që synon orientimin e studimeve drejt gjuhëve të tjera të Ballkanit përmes shqipes.

Po kështu me kujdesin e katedrës dhe punën e saj, rreth 60 personalitete shqiptare zënë vend në Enciklopedinë e Kulturës Kineze.

Duhen vlerësuar gjithashtu edhe marrëdhëniet e ngushta që Katedra e Gjuhës Shqipe të BFSU ka me Akademinë e Shkenca dhe disa Universiteti në vendin tonë, si dhe shkëmbimet akademike mes institucioneve. Profesorë të nderuar si Emil Lafe, Floresha Dako, Rexhep Ismajli, Shaban Sinani, etj janë ftuar për kurse leksionesh në Katedër, ndërkohë që albanologë kinezë si Prof. Ke Jing, Prof. Chen Fenghua, etj kanë marrë pjesë në konferenca shkencore të organizuara nga Akademia e Shkencave dhe institucione të tjera, kushtuar çështjeve të kulturave e qytetërimeve në Ballkan. Prof. Dr. K Jing vitin e kaluar u pranua si anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Dhe përpos gjithë kësaj veprimtarie të frytshme mësimore, studimore e akademike, vlen të përmendet edhe kontributi i stafit të pedagogëve të kësaj katedre për zbatimin me sukses të Programin të përkthimit dhe botimit të ndërsjelltë të autorëve shqiptarë e kinezë në vendet respektive, program i nënshkruan në vitin 2015, për zbatimin e të cilës u angazhuan disa shtëpi botuese në Shqipëri dhe Shtëpia botuese FLTRP (Foreign Language Teaching and Research Press), pranë Universitetit të Gjuhëve të huaja BFSU si dhe një grup ekspertësh kinezë e shqiptarë. Tani pas gati 10 vjetësh, falë këtij programi janë botuar mbi 20 libra të autorë kinezë, një pjesë e mirë e të cilëve, për herë të parë kanë ardhur në gjuhën shqipe të përkthyer drejtpërdrejt nga origjinali, të tillë si dy romane të shkrimtarit nobelist, Moyan “Bretkosa” dhe “Klani i Sorgumit të Kuq”, dy romane të shkrimtarit tjetër të njohur Yu Hua “Të Jetosh” dhe “Njeriu që shet gjak”, si dhe veprat filozofike “Dao De Jing”, “Analet- Lunyu” të Konfucit, “Konceptet bazë të mendimit dhe Kulturës kineze”, vepra klasike “Ëndërr në Pallatin e Kuq”- Hongloumeng, “Kultura tradicionale kineze”, e shumë libra të tjerë, si dhe janë shtuar botimet e autorëve shqiptarë në Kinë. Kështu përveç një numri të konsiderueshëm të veprave të Kadaresë dhe disa veprave të Dritëro Agollit, janë përkthyer dhe botuar drejtpërdrejt nga gjuha shqipe edhe “Përralla të Moçme Shqiptare”, “Otello, Arapi i Vlorës”, “Shqipëria përmes Artit”, “Guidë mbi Historinë e Shqipërisë dhe Trashëgiminë Kulturore Shqiptare”, ndërkohë këtë vit pritet të publikon edhe “Këngët e Milosaos”, “Vargje të Lira”, “Rrëfenjë me Ndërkombëtarë”, etj.

Prej më shumë se gjashtë dekadash, Katedra e Gjuhës Shqipe në Universitetin e Gjuhëve të Huaja në Pekin, vazhdon të jetë promotore e promovimit të gjuhës dhe kulturës shqiptare në Kinë.

“Zëri i Shqipërisë”- Antologjia e Poezisë Shqipe botohet në Uzbekistan

Këto ditë u botua në Tashkent, Uzbekistan, ‘Zëri i Shqipërisë’-një Antologji e plotë e poezisë Shqipe, përmbledhur nën përkujdesjen e poetes më të njohur të vendit të saj, një poete tashmë e njohur, përmes botimeve të veta dhe në UK, SHBA, Itali, Rusi, Turqi, Spanjë, në më shumë se 30 vende të Botës, zonjës Khosiyat Rustamova, kryeredaktore e revistës më prestigjioze letrare dhe artistike të Uzbekistanit.

Zonja Khosiyat Rustamova tashmë është e njohur nga disa prej poetëve shqiptarë, ngase ajo ka shfaqur një kureshtje të admirueshme për letërsinë Shqipe, dhe ka botuar në faqet e gazetës ‘Bota e Librit’ poezitë e njohura të autorëve të gjuhës Shqipe, si Naim Frashëri, Ndre Mjeda, Çajupi, Asdreni dhe Lasgush Frashëri, si dhe poetë bashkëkohës si Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Vangjush Ziko, Sadik Bejko, Rudolf Marku, Preç Zogaj, Fatbardh Amursi dhe të tjerë më pak të njohur.

Antologjia është krijuar duke u mbështetur kryesisht në botimet e mëparshme të autorëve shqiptarë në faqet e gazetës ‘Bota e Librit’ duke u plotësuar me poezi dhe intervista të disa prej autorëve.

Në faqen e parë botohet ky prezantim i Librit, i ndjekur nga një parathënie e shkruar nga zonja Rustamova.

“Zëri i Shqipërisë” — ky libër sjell fjalën e zemrës së letërsisë shqiptare, dhembjen dhe ëndrrat e popullit, historinë dhe botën shpirtërore në bibliotekën uzbeke. Aty janë mbledhur poezitë, tregimet, esetë dhe bisedat e shkrimtarëve dhe poetëve të njohur si Naim Frashëri, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Sadik Bejko, Rudolf Marku, Fatbardh Amursi etj.

Libri është i destinuar për një audiencë të gjerë lexuesish dhe konsiderohet një burim i çmuar për ata që dëshirojnë të ndiejnë se si mund të flasë zemra e një populli.

Parathënia:

Zëri i Shqipërisë - është zëri i letërsisë! Ky përmbledhje është një dhuratë e çmuar që përmban veprat e poetëve-shkrimtarëve më të njohur të letërsisë shqiptare, të botuara në gazetën “Bota e Librit” dhe të pritura mirë nga lexuesit tanë. Ky libër shpreh jo vetëm dashurinë për trashëgiminë tonë letrare, por gjithashtu shërben si një urë kulturore midis letërsisë shqiptare dhe asaj uzbeke.

Letërsia shqiptare ka qenë për një kohë të gjatë e rëndësishme me historinë e saj të pasur, në legjendat e bukura dhe burimet moderne. Ajo tregon thellësisht ndjenjat, shpresat dhe ëndrrat e popullit. Në këto vepra, krijuesit kanë reflektuar jo vetëm përvojat e tyre personale, por edhe veçantitë sociale-politike dhe kulturore të kohës së tyre.

Ne synojmë që me këtë libër t’i prezantojmë lexuesit tanë me botën unike të letërsisë shqiptare. Jemi të bindur se, përmes këtyre veprave, lexuesit do të ndjejnë jo vetëm bukurinë e lirikes dhe mendimet e pasura, por gjithashtu do të vënë re afërsitë ose dallimet midis kulturës sonë kombëtare, letërsisë dhe popujve tanë.

Çdo vepër është një dëshmi e kohës, çdo rresht është harmoni e të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes. Kjo përmbledhje, si ornamentet e veçanta të letërsisë, fton lexuesit e vet në harmoni dhe inspirim, duke u ofruar atyre mundësinë për të zbuluar majat e reja të potencialit letrar.

Duhet të themi se kjo përmbledhje është përgatitur si rezultat i një pune të madhe. Arsyeja e parë është problemi i gjuhës, ndërsa arsyeja e dytë ka të bëjë me vendosjen e lidhjeve të ngushta dhe gjetjen e veprave të poetëve-shkrimtarëve që janë përkthyer në anglisht ose rusisht, duke ia paraqitur ato përkthyesve me përvojë, si dhe angazhimin e një numri të autorëve që jo vetëm që janë tani të njohur në mbarë botën, por që tashmë të njohur përmes krijimtarisë si të aftë, për të diskutuar seriozisht mbi problemet aktuale në letërsi. Në këtë rast, shpreh falënderimin tim për mikun tonë që na ndihmoi nga afër, poetin shqiptar-amerikan, themeluesin e protonizmit, Gjek Marinaj, si dhe poetin e njohur Rudolf Marku dhe shumë përkthyes tanë uzbekë.

Khosiyat RUSTAMOVA.
Kryeredaktore e gazetës “Bota e Librit”, Prill, 2025



AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË

VEHBI MIFTARI

ETNOLETRA SHQIPE

Raporti i letërsisë me etnokulturën
e kombformimin

BOTIMET TOENA